

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Sfidat e trashëgimisë kulturore në Maqedoni

(konferencë shkencore – 30.09.2014)

- 9 -



Shkup, 2015

Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE –
SHKUP

Vëllimi 9 – 2015

Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Dr. Skender Asani

Kryeredaktor:
Dr. Zeqirija Ibrahim

Këshilli redaktues:
Dr. Shefqet Zekolli
Dr. Sefer Tahiri
Dr. Mixhait Pollozhani
Mr. Hidajete Azizi

Sekretar i redaksisë: *Mr. Agron Salih*

Redaktor teknik: *Naser Fera*

Copyright© ITSHKSH, 2015
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN 978–608–4653–25–7

www.itsh.edu.mk

Ky botim është ndihmuar nga Komuna e Çairit.

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Sfidat e trashëgimisë kulturore
në Maqedoni

(konferencë shkencore – 30.09.2014)

- 9 -

SCUPI

Shkup, 2015

TRYEZA E LËNDËS:

NË VEND TË HYRJES.....	7
BEHIXHUDIN SHEHAPI: TRASHËGIMIA KULTURORE, BAZË PËR PËRPARIMIN E SHOQËRISË	9
NAIM HALIMI: TRASHËGIMIA KULTURORE E SHQIPTARËVE NË MAQEDONI PASURI E RAJONIT DHE EVROPËS	11
QEMAL MURATI: GJUHA ËSHTË NJË TRASHËGIMI	15
ZEQIRJA NEZIRI: LAHUTARI KADRI ZYMERI	23
HAMIT XHAFERI: EKZISTENCA DHE SHFAQJA E PARIMIT TË ZBUKURIMIT NË KËNGËT E KRESHNIKËVE TË TREVËS SË KËRÇOVËS	31
NEBI DERVISHI: MUZEU ETNOKULTURA “VIA KANDAVIA” NË FSHATIN LIVADHI TË STRUGËS	45
SEVDAIL DEMIRI: SHTYPI SHQIPTAR NË MAQEDONI, SI TRASHËGIMI KULTURORE.....	50
BUKURIE MUSTAFA: LOJËRAT POPULLORE NJË TRASHËGIMI E HARRUAR	56
IZAIM MURTEZANI : KARNAVALI I BOZOVCËS	68
BEXHET ASANI: NJË MBISHKRIM I LASHTË NË UNAZË	89
HIDAJETE AZIZI: IDENTITETI KOMBËTAR DHE FETAR NË PROCESIN E EMËRVËNIES	94
AFRIM REXHEPI: ESTETIKA E ISO–POLIFONISË	108
RINI USEINI: MBI KUJTESËN APO NGULMIN, MANIFESTIMI I SOTËM I VESHJES POPULLORE.....	115
AFET JASHARI: PEHLIVANIZMI – VLERË E TRASHËGIMISE KULTURORE NË MAQEDONI.....	125

ARLIND FARIZI: “KONTRIBUTI I LETËRSISË PËR RUAJTJEN E TRASHËGIMISË – SIMBOLI MITIK I GJARPRIT TE ‘LULET E FTOHTA TË MARSIT’ TË ISMAIL KADARESE”	130
ARBEN SULEJMANI: TEQEJA BEKTASHIANE HARABATI BABA, NDËR MË E VJETRA TRASHËGIMI NGA EKZISTUESET DERI MË SOT	141
SEFER TAHIRI: PROJEKTI SHKUPI 2014 MIDIS POLITIKËS DHE KULTURËS	141
KONKLUZIONET E KONFERENCËS SHKENCORE “SFIDAT E TRASHËGIMISË KULTURORE NË MAQEDONI”	141

NË VEND TË HYRJES

Trashëgimia kulturore, shpirtërore dhe materiale, historikisht në Maqedoni përballet me sfida të ndryshme, si pasojë e politizimit të kësaj fushe dhe tendencave për vënien e saj në funksion ideologjik dhe etnonacionalist, gjë që e dëmton rëndësinë bazike të saj, që është përcjellja e vlerave të mirëfillta brez pas brezi.

Sidomos viteve të fundit, pra nga viti 2006 deri më sot, kur pjesë e establishmentit politik dhe rjedhimisht edhe me institucionet e kulturës udhëheq një parti e kampit të djathtë, VMRO–DPMNE, si asnjëherë më parë dhe si në asnjë vend tjetër me civilizim të lashtë, nuk bëhen përpjekje që trashëgimia kulturore të shërbejë si instrument politik, por edhe publik, për kontruksionin e një identiteti të ri etnokulturor maqedonas. Fatkeqësisht krejt kjo është duke u realizuar në kurriz të vlerave subline të kulturës shqiptare, të kultivuar ndër shekuj, vlera që nuk janë të ruajtura dhe të sistematizuara sa duhet nga shteti, janë të pambrojtura nga institucionet kompetente, të papromovuara sa duhet nga mediat dhe segmentet tjera shoqërore dhe krejt në fund janë edhe të paafirmuara në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Andaj, nisur nga këto fakte, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup (ITSHKSH), mori nismën për organizimin e një konference shkencore me temë “Sfidat e trashëgimisë kulturore në Maqedoni”, në të cilën në mënyrë shkencore u shoshitën tema të ndryshme që e përcjellin me vite të tëra trashëgiminë kulturore, sidomos në hapësirën shqiptare.

Për të pasur sukses në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe në afirmimin e saj publik është e nevojshme që institucionet kulturore të shtetit të rrisin kujdesin ndaj vlerave tona të trashëguara, që nga kohërat më të lashta. Ky synimi nënkupton revalorizimin e vlerave kulturore, gjetjen dhe restaurimin e objekteve të vjetra arkeologjike, ruajtjen dhe kultivimin e vlerave materiale – etnologjike, pro–

movimin dhe propagandimin e tyre përmes mas-mediave të ndryshme, etj.

Për të elaboruar temat në konferencë, përveç studiuesve të ITSHKSH-së, u paraqitën edhe studiues të shumtë nga universitetet shqiptare në Maqedoni (USHT dhe UEJL), të cilët dhanë kontributin e tyre në shtjellimin e shumë aspekteve që ndërlidhen me trashëgiminë kulturore tek ne. Në këtë mes studiuesish bëjnë pjesë: Prof. dr. Fatmir Sulejmani (USHT) Prof.dr. Naim Halimi (ITSHKSH), Prof.dr. Qemal Murati (ITSHKSH), Dr. Mixhait Pollozhani (USHT), Prof. dr.Nebi Dervishi (USHT), Dr. Skender Asani (ITSHKSH), Prof. dr. Zeqirja Neziri (USH),Prof.dr. Hamit Xhaferi (UEJL), Dr. Sevdail Demiri (ITSHKSH), Prof.dr. Bukurije Mustafa (ITSHKSH), Prof.dr. Izaim Murtezani (Instituti i Folklorit), Dr. Bexhet Asani (Universiteti FON), Prof.dr.Afrim Rexhepi (Instituti i Letërsisë), Dr. Hidajete Azizi (ITSHKSH), Mr. Rini Useini (ITSHKSH), Afet Jashari (Ministria e Kulturës), Mr. Arlind Farizi (USHT), Mr. Arben Sulejmani (USHT) dhe Dr. Sefer Tahiri (ITSHKSH).

Kjo konferencë u organizua në kuadër të projektit tradicional të ITSHKSH me titull “Mbrojtja e trashëgimisë kulturore në Maqedoni”, që ka për qëllim promovimin dhe afirmimin e trashëgimisë. Projekti u mbështet financiarisht nga Ministria e Kulturës.

Ky botim që keni në duar, është në vazhden e promovimit të këtyre vlerave tona të pasura kulturore e shpirtërore të trashëguara brez pas brezi, të cilat duhet të ruhen e kultivohen përjetësisht.

Këshilli organizativ i konferencës shkencore

*Fjala përshëndetëse e sekretarit shtetëror në Ministrinë e Kulturës,
Behixhudin Shehapi*

TRASHËGIMIA KULTURORE, BAZË PËR PËRPARIMIN E SHOQËRISË

Të nderuar mysafirë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që ta shpreh kënaqësinë që sot kam mundësinë t'ju përshëndes dhe t'ju drejtohem në këtë tubim evenimenti, në organizim të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni.

Vendet, popujt dhe bashkësitë në Evropën Juglindore i bashkojnë jo vetëm lidhjet e fuqishme historike, shoqërore dhe ekonomike. Shtetet nga rajoni ynë dhe banorët e tyre i bashkon para se gjithash pasuria e vetme e diversitetit të shprehjes kulturore, që është bazë e specifikës së vet, por edhe të lidhjeve të shumta të brendshme, të thella dhe komplekse. Kujdesi për ruajtjen e trashëgimisë kulturore nuk është vetëm një obligim deklarativ i shoqërisë së gjithëmbarshme bashkëkohore, e cila duke e parë rëndësinë e saj krijon kushte për ruajtjen e saj për gjeneratat e reja.

Pikërisht për këtë, kultivimi dhe afirmimi i kulturës së popujve dhe bashkësive etnike në vendin tonë paraqet njërën ndër përpjekjet e Qeverisë dhe Ministrisë së Kulturës. Përparimi i kulturave i të gjitha bashkësive që jetojnë në Maqedoni mbetet imperativi ynë, nga fakti se të gjithë së bashku japim kontribut të paçmueshëm ndaj thesarit të pasur kulturor, me të cilin njihet vendi ynë në mbarë botën.

Maqedonia është vendi i më shumë civilizimeve që kanë lënë dëshmi të rëndësishme materiale nga kohërat e kaluara të ekzistimit të vet. Duke prezantuar një ndërlidhje të rëndësishme të rrethanave kulturore përmes karakteristikave individuale, pasqyrohen memoriet kolektive të bashkësive të ndryshme etnike dhe religjioze, të cilat, megjithatë, nga kohërat e lashta kanë mësuar të jetojnë bashkë, të komunikojnë dhe t'i respektojnë dallimet mes vete. Në këtë kontekst, konsideroj se në raport me trashëgiminë kulturore, lirisht mund të flitet për një kulturë universale. Në këtë drejtim, trashëgimia e gjithëmbarshme e palëkundshme kulturore në Maqedoni paraqet një bazë e mirë për përparimin e karakterit multikultor të përditshmërisë dhe rrethimit tonë, si dhe luajtjen e rolit të rëndësishëm për kapërcimin e zbrazëtirave mes njerëzve. Interaksioni mes kulturave dhe etnikumeve të ndryshme gjithnjë ka qenë një karakteristikë e veçantë për nënqiellin tonë. Duhet të përpiqemi që përmes veprimtarive tona themelore të kontribuojmë për ruajtjen e heterogjenitetit kulturor, që paraqet pasurinë më të madhe për të gjithë qytetarët në RM, nga shkak se niveli i zhvillimit kulturor është faktor kyç në proceset integruese të vendit. Së këndejmi, Ministria e Kulturës me gjithë potencialin në këtë konstelacion të ngjarjeve do të përpiket për gjithë atë që nga e kaluara ka mbetur si dëshmi në këtë pjesë të tokës, gjithë atë që afirmon shkallën e lartë të zhvillimit të civilizimit, ta ruajë, ta paraqesë dhe ta ndajë me botën. Në këtë drejtim dhe në këtë frymë konsideroj se edhe kjo konferencë do të japë kontributin e vet të paçmueshëm.

Faleminderit.

NAIM HALIMI,
ITSHKSH – Shkup

TRASHËGIMIA KULTURORE E SHQIPTARËVE NË MAQEDONI PASURI E RAJONIT DHE EVROPËS

Trashëgimia kulturore e shqiptarëve në Maqedoni, me plot të drejtë mund të thuhet se nuk është vetëm e atyre që e kanë krijuar (shqiptarëve), por edhe e mbarë rajonit, popujve të Ballkanit, por edhe Evropës në tërësi. Studiuesit tanë, madje jo vetëm ata, kanë konstatuar me të drejtë në bazë të fakteve, se kultura shqiptare është antike dhe me vlerë të madhe historike, e trashëguar nga të parët tanë Ilir, respektivisht fisi i tyre dardan, i cili me shekuj jetoi në këto treva, ku jetojnë sot shqiptarët në Maqedoni. Dëshmi të këtij mendimi janë veprat e krijuar prej tyre, si ato materiale ashtu edhe ato shpirtërore, të shkruara nga autorë antik dhe të dëshmuara nga artefaktet historike, të gjetura gjatë gërmimeve arkeologjike në qytetet: Heraklea, Stobi, Skupim, në Dardani, sot trualli shqiptar në Maqedoni, Dollogozhdë të Strugës, në Hisarë të Tetovës, Likovë të Kumanovës e në shumë vendbanime tjera, të hulumtuara qëllimisht apo të gjetura rastësisht. Kjo kulturë karakterizohet për lashtësinë e traditave dhe për veçoritë etnike që ka, që vërehet qartë në arkitekturë, në qytete të rethuara me mure mbrojtëse, me porta e kulla të shumta, në sheshe, stadiume, palestra, në shtëpitë e aristokracisë, enë, vegla të punës, armë, stoli, veshje dhe në zbukurimin e trupit, të punuara prej materialeve të ndryshme, prej leshi, lini dhe hekuri, bronzi, argjendi e ari. Ilirët si punëtorë trima që ishin, shqu-

heshin edhe për mikpritje në festa e gosti, në këngë dhe në valle, në ndërtimin dhe pëdorimin e veglave muzikore, të fyellit e lahutës, në dijen e mjekësisë popullore, shkollim, armatim, në artin luftarak, etj.

Një traditë e jetës së tillë kulturore ilro-shqiptare, në trojet tona vazhdoi edhe më vonë në mesjetë, madje jo vetëm te aristokracia, te prijësit e fiseve siç ishin Progonët e Gropajt (në Ohër), por edhe te mbarë populli shqiptar. Nga dora e mjeshërve shqiptarë, si për shembull e Onufrit dhe djalit të tij Nikolla e vëllezërve Zografi u punuan shumë vepra interesante nëpër kishat e Maqedonisë së sotme, si bie fjala pikturat dhe ikonografite në Zërzë të Prilepit dhe në Slepçe të Demir Hisarit.

Rëndësi të veçantë kanë edhe veprat e rilindasve tanë që kanë punuar këtyre anëve, si Pjetër Bogdani në Shkup, Josif Bageri etj., të cilët japin shumë jo vetëm për ndërtimin e identitetit ilir-arbëror-shqiptar, por edhe për mbarë qytetërimin ballkanik e më gjerë. Me vlerë të veçantë janë edhe objektet tjera fetare si teqetë e xhamitë, të ndërtuara anekënd trevës shqiptare në Maqedoni. Një vlerë të veçantë ka edhe Çarshia e Vjetër e Shkupit, me monumentet kulturo-historike, fetare e kombëtare, me Kullën (Konakun) e Vilajetit të Kosovës me konaqet tjera rreth saj, që ishin njëherit edhe vatër e Lëvizjes Kombëtare, për shqiptarët në atë kohë, ndërsa pasuria jonë kulturore-historike në këtë kohë.

Vlerat e këtyre kulturore, nga ana e shqiptarëve në Maqedoni, deri tani pak janë hulumtuar për shkaqe të njohura, ndërsa të tjerët që kanë punuar në këtë drejtim, fort pakë i kanë kushtuar rëndësi kësaj veprimtarie, madje një pjesë të saj e kanë shtrembuar, e shumë vlera të saj i kanë përvetësuar. Megjithatë pjesa më e madhe e trashëgimisë kulturore e shqiptarëve

në Maqedoni ka shpëtuar falë popullit, që e ka krijuar, e ka ruajtur dhe e ka kultivuar, brez pas brezi deri në ditët tona.

Sa i përket ruajtjes, kultivimit dhe studimit të trashëgimisë kulturore të shqiptarëve të ne në Maqedoni, në krahasim me atë materiale, është bërë diçka më shumë për të parën, shpirtëroren, kuptohet gjithnjë si rezultat i kujdesit të vetë shqiptarëve, sepse institucionet e shtetit e sidomos Drejtoria e Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore, që ka detyrë këtë veprimtari, s'ka bërë thuajse asgjë për kulturën shqiptare, ndonëse edhe në këtë Drejtori, janë derdhur shuma të mëdha parash edhe nga taksapaguesit shqiptar. Këto rezultate optimale në fushën e kulturës shqiptare, janë arritur kryesisht falë angazhimit të studiuesve shqiptarë, jashtë institucioneve, nga vetë dëshira e tyre për të studiuar, për kënaqësinë e tyre ose për tu avansuar në shkencë, për tituj magistrature apo doktore. Sido qoftë këta studiues entuziast, që i ka pasur pothuaj çdo zonë e banuar me shqiptarë kanë mbledhur një numër të madh të krijimtarisë shpirtërore si mite, legjenda, përralla popullore, anekdoda, kash e lashe, magji, bekime, mallkime, ofendime sharje, përshëndetje, veshje, këngë, valle e instrumente popullore, të folme popullore, lojërat popullore, simbolet, lutjet, shakatë, reçetat e përgatitjes së ushqimit, solemnitetet dhe ritet gjatë ditëve të veçanta, duke filluar nga festat e motmotit deri te ditëlindjet, ritet e lindjes, të martesës e të vdekjes, etj.

Këta njerëz me vullnet e me mund të madh, arritën të hulumtojnë, të grumbullojnë dhe të publikojnë, një pjesë të këtij thesari kulturor të shqiptarëve në Maqedoni, si puna e Prof.dr. Fadil Sylejmanit në Malësinë e Tetovës apo e Edibe Selimit në Pollog, e Prof.dr. Nebi Dervishit në Strugë dhe e shumë të

tjerëve, punimet e të cilëve u botuan në revistën „Jehona,, dhe në gazetën „Flaka,,.

Një kontribut të madh në këtë veprimtari po jep prej theme—limit edhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, respektivisht punëtorët shkencor të tij dhe bashkëpunorët sdudiuës të kësaj kulture, duke publikuar punimet e tyre në revistat e e këtij Instituti „Studime Albanologjike,, dhe në„Skupi,, si dhe duke organizuar simpoziume e konferenca shkencore.

Nga kjo që u tha shkurt mund ta nxjerrim një konstatim, se krahas kësaj pune të madhe e të mirë që u bë për etnokulturën e shqiptarëve në Maqedoni, mbetet edhe shumë për të punuar, sidomos në fushën e vjeljes së materialit në popull, i cili e krijoi dhe e ruajti atë, pa të cilin studiumi i kësaj kulture nuk do të mund të bëhej.

QEMAL MURATI,
ITSHKSH – Shkup

GJUHA ËSHTË NJË TRASHËGIMI

Në traktatet e tij filozofike, filozofi epokal vjenez Ludwig Wittgenstein (*Tractatus logico-philosophicus*) e krahason gjuhën dhe zhvillimet historike brenda saj figurativisht me një qytet të vjetër:

“Gjuha mund të krahasohet me një qytet të vjetër, ku bashkekzistojnë rrugica dhe sheshe, shtëpi të reja dhe të vjetra, shtëpi me pjesë të ndërtuara në kohë të ndryshme dhe rreth tyre një numër i madh lagjesh të reja periferike, me rrugë të drejta e të parregullta e me shtëpi standarde”. Dhe, ja pse gjuha nuk është vetëm një formë e shprehjes apo një mjet komunikimi, por është dhe një vlerë që kemi trashëguar nga të parët, sikurse kemi trashëguar dhe doket, zakonet, kulturat, qytetet, etj.

Pra, *çdo gjuhë është një trashëgimi*, siç thoshin njerëz të famshëm dikur, midis tyre edhe Ferdinand de Saussure, krijuesi i lingistikës moderne. Po ashtu, *çdo gjuhë që zhduket është një pasuri që humbet një pjesë të njerëzimit që hesht përgjithmonë. Për më tepër: “Gjuha nuk është vetëm një çështje e drejtshkrimit dhe e drejtpërdorimit. Gjuha është qëndrimi ndaj traditës, detyrimi për të ardhmen tonë. Gjuha është një çështje e nderit dhe dinjitetit, një çështje e ligjshmërisë. Gjuha është një nga simbolet, siç është flamuri, siç është stema, siç është himni kombëtar. Edhe më shumë se kaq. Absolutisht: gjuha është atdheu i fundit, siç ka qenë thelbi i ekzistencës,*

kur nuk kemi pasur atdhe në kuptimin e një shteti të organizuar” (Mitanoski 2014).

E, në hartën e gjuhëve të botës, gjuha shqipe është pjesë e kësaj trashëgimie nga më të qenësishmet. Gjuha shqipe që flasin sot rreth 7 milionë shqiptarë është një shenjë me shumë të shënjuar thelbësorë, dhe që si e tillë paraqet trashëgiminë kulturore botërore. Në radhë të parë, duke u dhënë shqiptarëve edhe emrin, *“Ajo është garancia që ne jemi shqiptarë, është si ai thesari që shtetet mbajnë të groposur në banka për të garantuar ekzistencën e tyre. Kombi s’ka gjë tjetër që e mban të bashkuar, veç asaj”*, siç shprehet me intuitë të hollë shkrimtari Ismail Kadare.

3. Një shënjuar (signifia) të veçantë që mbart kjo gjuhë është se shqipja, bashkë me greqishten e vjetër dhe armenishten, janë gjuhë më vete në familjen e lashtë indoevropiane, që nuk kanë lidhje afrie me gjuhë të tjera të kësaj familjeje. Dhe, duke qenë një gjuhë e tillë krejt e veçantë, nuk ka qenë e rastësishme që me këtë gjuhë të preokupoheshin linguistë dhe dijetarë më elitarë të kohës, si gjenitë e kalibrit botërorë: Gottfried Wilhelm Leibnitz, Franc Bop, Gustav Meyer, Gustav Weigand, Norbert Jokl, Holger Pedersen, August Dozon etj. Filozofi i madh gjerman Gottfried Wilhelm von Leibniz (1646 – 1716) qysh disa shekuj më parë do të shprehej: *“Nëse doni të zbuloni historinë para Krishtit dhe shkencat e asaj kohe, duhet të studioni gjuhën shqipe!”* (Gjoshi 2013: 355). Ndërkaq, një kërkimtar tjetër, August Dozon, në hulumtimet e tij folklorike e filologjike, do të veçonte: *“Gjuha shqipe, që i dallon shqiptarët nga pjesa tjetër e botës, ngjante se duhej të jepte çelësin e prejardhjes së tyre dhe të zbulonte se prej nga rridhnin ata. Por kjo gjuhë, mozaik i çuditshëm copash që ngjajnë të mbledhura nga çdo anë, nuk ofron në pamje të*

parë veçse një enigmë tjetër të çuditshme dhe të padeshifrueshme”. Gjuhëtari amerikan Eric P. Hamp, që shquhet për kontribute gangullore në albanologji, shqipen e konsideron si dashuri personale: “*Shqipja është dashuri personale e inja. Është strumbullari rreth së cilës sillet gjithë gjuhësia ballkanike. Është themeli i sprachbundit ballkanik*” (“*Albanian is a personal love of mine. Albanian is the pinion on which Balkan linguistics all rests. Albanian is what is the fundament of Balkan Sprachbund.*”). “*Sllavishtja e vjetër dhe gjuhët baltike – edhe lituanesët do binin dakord, u pëlqen apo jo – janë si binjakë. Por këta binjakë nuk do mund të rrinin bashkë pa trinjakun e tyre, shqipen*” (Hamp).

Në shqipen e sotme janë ruajtur shumë fjalë të botës së lashtë paraindoeuropiane: *alban, mal* (G. R. Solta), *shegë, vresht*; mënyra e numërimit vegesimal me *njëzet (njëzet, dyzet, në disa të folme te arbreshët e Italisë edhe trezet “60” e katërzet “80”*); Nga bota antike, kjo gjuhë ka ruajtur fjalë nga greqishtja e vjetër (*lakër, drapër, pjepër, mokën – makinë për shtypjen e grurit*), dhe nga latinishtja.

Gjuha shqipe është atdheu i vërtetë i shqiptarëve. Ndonëse e pashkruar deri në shek. XVI, ajo arriti ta mbronte elementin shqiptar përpara asimilimeve të mëdha. Kjo gjuhë në antikitet është folur edhe në territore ku sot nuk ka më popullatë shqiptare, si p.sh. edhe në Maqedoninë qendrore e lindore, sikurse e dëshmojnë këtë disa toponime me atributin *Arbanas*. Pra, shqipja na jep dëshmi të sigurt se atdheu i sotëm gjeografik i shqiptarëve ka pësuar restriksion, e jo ekspansion (E. Çabej).

Në këtë kuptim, atdheu i shqiptarëve është gjuha shqipe dhe jo shtetet a viset shqiptare. Ngase shtetet edhe mund të shformohen, por gjuha është ajo që mbetet. E humbe gjuhën, ke humbur gjithçka. Këtë postulat e shpreh edhe shkrimtari i

njohur hebre Amos Oz, i cili kur e binte puna të fliste për gjuhën dhe atdheun, përdor këtë paralelizëm të goditur: “*Atdheu im nuk është Izraeli, por fjalorët dhe liria. Mund ta nënvizoni se atdheu im i parë është fjalori...Atdheu im është gjuha ime...*”.

*Gjuha dhe ideologjia linguistocide: e kujt gjuha,
e atij dhe shteti*

Përveç që shërben si mjet marrëveshjeje, gjuha ka dhe përmasën ideologjike. “*Gjuha është mbase vegla më e mirë e nacionalizmës. Bile për disa shoqëri idealizma kombëtare nuk mund të gjejë vegël më të puthitur e më të goditur që ta përdorë për qëllimet e veta*” (Branko Merxhan: 160). Tek popujt e tjerë, si p.sh. te serbët, kanë krijuar deri dhe elaborate për zhdukjen e gjuhëve të popujve të tjerë. Të kujtojmë këtu amanetin e Stefan Nemanja, që i linte të birit në prag të vdekjes: “*Vendet dhe shtetet nuk pushtohen vetëm me shpatë, por edhe me gjuhë*”. Nga kjo ideologji linguistocide serbët nuk kanë hequr dorë as sot. E, nga ana tjetër, gjuha shqipe nuk është përdorur asnjëherë si vegël kundër gjuhëve të tjera. Përkundrazi, ajo ka qenë halë në sy e pushtuesve dhe e fqinjve. Këtë e dëshmon sot edhe statusi zyrtar i gjuhës shqipe në Maqedoni, ku gjuha i ndan shqiptarët dhe maqedonasit në dy kategori qytetarësh, – si shenjues se shqiptarët nuk janë të barabartë me maqedonasit:

“Te maqedonasit dhe te shqiptarët ka dy kategori qytetarësh. Ligji për përdorimin e gjuhëve është i zbatueshëm vetëm në pushtetin lokal, në pushtetin qendror në ato komuna ku shqiptarët janë nën 25% nuk kanë të drejtë të drejtohen në gjuhën shqipe. Të marrim një shembull, kemi dy të burgosur, sepse fatkeqësisht të burgosur ka shumë shqiptarë, njëri nga

Ohri dhe njëri nga Struga. Eh, tash, drejtorit shqiptari nga Struga mund të drejtohet edhe në shqip, ndërsa ky nga Ohri jo, edhe pse të dy janë shqiptarë. Ose ke maqedonas nga Strumica i cili ka vetëm një gjuhë zyrtare dhe maqedonas nga Struga i cili ka dy gjuhë zyrtare! Eh kjo nuk mund të quhet karakter unitar i shtetit. Nëse duam karakter unitar atëherë gjuha shqipe duhet të jetë zyrtare edhe në Strumicë, pa marrë parasysh a ka nevojë ose jo atje. Kushtetuta duhet të jetë e barabartë për të gjithë, sepse Maqedonia nuk është shtet njënacional, por është shtet multi-etnik” (Ziadin Sela, kryetar i komunës së Strugës, intervistë për portalin “Faktor”, “ALMAKOS, 17. 8. 2014). Por, edhe në qytetin e Strugës me shumicë shqiptare, në manifestimet që realizohen në nivel qendror dhe me karakter ndërkombëtar, siç është festivali tradicional “*Mbrëmjet Strugane të Poezisë*”, gjuhë zyrtare është vetëm maqedonishtja dhe anglishtja, por jo dhe shqipja, krejt kjo sipas ligjeve dhe Kushtetutës së Maqedonisë. Për shkak të kësaj problematike, manifestimi prestigjioz ndërkombëtar është bojkotuar dy herë radhazi nga kreu i komunës së Strugës Zijadin. Por kjo nuk e zgjidh çështjen. Dhe përderisa në shtetin më të ri të rajonit, në Republikën e Kosovës, serbishtja me 5 për qind të folësve të saj është gjuhë zyrtare në përdorimin publik në të gjithë territorin e Republikës, në shtetin e quajtur Republika e Maqedonisë shqipja me 25 për qind (sipas statistikave gjuhësore) është gjuhë zyrtare lokale, edhe aty me kufizime. Logjika e shtetit maqedonas edhe në aspektin gjuhësor funksion në këtë: “*Gjuha jam unë*”, domethënë shteti jam unë. E kujt gjuha, e atij dhe shteti”. Pabarazia në gjuhë është nuk është thjesht vetëm çështje filologjike, por është pabarazi edhe në rrafsh të tjera shoqërore, në ekonomi, në punësim etj. Çfarë statusi ke

në gjuhë, atë status do të kesh edhe në shoqëri. *Në vende normale, gjuhët shërbejnë që njerëzit të kuptohen, jo për të krijuar probleme*” (Mariano Rajoy). Por duket se Maqedonia është e destinuar të ecë gjithmonë në linjën e kundërt.

Çfarë bëjmë ne për shqipen?

Përderisa shqipja shpreh shumë gjëra: na ka dhënë emrin dhe identitetin tonë kombëtar, e na ka ruajtur nga asimilimi, atëherë mund të shtrohet pyetja ç'bëjmë ne për gjuhën shqipe dhe për linguistikën shqiptare? Përgjigjja më e saktë mund të jetë – pak ose aspak!

Në fushën e fjalorëve nacionalë, ne sot kemi *Fjalorin e gjuhës shqipe* (2006), me rreth 48.000 fjalë, ndërsa edhe maqedonishtja si gjuhë rajonale ka fjalor standard në katër vëllime me 100.000 fjalë.

Si komb kemi formuar standardin gjuhësor të fundit në Ballkan dhe në Evropë (1972), dhe, si për paradoks, ka zëra që kërkojnë kontestimin e standardit dhe ristandardizim të shqipes standarde!

Ne sot kemi prirje të mohojmë gjithçka që është krijuar në fushën e gjuhës shqipe dhe të albanologjisë shkencore me aq pasion e dije dhe në vend të saj të mbëltojmë linguistikën e keqe, joshkencore, përfshirë këtu dhe etimologjinë joshkencore, mohimin e standardit jo mbi baza të shëndosha filologjike, por nga tarafet krahinariste. Çështja e gjuhës paraqet vërtetë një temë shumë interesante. *Një kryeministër i Bullgarisë, Aleksandar Stamboliski*, në fillim të viteve 20 të shekullit që doli u akuzua nga ana e një pjese të madhe të popullit si tradhtar, sepse deshi të hiqte një nga gerrat e panevojshme të alfabetit bullgar /Ѣ/, për thjeshtimin e

alfabetit (Merxhan 1996: 158). Dhe ajo punë i kushtoi atij me dorëheqje. Kurse tek ne, kryeqeveritari e qeveritarë tanë të deridjeshëm janë përpjekur të punonin për rrënimin e standardit të shqipes së sotme, duke organizuar deri dhe konferenca si ajo e Durrësit “*Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*” (2010) (Tiranë, 2011), me projekte për krijimin e standardeve krahinoriste. Në fakt, politikat e kësaj konference në koncept janë antistandardiste, prandaj dhe si e tillë ajo u bojkotua nga shumica e institucioneve, e gjuhëtarëve dhe intelektualëve shqiptarë. Dhe puna e saj nuk qe veçse një doç.

Në Shqipëri dhe në Kosovë gjuha shqipe sot sikur nuk vlerësohet sa duhet, shkelet e nëpërkëmbet e artificializohet, kurse në plëngun e saj në Maqedoni shqipja trajtohet si gjuhë e rendit të dytë. Nga “shtëpia e të qenit” shqiptar, gjuhën shqipe duket sikur e kemi kthyer në një “askujtland, gjuhë të askujt”, kur me këtë gjuhë merret gjithkush dhe s’merret askush si duhet. Duke parë gjendjen e tillë të gjuhës, një blogist do të shprehej me zemëratë: “*Shqipëria nuk ka asgjë, edhe gjuha mbaroi. Tani s’na mbetet gjë tjetër vetëm të thërrasim fort: rroftë Atdheu ynë Anglia, se gjuhën e saj po flasim e po shkruajmë sot*”.

Çfarë bëjmë ne sot për shqipen? Kjo është pyetja që duhet t’i bëjmë vetes sonë çdo ditë, në institucionet tona dhe në shoqërinë tonë. Gjuha shqipe nuk është vetëm një mjet komunikimi, por është edhe art, edhe pikturë, edhe muzikë, edhe skulpturë, edhe identitet. Si një monument i lashtë kulture, shqipja nuk mund të mbrohet vetvetiu, por duhet të vihen të gjithë shqipfolësit në mbrojtje të saj, duke përdorur fjalën e bukur shqipe në vend të fjalës së huaj, theksin e shqipes në vend të theksit të huaj, gramatikën e shqipes në

vend të gramatikës së huaj. Gjuha më shumë se çdo gjë tjetër është “prodhim vendi” që nuk duhet ta lëmë të bastardohet e të birret siç edhe e kemi lënë, me mospërdorimin korrekt të saj. Ndaj, ruajtja e pasurisë gjuhësore të shqipes duhet të jetë detyrë e çdoditshme sikurse ruajtja e thesarit të bankës kombëtare nga ana e shtetit.

BURIMET E LITERATURËS

Gjoshi 2013 = Gjoshi, Ragip, *Ndihmesa e albanologut rumun Grigore Brënkushi filologjisë shqiptare*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 32/1, Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2013.

Merxhan 1996 = Merxhan, Branko, *Formula të neo-shqiptarizmit, Apollonia*, Tiranë, 1996.

Mitanoski 2014 = Mitanski, Vele, *За јазикот и матковината се работи*, “Utrinski Vesnik”, 1. 7. 2014).

ZEQIRJA NEZIRI,

Fakulteti i Filologjisë “Bllazhe Koneski” – Shkup

LAHUTARI KADRI ZYMERI

Konteksti. Për këtë konferencë do të flasim vetëm për një lahutar, i cili meriton vëmendjen e studiuesve jo vetëm si njëri preja rapsodëve të rrallë të gjallë të këndimit epik shqiptar, por sidomos për kujtesën e freskët, aftësinë e të kënduarit dhe veçanërisht për aftësinë e thurjes së vargjeve, të ngritjes së veprimit dhe të krijimit të situatave përshkrimore të veprimit të personazheve.

Ekzistimi i gjallë i këngëve të Eposit Heroik Shqiptar në fillim të decenies së dytë të shekullit të njëzetentjëtë është një dëshmi e fortë që kundërgargumenton shkrimet tendencioze të para një shekulli se shqiptarëve të Maqedonisë i mungojnë këngët epike, me çka atyre dëshirohej t’u mohohet lidhshmëria e drejtpërdrejtë me trungun kombëtar shqiptar. Ky material i pasur i këngëve të Eposit Heroik Shqiptar i regjistruar në truallin e Maqedonisë është argument i padyshimtë shkencor që dëshmon jo vetëm autoktoninë e shqiptarëve në këto troje, bind opinionin shkencor shqiptar e botëror jo vetëm për ekzistimin e gjallë të këtij tipi të këndimit, por bind edhe në pandashmërinë e pashkëputshmërinë shpirtërore nga trungu kombëtar dhe, në këtë kontekst, kanë rëndësi të veçantë e të madhe shkencore jo vetëm për këndimin epik kombëtar të Eposit Heroik Shqiptar, jo vetëm për shtrirjen e tij horizontale deri në kufijtë më të skajshëm të kombit, por janë edhe një dëshmi e pakontestueshme shkencore për ekzistimin, je-

tesën dhe funksionimin e gjallë të këndimit epik shqiptar në përgjithësi.

Nxitja

Shkak për këtë kumesë është projekti “*Gjendja e tashme e Eposit të Kreshnikëve në pesë vende të Ballkanit*” që realizohet nga Instituti Albanologjik i Prishtinës me përkrahje të MASH të Kosovës. Për t’i përmbushur kërkesat e këtij projekti të gjendjes së tanishme të Eposit Heroik Shqiptar arritëm në të dhënë se përkrah rrudhjes së subjekteve, u paraqit zgjerimi dhe plotësimi me subjekte të reja, sidomos sa i përket ekzistimit të mbijetojave të tij ndër shqiptarët e Maqedonisë.

Mbështetja teorike dhe lashtësia e Eposit Heroik Shqiptar

Në fund të tetorit (20–22) të vitit të largët 1983 në Tiranë u mbajt një simpozium tematik, i cili kryekëput i është kushtuar këndimit të gjatë epik te shqiptarët. Në materialet e këtij simpoziumi, nga fusha më të ndryshmet (historike, arkeologjike, mitologjike, etnologjike, juridike, shoqërore, kulturore, krahasimtare: letrare e gjuhësore) u shtruan, u sheshuan, u rrahën dhe u ndriçuan aspekte të shumta që ky epos, nga periudhat më të hershme primordiale gojariht i ka bartur me vete dhe i ka sjellë të gjalla deri në ditët tona.

Në Simpoziumin e përmendur të Tiranës u vendos baza teorike e Eposit Heroik Shqiptar, u vërtetuan dhe historikisht u saktësuan pikëpamjet e hamendësuarra, për atë kohë të Bernardin Palajt e të Ernest Koliqit të viteve të tridhjeta të shekullit të kaluar. Kështu, sa i përket jetesës gojore mbi dymijëvjeçare të këtij Eposi, që tani po shkel në mijëvjeçarin e tretë u konstatua se përgjatë shekujve ai arriti t’i rezistojë, të qen-

drojë e të mbijetojë i paprekur mbi të gjitha stuhitë, që sillnin sundimtarët e ndryshëm, që përpiqeshin t'i shkelnin e t'i shtypnin shqiptarët.

Ashtu si Bjeshkët e Nemuna, do të shprehej Qemal Haxhihasani që pa u mekur i kanë rezistuar fatkeqësive natyrore, ashtu edhe Eposi, si njëri prej ngrehinave madhështore kombëtare arriti ta mbjellë në vijimësi, ta kultivojë e ta ruajë të paprekur etninë, traditën e rezistencës e të trimërisë, të burrërisë e të guximit, të sakrificës e të vetëmohimit.

Në Eposin Heroik Shqiptar dy janë temat kryesore që kanë brumosur Mujin e Halilin me shokë: ruajtja e trojeve dhe e nderit familjar. Ruajtja dhe mbrojtja e tokës dhe e kullosave nga uzurpimet e sundimtarëve të llojllojshëm kërkonte trimëri e burrëri, guxim e sakrifica, ashtu si nderi vetjak e familjar kërkonte të ruhej e kultivohej nga përkeqja e këtyre sundimtarë.

Jetesa aktive dhe pasive e EHS

Në jetesën e Eposit Heroik Shqiptar dallohen dy periudha të mëdha (aktive dhe pasive), nëpër fazat e të cilave shtresohen koha e lindjes dhe e formimit, për të vijuar me kohën e vijimësisë e të mbishtresimit, të kontaminimit e kultivimit, për të arritur kohën e konstituimit e të konsolidimit si formë e ngjeshur poetike. Tri etapat e jetës së tij aktive përputhen me të trija periudhat e Mesjetës (të hershme, të mesme dhe të vonë). Qemal Haxhihasani do të theksojë se mbishtresimi në Eposin Heroik Shqiptar, në mënyrë metaforike është i ngjashëm me shtresat e borës së Bjeshkëve të Nemuna, të cilat e shtresojnë njëra tjetrën pa pritur të shkrihet shtresa e parë. Me përfundimin e Mesjetës mbyllet edhe jeta aktive e Eposit Heroik Shqiptar.

Në periudhën pasuese, në atë të jetës pasive, po ashtu paraqiten katër faza kohore: e sundimit osman, e gjysmës së parë e të dytë të shekullit të njëzetë; ndërkaq, faza e katërt është kjo që po e jetojmë, në të cilën, si rezultat i zhvillimit të përgjithshëm shoqëror e teknologjik jemi dëshmitarë të zhdukjes së tij të përditshme.

Vatra e këndimit epik në Karadak të Shkupit

Në këtë projekt përgjithësisht u konstatua se gjendja e tanishme e rapsodëve dhe e këndimit epik të tipit të Eposit Heroik Shqiptar në trevat e Maqedonisë të banuara me shqiptarë është e ngjashme me anët e tjera të kombit: numri i rapsodëve shumë është zvogëluar, ashtu si është rrudhur edhe fondi i krijimeve të tyre. Gati të gjithë kanë ndërruar vendbanimet: nga fshatrat malore janë ulur në qytete. Por për dallim nga krahinat e tjera kombëtare të shqiptarët e Maqedonisë paraqet interes të madh shkencor zbulimi i vatrave të reja në të cilat kultivohet këndimi epik i tipit të Eposit Heroik. Njëra prej këtyre vatrave është edhe malësia e Shkupit e njohur si Karadaku i Shkupit, ku graviton edhe fshati Tanushë, prej ku e ka origjinën subjekti ynë.

Kadri Zymeri (1949)

Kadri Zymeri (1949) është nga fshati Tanushë e Shkupit. Nga biseda që kemi pasur me të mësojmë se i përket tipit të parë të formimit të rapsodëve, të cilët *‘shkollën e këndimit epik’* e kanë trashëgimi familjare dhe pjesërisht tipit të dytë, të cilët *‘shkollën e këndimit epik’* e kanë marrë dhe janë formuar në mjedis shoqëror. Përveç këndimit, këta rapsodë një pjesë të këngëve i recitojnë dhe një pjesë tjetër i tregojnë në prozë.

Kadri Zymeri ka një fond shumë të pasur që i afrohet fondit të rapsodëve shembullorë. Fondi i tij i përgjithshëm i afrohet 10.000 (dhjetë një vargjeve). Në këtë fond shumë të pasur përfshihen këngë lirike, balada dhe këngë epike si të atyre të Eposit Heroik Shqiptar, ashtu edhe të atyre me temë historike. Në këtë punim do të flasim vetëm për tri këngë të Eposit Heroik Shqiptar, të cilat në formën e inçizuar kapin këtë hapësirë kohore: Niko Bajraktari e Mujo Bylykbashi (49 min.), Ramë Bajraktari (43.5 min.) dhe Muji e Pajo Harambashi (23.24 min). Analiza e fondit të tij krijues të këtij tipi këngësh tregon se te ky rapsod ruhen të gjitha elementet e teknikës epike:

(1) Në aspektin meloritmik është ruajtur pushimi midis situatave, skenave e episodave.

(2) Në aspektin strukturor kompozicional të teksteve është vërejtur se:

(a) janë ruajtur hyrjet tradicionale;

(b) është ruajtur binariteti i ndërtimit të veprimit në dy plane: herë në frontin e luftëtarit; dhe herë në frontin e kundërshtarit;

(c) janë ruajtur dhe janë kultivuar më fort ato motive, të cilat kishin të bënin me mbijetesën: mbrojtjen e trojeve etnike, ruajtjen e identitetit e të nderit, kultivimin e dinjitetit; mandej luftimin e dukurive dhe ceneve e dobësive të ndryshme morale, si: besëprerja e besëshkelja, tradhëtia e nënçmimi i qyqarllëkut, si dhe mungesa e vigjilencës.

(ç) Në aspektin strukturor këngët që kanë për motiv bëmat e Mujit janë më të shkurta, sepse rapsodi shumë pak ka lejuar të zgjerohet subjekti i tyre me elemente të reja. Si duket duke e konsideruar Mujin si hero të stërlashtë të traditës i është shmangur njolloshjes së personalitetit të tij dhe kanë dashur ta ruajnë formën arkaike të këngëve.

(ç.1) Përballë kësaj dukurie te këngët që në bërthamën e tyre kanë pasur bëmat e heronjve të tjerë, si Ali e Zuku Bajraktarit, janë zgjeruar në strukturë dhe njohin kontaminimin, qepjen e motiveve edhe të këngëve të tjera. Në këto këngë vërehet një shtrirje në gjerësi e lëndës, shtrirja e veprimit të heronjve; pasurimi me bashkëlloftëtarë të tjerë dhe kontaminimi e bashkimi i motiveve të një kënge ose të bëmave të një heroit tjetër me ato të heronjve të tretë.

(d) gjerësia përshkrimore: numri i madh i heronjve, tejkalimi i pengesave, zgjidhja e obligimit;

(dh) *gjerësia epike*: paralelizmi, dialogu epik (lufta me fjalë, biseda me kalin),

(e) përsëritja epike: skena, situata, episode;

(ë) formulat:

(1) *përsëritja e fiksioneve gjuhësore* (me një ose dy fjalë dhe me vargje e fragmente në prozë); dhe

(2) *përsëritja si teknikë rrëfimore*;

(f) *kompozicioni*: shkallëzimi (pranë një veprimi kryesor e-kzistojnë një numër i pakufishëm i veprimeve dytësore), ndërfitjet episodike;

(g) *gërshetimi* i stilit të këndimit me vargënimin;

(gj) përdorimi i fjalëve poshtëruese, dialogu eksplikativ (sin-kronik dhe diakronik);

(h) pushimi midis njësive përmbajtjesore;

(i) përfundimet epike.

Përfundim

Në periudhën midis dy luftërave botërore në shkencën folklorike, sidomos sllave jugore ishte mbjellë pikëpamja, se te shqiptarët e Maqedonisë, me kohë i ishin zhdukur këngët epike dhe se te këta mund të gjendej vetëm ndonjë baladë.

Kontekstualisht atëherë kur mendohej se ky tip këndimi është zhdukur kaherë dhe janë shkukur përgjithmonë rrënjët e tij, ashtu siç janë zhdukur disa dukuri të traditës jetësore, ndodhi e kundërta: midis tyre jo vetëm që ekzistojnë mbijetoja të këndimit të Eposit Heroik Shqiptar, por ky tip i këndimit tek ata akoma është i gjallë dhe i freskët.

Në fund fare: Për rëndësinë dhe vlerat e shumta të kësaj trashëgimie mbi dymijëvjeçare dhe për kujdesin në ruajtjen e saj, Instituti e ka obligim moral dhe detyrë zyrtare të propozojë në organet përkatëse që z. **Kadri Zymeri t'i lidhet një pension kombëtar.** Me këtë akt nuk i dalim borxhit, por vetëm tregojmë interesimin, dashurinë, respektin dhe kujdesin tonë ndaj ruajtjes së kësaj tradite shumë të madhe kombëtare e ndërkombëtare.

Bibliografi:

ASANI, Bexhet (1996), *Ç'u këput një degë qarri. Këngë popullore nga fshatrat toske të Strugës*. Onufri, Elbasan.

ASANI, Bexhet (2003), *Zura trëndafil me vesë*, Strugë.

KROSI, Ibrahim (1984), *Këngë popullore lirike të Dervenit*, Flaka, Shkup.

LUTFIU, Mojsi (1988), *Prozë popullore dibrane*, Flaka, Shkup.

MURATI, Qemal (2000), *Këngë të moçme kërçovare*, Çabej, Tetovë.

NEZIRI, Zeqirja (1993), *Hrvati o Albancima*, Hrvatsko – albansko drustvo, Zagreb.

NEZIRI, Zeqirja (2010), *Epika gojore shqiptare*, Shkup.

OSMANI, Hafezat (1999), *Epikë popullore shqiptare*, Shkup.

SEJFULLA – REÇANI, Fehim (1989), *Këngë popullore të Gostivarit*, Flaka, Shkup.

TRUHELKA, Ciro (1905), *Arnautske price I – II*, Sarajevo.

TRUHELKA, Ciro (1942), *Uspomene jednog pionira*, Zagreb.

XHAFERI, Hamit (2003), *Epika popullore shqiptare e trevës së Kërçovës*, Voka – 4, Tetovë.

HAMIT XHAFERI,

*Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit,
UEJL – Tetovë*

EKZISTENCA DHE SHFAQJA E PARIMIT TË ZBUKURIMIT NË KËNGËT E KRESHNIKËVE TË TREVËS SË KËRÇOVËS

Epika heroike legjendare përfaqëson një kompleks poetik dhe etnokulturor, që përmledh vlera të shquara estetike. Këto vlera estetike përftohen jo vetëm nga përmbajtja heroike e këngëve të Ciklit të kreshnikëve, por nga mënyra si përcillet te marrësi ky krijim kaq i fuqishëm artistik. Dhënësi (në këtë rast rapsodi popullor i trevës së Kërçovës) ka mundur që gjithë këtë përmbajtje kaq të ngjeshur, e të mbushur me luftëra të gjata e të vazhdueshme, në një territor të caktuar, ta sjellë te marrësi i kohës së vet, por edhe të kohëve në vijim me finesë, me qartësi dhe thjeshtësi. Ai ka ditur të na sjellë të bukur nga ana poetike dhe muzikore.

Lind fare thjesht pyetja: Si ka mundur që në një krijim kaq të gjerë dhe të hershëm ky rapsod i kësaj treve të na e sjellë po kaq bukur?! Këngëtari popullor i trevës së Kërçovës, përveç parimeve të njohura dhe tepër të qartësuara në këtë krijim, ka zbatuar me shumë finesë dhe delikatesë *parimin e zbukurimit*. Kjo nuk është një dukuri e rrallë në krijimtarinë popullore shqiptare, por në këtë epos ajo nuk del në “sipërfaqe”, siç ndodh me lloje të tjera letrare, kënaqësinë e pranisë së zbukurimit e ndjen sapo bie në kontakt me këtë cikël madhështor, përkatësisht me këngën Qysh mi boni ne Savre kapidani: *Ih sa budall ene Savre të mi paske çen’ ene/ Ih me je pa*

ene ti mor Fatëjme turkinj/ E ti vesh' ene ajo mor petekatë e bajramit/ Ahej të zanë ethetë batil ty tetë-nantë vjet s'të lajn-o hej. Në këtë studim do të orvatemi të zbulojmë ku dhe si zbatohet parimi i zbukurimit, duke u ndalur në disa elemente të këtij krijimi dhe në këngët kreshnike që i këndon këngëtari dhe rapsodi popullor i trevës së Kërçovës, siç janë këngët: "Ç'u ngritë krali i Kralis'", ose (Bashi Muja), "Ç'u bo Bena tetë-nantë vjetë", ose (Beno Bajraktari), "Çysh mi boni Savre kapidani", "Emin Mixha a vjetrau", ose Emin Mixha.

Ashtu si në eposin shqiptar, edhe në ciklin e këngëve të kreshnikëve që këndohen në trevën e Kërçovës, si në çdo epos tjetër, koha (jo e formimit të eposit të kreshnikëve), por si nocion i shtrirë në hapësirë, vjen e shkon sipas një kalendari të ndryshëm nga kalendari njerëzor. Nuk është qëllimi i këtij studimi të trajtojë këtë çështje, për një arsye fare të thjeshtë: sepse ne jemi të bindur në autorsinë shqiptare të eposit të trevës së Kërçovës. Ai është jo vetëm pjellë e kohës kur u krijua, por krijim i të gjithë historisë së ekzistencës dhe mbijetesës së kombit shqiptar në përgjithësi. Ky cikël madhështor i kësaj treve, si vetë malet dhe historia jonë ka lindur si një këngë e vetëdijshme, si një mesazh dhe alarm i pavdekshëm i historisë heroike të popullit, si një mesazh që përcjell psikologjinë, dhe botëpërjetimin e tij origjinal. Në çdo qelizë, në çdo element të kozmosit tanë epik duket bota shqiptare, ku spikat mjedisi dhe relievi ynë gjeografik me bjeshkët e larta, me ashte, me lugje, kullota, mrize e kroje, rudina e shkëmbinj.

Më shumë se të gjitha anët e tjera përshypja e parë e jashtëzakonshmes që është realizuar nëpërmjet parimit të zbukurimit shfaqet te fuqia dhe përmasat fizike të heronjve kryesorë të këtij ciili, siç bie fjala pamjen dhe trimërinë e Bashi Mujit kundrejt kralit të Kralovës: *Ih me e pa mun-o ti mor Bashi*

*Mujinë/ Ahej të zënë ethetë tetë-nantë vjeto st'lajnun—o hej mor hej. Që në fëmijërinë tonë të hershme në kujtesën tonë ngrihet imazhi i panjes fizike të Mujit, Halilit dhe Tridhjetë agëve të Jutbinës. Krijuesi popullor për t'i bërë sa më të bukur, të paarritshëm dhe të jashtëzakonshëm ka punuar me kujdes nëpërmjet hiperbolës të na japë heronj të madhërisëm, këta heronj janë të ngjashëm dhe na kujtojnë heronjtë e pavdekshëm të “Iliadës”, heronjtë e eposeve të kontinentit, heronjtë biblikë dhe mitologjikë. Të ndalemi në këtë paraqitje dhe portretizim fizik të realizuar nga ana e krijuesit popullor të kësaj treve, veçanërisht te figurat kryesore të këtij cikli: *Ene Mujos ato mor një dru mas ja kan vue/ Ih druni ran ene një mi ok' na a kane/ Ih dymdhetë buj drunin s'munen me e hek/ Ahej ma hek drunin Muja si byku shtat—tet' vjet o hej.**

Muji dhe Halili janë të madhërisëm sepse kanë trupa gjigandë, kanë një forcë fizike dhe morale shpirtërore të jashtëzakonshme. Rapsodi i këtushëm popullor i përfytyron kreshnikët me përmasa kolosale, mekraharor tetëmbëdhjetëpëllëmbësh, me sy si grykë kazanesh, me opinga sa me fjetur një njeri, çibukun sa me i vu një kaci prushi sipri. Muji ngre shkëmbin njëmijëokësh, dridhen bjeshkët kur shkon me gjokun e tij fluturim, pi verë me bucelë dhe përnjëherë një ibrik me raki: *O ç'e maur Mujon ajo e shteu në shpëje/ Ih vrëjk e vrëjk ene ja për një ibrik me rakëj—e. Muji shërohet nga gjarpërinj fantastikë, shkul lisa qindravjeçarë. Ata hanë nga një dash në vakt, pinë verë me bucela, kafe me filxhan njëzetokësh, ngrenë në dorë shkëmbin njëmijë okësh, shkulin lisa nëntëqindravjeçarë, dridhen pyje e majat e bjeshkëve kur ata bërtasin: *O ene kullatë Mujitë ato ja kan' r'zue/ Ene motrnë e Mujitë ato ja patën plague/ Ih nanë e gru të Mujitë ato ja kan' marre.**

Nëse krijuesi popullor do të jepte heronj thjesht madhështor fizikisht, ky epos nuk do t'i mbijetonte erozionit të kohës dhe do të ishte thjesht një dëshmi e realizuar artistikisht mbi heronj madhështorë, që ne do të mendonim t'i përngjasonim me figurat e heronjve hyjnorë që kishin aftësinë e pavdekësisë. Pa dyshim ky epos nuk do të kishte mbërritur te njeriu i shekullit XXI, por thjesht do të ishte si armë e paraqitur në një muze historik. Ai vazhdon jetesën e tij, duke përcjellë te ne mesazhe dhe ide për të vazhduar ecjen tonë në rrjedhën e historisë duke mbartur në radhë të parë gjithë vlerat kulturore, shpirtërore dhe morale të trashëguar nga të parët tanë, të përcjellë nëpërmjet këtij krijimi vigan të popullit tonë.

Heronjtë e eposit tonë kanë tipare fizike, etnokulturore dhe shpirtërore të luftëtarëve shqiptarë, ku spikatin tiparet e tyre morale, siç janë: besa, burrëria, guximi, heroizmi, vetëmohimi. Ata kanë një forcë fizike dhe shpirtërore të jashtëzakonshme, janë të papërkulur dhe mbartin virtytet që janë kultivuar brez pas brezi në mjedisin gjeografik dhe etnokulturor shqiptar. Ata bëjnë një jetë aktive përmes së cilës tregojnë virtyte të larta morale, ndershmëri dhe urtësi, vetmohim e besnikëri, vullnet të papërkulur dhe karakter të fortë.

Eposi ynë nuk sjell vetëm gjurmët e lashtësisë së shekujve, por pasqyron fort mirë shumë nga cilësitë morale të popullit tonë. Një vend të gjerë zë pasqyrimi i tipareve dhe veçoritë etnopsikologjike të shqiptarëve të kësaj treve. Bota e gjerë dhe e larmishme e epikës sonë legjendare pasqyron mjedise të përcaktuara që ruajnë karakteristikat e veçanta të shqiptarëve si etni. Në një plan të përgjithshëm mund të thuhet se këngët e Ciklit të kreshnikëve që këndohen në trevën e Kërçovës janë himnizimi i forcës trupore, trimërisë, guximit dhe qëndresës në rrethana të vështira: *Hem ne Mujo sa shum na ka b'rtëjte/ Ih xhith çufartë*

*mor na kan zan' me hike/ Se bash Halili me shpatë ka n'jizet n'aj vretë/ Ahej Bashli Muja me dru ka n'jcin po n'aj myt o hej. Këto qenë kërkesat dhe idealet e kohës dhe të mjedisit shoqëror ku ishte krijuar dhe gjallonte ky cikël i këngëve kreshnike. Jo rastësisht edhe motra e Mujit do tu kundërvihet Xhelatçinjtë njësoj si vëllai i saj: *Of kur naj pa ene motra e Mujitë çufartë tuj ardh/ Ih na mur pushkën e mjera na ka zan' atë frengëj/ Ih luftë të madhe ajo mor me to na ka boe/ Ahej jodvaj përhap çufartë ajo naj ka kthy-mun o hej mor hej.**

Në këngët kreshnike që këndohen në trevën e Kërçovës, pa-sqyrohen copëza nga jeta e gjallë dhe dinamike e bashkësive të lira fshatare nga kjo trevë, që banojnë siç dëshmon toponomia e vendbanimeve në lugina apo rrëzë bjeshkëve të larta te Dardha, te Çuka.

Në rrethana të vështira të qëndresës shumë shekullore, populli ynë dhe në këtë kontekst edhe rapsodët popullor nga treva e Kërçovës, me këngët e këtilla që i këndojnë e ndjejnë nevojën për t'u thurur lavde duke i himnizuar heronjtë që i kanë qëndruar pushtuesit. Këta i heroizuan protagonistët, duke u dhënë atyre tipare të heronjëve të lashtësisë, me fuqi dhe përmasa fizike mbinjerëzore.

Këngët që i këndojnë rapsodët popullor nga treva e Kërçovës, tregojnë qartë se kreshnikët hidhen në aksione të guximshme dhe të rrezikshme për mbrojtjen e bjeshkëve, për shpëtimin e shokëve, për të dalë prej rrethimit armik, për të rrëmbyer vajzën që dashurojnë ose për të vënë në vend nderin e cënuar të nënës dhe të motrës, Muji i maskuar i hyn krajlicës brenda në konak: *O ene Muji sa me kadale po naj folë/ A ku dinë ti moj kralic' se unë jam Muja/ Oh more Mujo ti bre çka na thue/ Mor s'ashtë e munëme gruja burin me harrue/ Se dhetë vjetë ene unë me ty kum jetue/ Her më ke ra Mujo her më*

ke përçafue/ Të xhitha hujetë xhadija tu ja kallzue/ Ahej dhetë vjetë në një mufes jemi mulu-mun o hej.

Prania e këtyre elementeve ka bërë të mundur dhe përcaktimin e këtyre këngëve si këngë legjendare. Karakterin legjendar të këtyre krijimeve ua përforcon dhe poetika popullore e kësaj treve, e zhveshur nga elemente të vetëdijes historike dhe mbi të cilën ngërthehen me një bukuri të rrallë figura dhe motive imagjinare, fantastike. Të tilla janë këngë me motive lindjesh të mrekullueshme të heroit, të rritjes fantastike, të zbulimit të aftësive çudibërëse qysh në fëmijëri, të gjesteve dhe bëmave të jashtëzakonshme, siç është Beno Bajraktari i cili shkon në Krajli për t'i shpëtuar motrat: *E na e ka kref xhokunë mëjr e ka limue/ Ahej veç po përetë ditën ato me u përevu mun-o hej/ O more ene dita e dill ç'na u afrue/ Ene krali darsmën na e ka fillue/ Ih tanë mezlishtin aj na e ka trmaue/Ene tërëj robinkatë aj bakshëjsh naj vue/Ahej hajde thotë atëllartë ku jan me u prevu mun-o hej.*

Në grehinën kolosale të eposit të kreshikve, veprojnë plot figura mitike si zanat, të lumet e natës, orët e shtojzovallet, gjarpërinjtë që u japin forcë kreshnikëve ose u shërojnë plagët, zogjtë që paralajmërojnë ngjarje; vende të kulteve pagane si Mrizet e Mëdha, Çuka, Lugjet e Verdha, kroje, pyje, shpella etj., trupa qiellorë që komunikojnë me njerëzit dhe marrin ndore kreshnikët si dielli, hëna etj. Sipas shëmbëlltyrës së poetikës mitike, janë krijuar këngë që i kushtohen origjinës mitologjike të kreshnikëve “Ora e Mujit”, “Fuqia e Mujit”, “Fuqia e Halilit” etj; këngë për martesë të mrekullueshme si “Martesa e Halilit”, “Martesa e Mujit”, “Muji merr Lajkën e bardhë”, “Muji dhe tri zanat e malit”; këngë për ndeshje dhe përplasje me përbindësja, zana, kuçedra, bajlozë si: “Gjure Harambashi plagos të lumet e malit”, “Halili pret Pajo Ha-

rambashin” etj. Në këngë e këtushme kreshnike, këndohen jo vetëm heronjtë mitikë, por edhe njerëzorë që zotërojnë fuqi të mrekullueshme, çudibërëse, sepse janë ushqyer me "tamël gjini zanash", me lang lulesh fushe, që i kanë bërë çobenjtë, kreshnikët viganë, që i bëjnë të dridhen malet e bjeshkët kur "vëkasin", thajnë gjethe e bar kur kalojnë me kuajt e tyre të mrekullueshëm. Kur bërtit Bashi Muja, tjegullat e sarajeve biejn poshtë në tokë: *More kurë na brttati bre ç’aj Bashi Muja/ Ahej xharamidatë pej saraj poshtë të na ran—o hej mor hej.* Në eposin e këngëve kreshnike të kësaj treve prania e elementeve mitologjike përputhet edhe me përfytyrimin poetik të kreshnikëve e të bëmave të tyre, të cilat gjithashtu janë mbinjerëzore. Kreshnikët jo vetëm në përmasa dhe fuqi, por edhe në cilësi të tjera, janë të mbinatyrshëm. Në zemrën e tyre lëvrinjë gjarpërinj, ata ndihmohen prej kafshësh dhe e—gërsirash dhe rivalizojnë me orët, të cilat herë i ndëshkojnë për ndonjë prapësi, herë të tjera u bëhen krahë, thuajse njësoj si heronjtë e mitologjisë antike. I këtillë është xhoku i Beno Bajraktarit i cili: *O mor Xhokuj Benos as një neri nuk na përeno—në/ I çojnë bar e taxhi Xhokutë aj nuk na hane/ Ih naj çojnë uj ene Xhokutë aj nuk na pëjne/ Ih shum ene shumë ato Xhokun na e turlisin/ Ih me dhamë e me shelba Xhoku po naj vrete/ Ahej vetum sajbinë e vetë Xhoku na krkon—o hej.*

Në këngët e kësaj treve është e gjallë bota mitologjike: zanat dhe orët janë qenie mitologjike. Ato janë të ngjashme me gjysmëperënditë e botës antike. Legjendat dhe përrallat nuk arsyetojnë mbi natyrën dhe cilësitë e tyre, por na i paraqesin si vepruese. Fuqia e tyre është mbinjerëzore. Por një kreshnik me forcë të jashtëzakonshme mund t’i plagosë dhe t’i cenojë ato. Edhe heronjtë e Homerit i plagosin perënditë e Olimp it po të merrnin pjesë në grindjet e tyre. Orët dhe zanat kanë

intuitë të veçantë lidhur me të ardhmen e bujarëve dhe agëve dinë fatin, rrezikun dhe fundin e tyre. Ato kanë karakteristika të përbashkëta. Janë rojet e heronjve. U japin fuqi atyre. U vinë në ndihmë sa herë që gjenden ngushtë. U shërbejnë dhe i njekojnë kur plagosen për vdekje, siç rrëfëhet në këngën “Martesa e Halilit”: *Po thot' dilli “a’ndorja ime”/ Po thot' hana “a’ndorja e ime”/ Kan' than' ort “a’ndorja jon”*.

Të ndalemi pak te Gjoku i Mujit. Nga Hargjegjja, Gjoku i famshëm në këngët e kreshnikëve është kali apo ati i bardhë: *Mor lumi unë thotë për kitë xhok çë kum ble/ Ahej e kumë xhokunë unë mor zog—o me fjet—o hej*. Pa kalin, shokun e tij besnik, kreshniku është i humbur në luftë. Edhe në zbukurimin dhe pajisjen e gjokut apo të murxhait ka një paralelizëm të dukshëm: *Ne patëkojatë ja ka vumunë pi alltani/ Ahej ene thumatë ja ka vu për rixhani—o hej mor hej/ O na mur xhokunë trëjmi na ka dal në pazar/ E naj ka ble—munë xhokutë aj një shale/ More shale ranë tredhetë ok’ na—a kane*.

Dallohet qartë jeta që rrjedh në gjirin e natyrës dhe në kontakt të vazhdueshëm e të pandërprerë me të: te bjeshka, mali, lugina, kroi, shpella, pylli, ndodhin heroizma, drama, tragjedi, kuvende, biseda. Kreshnikët ndihmohen ose pengohen prej elementeve të natyrës, grinden dhe pajtohen me to, miqësohen dhe armiqësohen. Ata marrin përmasat e këtyre elementeve natyrorë, ashtu si këto elemente natyrorë dhe të mrekulueshëm marrin frymë, mendojnë dhe veprojnë si vetë njerëzit. Kreshnikët dinë të shijojnë, dallojnë, të kuptojnë shumë mirë ngjyrat, tingujt, zërat karakteristikë të elementeve që i njohin si të tyret. Një degë e thyer, një fije bari e shkelur, një gur i zhvendosur, një nuancë në këngën e zogut, janë shumë domethënëse për heronjtë, janë shenja paralajmëruese për ta. Marrësi dhe cilido studiues i këngëve kreshnike zbulon lehtë—

sisht cilët janë dhe cili është roli i elementit pagan mitologjik. Në Vajin e Ajkunës që qan të birin e vrarë nga "shetë" marrin pjesë hëna, dielli, yjet, bjeshkët etj. Veç personazheve mitologjikë në epos gjën edhe mjaft elemente të mrekullueshëm arkaikë, si: zana që kthen në gur dhe në dru krushqit bashkë me kuajt e tyre, burri që dihet i vdekur dhe kthehet në çastin kur gruaja e tij po martohet me tjetër, siç është rasti me Ymer Agën, djali që verbohët nga e ëma dhe që pastaj bëhet vrasës i s'ëmës së tij. Të gjitha këto elemente të një shtrati të vjetër i gjejmë të përbashkëta me epikën dhe mitologjinë greke që përplasen në rastin e Ajkunës me hyjnitë e moçme greke që vdesin e përtërihen bashkë me bimësinë. Te zana që kthen në gur krushqit shohim hijen e Circës; te burri i humbur që kthehet në shtëpinë e ve shohim Odisenë, te Zuku që vret t'ëmën shohim Orestin. Kreshnikët e eposit shqiptar qëndrojnë jashtë specifikës dhe ligjësive të këngëve historike. Me fytyrën dhe gjestet e tyre monumentale, ata janë të ngulur rregullisht në një mjedis mitologjik, flasin me kuaj, me orë e zana, me zogj fantastikë, komunikojnë me gjarpërinj që u shërojnë varrët, e motra e Hasan Agës bisedon me arushën, ujkun, korbin. Zuku Bajraktar me heronjtë e përrallës ka një mënyrë të mrekullueshme. Po ky si dhe ndonjë tjetër, shëron sytë duke i larë me barin magjik, kreshnikët kanë armë të jashtëzakonshme si heronjtë e përrallave.

Idealizimin dhe zbukurimin e figurës së gruas dhe familjes e ndeshim në këngët kreshnike që këndohen në trevën e Kërçovës, në të cilat raportet familjare jepen të idealizuara. Kjo jetë e idealizuar i përshtatet llojit të zhanrit epik, ku marrëdhëniet familjare që përshkruhen aty spikasin krahas forcës, nderit, virtytit etj. Nderi që është një ndër normat më themelore në familjen patriakale që përshkruhet në epos. Malësori pa-

triarkal kërkon një jetë të idealizuar. Kjo jetë e idealizuar që paraqitet në këngët kreshnike i përshtatet vetëm zhanrit epik. Dhe në këtë lloj gjinie, rapsodi popullor na jep modele që janë për t'u admiruar dhe për t'u marrë si shembull (simbole të besës, besnikërisë bashkëshortore, stoicizmit, nderit etj.). Kështu edhe në eposin homerik figura e Andromakës, s'është figura e një gruaje të çfarëdoshme, të zakonshme është modeli i bashkëshortes, apo ajo e Penelopës. Këto janë figura epike madhështore që i përshtaten zhanrit epik.

Të ndalemi te figura e Ajkunës, që na kujton deri diku He-kubën trojane. Ajo na paraqitet si grua e madhërishtme, fjala e së cilës ka pushtet te dy fëmijët e saj; ajo në pjesën më të madhe të Eposit është e heshtur, por me një heshtje të admirueshme kur shpalos ndjenjat e saj si nënë, kur vajton të birin. Forca e vajit të saj bën që dhe orët e bjeshkës ta ndalin fjalën dhe së rrahurit e zemrës: *Se ty vorrin ta run' nana/ More i mëiri i nanës – o! / Orët e bjeshkës ma s'un e nëijnë, / Fjalën n'goj' po ja kthejn' / Zemrën së rrahni ja kan nal'.*

Në cikël të bie në sy idealizimi i së bukurës te figura e grave. Bukuria kuptohet si një përsosmëri fizike dhe morale e shpirtërore, si më e mira në llojin e vet. Në këto këngë rapsodi priret më fort nga bukuria subline e femrës. Është fakt i evidentueshëm se krijuesi popullor ashtu siç nuk i nënvlerëson kundërshtarët në fushën e mejdanit, por i jep cilësitë e tyre, po kështu vepron edhe me femrat. Ai nuk idealizon vetëm femrat shqiptare, për nga bukuria fizike, por edhe ato që vijnë nga kampi kundërshtar. Për këtë dëshmon dhe fakti se në epos përdoren gjerësisht nocionet estetike në trajtën sipërore; “të gja ma t'mirë” shef njeri nën këtë diell” thuhet për Tajnushën e Krajlit; “kurrkund shoen nën këtë diell s'e ka” thuhet për Rushën e Krajlit; “fort sojnike nanën qi e kin' pasë”, thuhet

për nënën e Mujit e të Halilit; “nji qi amë e mira këtu ndër ne” thuhet për gruan e Arnaut Osmanit; “kurrë ma e mirë n’Jutbinë nuk ashtë kanë” thuhet për Fatime Shqyptaren, të cilën Krajli i Talisë e kishte kapur robinë. Me këto hiperbola fillon gjithmonë vizatimi i bukurive të heroinave në këtë cikël. Pa diskutim nga të gjitha bukuritë femërore që spikatin në këto këngë kaq madhështore, më evidente, dhe më e bukura është figura e Tanushës së Krajlit. Vargjet që arrijnë të bëjnë portretizimin e Tanushës pa diskutim janë vargjet më të bukura lirike të këtij cikli. Nëse do ta hiqnim një vizë simetrike në këto vargje do të dallonim nga njëri krah tiparet e fytyrës dhe nga krah u tjetër elementet më të bukura natyrore të bjeshtëve tona. Këtë portretizim rapsodi popullor e realizon me anë të krahasimit: *Vetlla e saj nrëit si fiskaj/ Shetku i ballit si shteku i malit/ Kur del hana me praru/ Sëyni i saj si kokrra e qushis’/ Ka qerpëikun si krah u dallanyshes/ Fëtyr e saj, si kuqet molla n’dengë.*

Veçoritë e gjuhës dhe roli i elementeve të saj në realizimin e parimit të zbukurimit në këngët kreshnike, ndërlidhen me elementin e mrekullueshëm, idealizimin dhe dhënien e bukurisë në shkallën sipërore qoftë në portretin shpirtëror të kreshnikve dhe zanave, ose në përshkrimin e elementeve mitologjike, apo në përshkrimin e betejave të pabarabarta, por gjithmonë me fitoren e kreshnikve shqiptarë, realizohen në saj të gjuhës së mrekullueshme poetike që është përdorur në këto këngë. Në themelet e gjithë këngëve të kreshnikëve, por edhe të vetë Epikës legjendare shqiptare, në çdo qelizë të kësaj ngrehine është përdorur gjuha e mrekullueshme popullore, pasuritë e saj leksikore e sintaksore, potenciali i saj i fuqishëm poetik. Me thesaret e kësaj gjuhe u krijuan vlera të padiskutueshme, që shërbejnë si modele të lartësimit të saj. Me vlerat

e shumta ideoartistike dhe originalitetin e tij eposi i këngëve të kreshnikve të trevës së Kërçovës qëndron me dinjitet krahas eposeve të mirënjohura, siç janë: Eposin homerik, Sagat e skandinave, Këngët për Ronaldin dhe Sidin, epopenë e Dikenis Akritasit, Kalevalën, Nibelungët, Bilinat ruse dhe epikën e Sllavëve të Jugut.

Vetë struktura e këtij cikli siguron përfshirjen e një përmbajtjeje më të gjerë se tema, jep dorë për bashkërendim njetesh dhe formash të ndryshme të shprehjes artistike, bën të mundur të tejkalohet e madhërisht heroike që është dominantja estetike, duke u mpleksur harmonishëm me elemente lirike dhe dramatike, krijon mundësi për t'u hedhur me shkathhtësi nga një plan në tjetrin, siguron në largësi të shkakut me pasojë, ndihmon që krahas temës qëndrore të përpunohen motive të nënrenditura.

Dy elemente kryesore dallohen në këto këngë: elementi lirik dhe ai epik. Këngët e kreshnikëve që këndohen në trevën e Kërçovës janë më fort epike se lirike, sepse zotëron përsëritje dhe tregimi i trimërive dhe bëmave. Fryma lirike shpreh shpirtin e shqiptarit të këtushëm dhe pasqyron ndjenjat e tij të holla. Në këto këngë shprehen këto ndjesi me një valë të rrëmbyeshme e të fortë, duke paraqitur shpirtin e shqiptarit me tërë burrërinë e vet, në ngjasim të asaj force dhe natyre madhështore të malësive e të shkrepave ku jeton.

Elementi i mrekullisë apo i mrekullueshmi në poezinë popullore shënohet nga hiperbolat që janë shumë të përdorura këtu. Hiperbola është përdorur me efikasitet në dhënien e forcës fizike dhe morale të kreshnikve, në realizimin e pranisë dhe pushtetit të elementeve mitologjike, në përsëkrimin e natyrës, në ndryshimin e menjëhershëm që pëson ajo në përputhje me situatën ku gjenden heonjtë. Rastet e hiperbolës i kemi për-

mendur më lartë në këtë studim. Po përmendim gjithashtu, rolin e së jashtëzakonshmes, si fryt të një trillimi të veçantë poetik, i cili mund të procedojë në rrugën e animizimit dhe antropomorfizimit apo në rrugën e theksimit, të mprehjes, të zmadhimit artistik.

Personifikimi apo animizmi bën që objektet dhe sendet të gjallërohen, kurse natyra të mbushet me tinguj dhe ngjyra (mali qesh nga gëzimi dhe gjëmon nga dhembja e hidhërimit, ahu shtrin degët për të mbrojtur trimin e rënë e gjethi pikon lot, reja vrenjtet e qesh dhe merr në gjë heronjtë). Kafshët flasin e veprojnë si njerëz (kali këshillon heroin, ka sedrën e njeriut, ndjen si ai. Qyqja bën paralajmërime, nxit kreshnikun për në luftë, të ndërmerrnin aksione, ndodhin heroizma, drama e tragjedi të fuqishme, shpërthen një botë e pasur shpirtërore. Idetë, konceptet abstrakte marrin formë e mishërohen me figura konkrete (fati mishërohet me figurën e orës a të gjarprit mbrojtës, forca e egër dhe brutale mishërohet te bajlozi, arapi i zi, etj.). Cilësitë e njerëzve, të kafshëve e të sendeve, marrin përmasa dhe përmbajtje nga më kuriozet (kujtojmë përmasat dhe forcën fizike e morale të kreshnikëve).

Nga ana statistikore vihen në dukje: hiperbolat, krahasimet, epitetet, paralelizmi figurativ mes natyrës (diellit), betejat, bisadat e heronjve me kuaj, me zogj etj. Fillimet dhe fundet e tipizuara të këngëve, dhjetërrokëshi, rima, turqizma e sllavizma. Krahas forcës fizike të jashtëzakonshme të kreshnikëve, del fare natyrshëm gjetja e kalit të mrekullueshëm, lotimi i gjokut të Mujit, mëzi që lind me yll në ballë, grumbullimi i kreshnikëve në kuvend, futja e tyre në palën kundërshtare duke ndryshuar veshjen: *Ih ka marr rrugë aj mor në pazar ka shkue/ Ene një gomar të mëjr aj na e ka ble/ Hemë do petka maxhypi naj ka marre/ E na a vesh Muja na a bomun si pi-*

taçë/ Ahej ç'e mur rrugë Muja për në Krali—mun o hej mor hej. Mbirja e luleve mbi varret e kreshnikëve, veprimi i dyfishtë, përsëritjet e fjalëve, përsëritjet epike, sinonimet, përdorimi i numrave simbolik 3,7,9,30,300, fillimi i këngëve me invokacione dhe mbyllja e tyre me dasma dhe fitore.

Përfundim

Jam i bindur se të gjitha aspektet e zbatimit të parimit të zburimit në këngët e kreshnikëve që këndohen në trevën e Kërçovës janë madhështore, por ne nuk kemi arritur t'i evidentojmë të gjitha në këtë studim. Dikush tjetër mund të humtojë dhe të paraqesë aspekte të tjera të pranisë dhe zbatimit të parimit të zburimit. Koha, madhështia fizike dhe morale e personazheve, figurat femërore dhe ideali i familjes, figuracioni letrar në funksion të ideve dhe mesazheve historike, njerëzore, kulturore, zakonore, nuk janë veçse maja e "ajsbergut". Këngët e këtushme kreshnike, kanë lindur dhe janë kënduar nga rapsodët e këtushëm popullor si domosdoshmëri e shprehjes artistike të epokës së formësimit të tij, është për të gjithë si një vend antik, ku sa herë që ta vizitosh këtë trevë dhe ta dëgjosh këngën kreshnike, do të mundësh padiskutim të mësosh të reja të pazbuluara më parë dhe të provosh ndjesi të reja. Gjithë çështjet e ngritura në këtë studim, paraqesin vetëm disa forma të shprehjes së këtij parimi, por mjeshhtëria e krijuesit popullor jo vetëm në këtë krijim por në gjithë arsenalin e tij, ka mundur të realizojë të bukurën e brishtë në krijimet lirike, tragjiken që dhemb me madhësi dhe legendën që ka mundur të kapërcejë shekujt. E rëndësishme është se këngët kreshnike vazhdojnë të qëndrojnë stoike, duke na tërhequr me forcën e tyre e duke na dhënë një mesazh për të gjithë: Pushkën e besën na la i pari.

NEBI DERVISHI,

Fakulteti Filozofik, USHT – Tetovë

MUZEU ETNOKULTURA “VIA KANDAVIA” NË FSHATIN LIVADHI TË STRUGËS

Trashëgimia kulturore dhe historike e një kombi është barometri më i mirë për matjen e nivelit të civilizimit të tij. Kjo begati përbën një mozaik të bukur vlerash që në plan të parë duken të pa rëndësishme, por thellë në vehte ngërthejnë vitalitetin, kreativitetin dhe qëndresën ndaj ndikimeve të jashtme. Ç’do komb gjatë periudhave të ndryshme historike, ka lënë trashëgimi kulturore që e bënë të dallohet nga popujt e tjerë. Në fakt, trashëgimi të begatë kanë lënë edhe ato kombe të cilat sot nuk bëjnë pjesë në hartën demografike botërore, pasi janë zhdukur, asimiluar ose shkrirë, por trashëgimia kulturore e krijuar nga to ka mbërritur deri tek ne, duke na kujtuar se dikurë ka jetuar një popull që ka krijuar vlera.

Vlera të tilla kulturore e historike ka krijuar populli shqiptar me bollëk, por fatkeqësisht tranzicioni i tej zgjatur si brenda kufijve të shteteve të Shqipërisë e Kosovës, e veçanërisht në trojet e tjera shqiptare që ndodhen në Maqedoninë Perëndimore (pra, trevat Lindore shqiptare), ka lënë në mëshirë të fatit, hajnave dhe falsifikatorëve pa identitet të definuar të gjithë këtë trashëgimi.

Duke u nisur nga kjo që përmenda më lartë, pas një pune rreth 15 vjeçare, në 19 prill të vitit 2002, në fshatin Livadhi të Strugës hapet Muzeu “Etnokultura e Fushëgropës së Ohrit” që sotë mban emrin Muzeu “Etnokultura Via Kandavia” .

Nismëtar i kësaj inicjative isha unë, sëbashku me rinin dhe banorët e fshatit.

Gjatë periudhës 12 vjeçare të funksionimit, muzeu është vizituar nga një numër i madh njerëzish, të cilët inpresionet e tyre i kanë shprehur në fletoret e përshtypjeve. Gjithashtu, muzeun e kanë vizituar edhe një numër i madhë personalitetesh dhe përfaqësuesish të korit diplomatik të akredituar në Shkup, ndër to edhe ish ambasadori amerikan Lorenc Batler.

Muzeu “Etnokultura Via Kandavia” përfshin mbi 5 300 artefakte nga trashëgimia kulturo-historike e shqiptarëve që jetojnë në Maqedoni. Objektet më të lashta datojnë që nga koha e neolitit të vonë, rreth 5 000 vite të vjetra (çekiç dhe daltë stralli) dhe janë gjetur në vitet 70 të shekullit të kaluar në rrjedhën e lumit Drini i Zi në qytetin e Strugës.

Muzeu është i ndarë në disa sektorë:

- 1.Sektori i arkeologjisë.
- 2.Sektori i filaterisë.
- 3.Sektori i nomizmatikës.
- 4.Sektori i orendive shtëpiake.
- 5.Sektori i armëve të zjarrit dhe armëve të ftohta.
- 6.Sektori i veshjeve popullore.
- 7.Sektori i instrumenteve popullore.
- 8.Sektori i veglave të punës dhe
- 9.Sektori i dokumenteve.

Për një kohë të gjatë koleksioni ishte i vendosur në një objekt privat, i cili linte shumë për të dëshiruar, pasi kushtet e veshitura dhe faktorët e ndryshëm natyror bënin që koleksioni dita ditës të humbiste shkëlqimin e tij.

Për këtë arsye në vitin 2012 u krijua një shoqatë joqeveritare me emrin Etnokultura “Via Kandavia”, e cila menjëherë i’u rrek punës për të bërë të mundur sigurimin e fondeve dhe hapsirave për zhvendosjen e këtij koleksioni me vlera të rralla nga ky objekt i përkohshëm.

Pasi u arrit që të sigurohet objekti ku do të vendoseshte koleksioni, u hartuan projekte të drejtuara ambasadave të huaja dhe veçanërisht Ministrisë së Kulturës së Republikës së Maqedonisë.

Nga ambasadat e huaja nuk arritëm të siguronim asnjë fond, kurse Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë, miratoi fondin qesharak prej 295 euro (18000 denar) i cili nuk ishte definitive, pasi që kontrata përfundimtare kishte klauzolë e cila parashihte që nëse do të kishte rebalans të buxhetit, kishte mundësi që të shkurtoheshin edhe kësaj mëtej.

Është i njohur botërisht fakti se për ne shqiptarët që jetojmë në Republikën e Maqedonisë, institucionet shtetërore janë njerëz, pasi ndaj nesh sillen me vrazhdësinë më të madhe duke na përbuzur dhe ironizuar tejskajshmërisht.

Duke u ndodhur në këtë pozitë të vështirë, aktivistët e kësaj shoqate refuzuan këtë fond dhe i’u rrekën punës që me mjete vetiake financiare të përshtatnin objektin e ri për Muze.

Kështu, pas një pune prej rreth 6 muajsh, më në fund në 14 qershor të këtij viti u rihap Muzeu “Etnokultuara Via Kandavia” në hapsirat që ndodhen në Shkollën Fillore “Aki Dika” – në fshatin Livadhi të Strugës. Shuma e investuar kalon mbi 12 mij euro, mjete këto që aktivistët i ndanë nga buxhetet familjare, në ndërko që buxheti shtetëror, i cili mbushet edhe nga taksapaguesit shqiptar, investon shumë marramendëse për kulturën maqedonase, kurse për kulturën shqiptare ndan shumë

të cilat nuk mund të mbulojnë as hargjimet për përpilimin e projekteve.

Muzeu “Etnokultura Via Kandavia” është një pasuri e vërtetë, jo vetëm për qytetin e Strugës, por edhe për mbarë trevat Lindore shqiptare, për arsye se në të janë të ekspozuara artefakte, veshje popullore, nomizmatikë, armë, dokumente historike, etj nga të gjithë këto treva.

Një pasuri të madhe paraqesin rreth 80 veshje popullore, për femra dhe meshkuj, të cilat janë ekspozuar në një sipërfaqe relativisht të vogël, por që përfaqësojnë një vlerë të madhe nga trashëgimia e popullit shqiptar. Këto veshje sëbashku me qindra aksesore të tjerë të çepur nga gratë shqiptare, që ndodhen në këtë muze, janë tregues i vërtetë se gratë shqiptare, edhe pse të pashkolluara kanë qenë artizane të shkëlqyera.

Një punë, relativisht e madhe është bërë me mbledhjen e mbi 1500 monedhave, të cilat datojnë nga epoka helenistike, pastaj ajo romake, bizantine, osmane e deri në ditët e sotme. Vlenë të cekën këtu monedhat me figurat e Lekës së Madhë, Perandorit Nerva, Vespasian, Valerius etj. Këto monedha së bashku me materialet e tjera të grumbulluara në këtë muze duhet t’i nënshtrohen një studimi të mirfilltë shkencor për të bërë të mundur që të deshifrohen dhe të ekspozohen ashtu siç u ka hije.

Gjetjet arkeologjike janë një vlerë tjetër që dëshmon vazhdimësinë pellazgo-iliro-arbërore-shqiptare në këto treva. Nga këto gjetje vlejnë të theksohen çeramika e varrit ilir e gjetur në fshatin Gradec të Gostivarit, çeramika e gjetur në fshatrat e Strugës, Shkupit e Tetovës.

Këndi i armëve është një vlerë tjetër për këtë muze. Ai përbehet nga disa lloje shpatash, jataganësh, kamash etj mbi 300 vjet të vjetra. Gjithashtu janë të ekspozuara një numër prej

rrethë 25 armësh zjarri të cilët datojnë deri në 250 vite më parë.

Një atraksion i vërtetë për vizitorët përbën edhe këndi ku janë të ekspozuara një numër bukur i madhë unazash mesjetare dhe të kohës së re, por ajo që zgjon kërshtërinë e tyre është unaza e djalit të themeluesit të shtetit shqiptarë, Ismail Qemalit, pra Qazim bej Vlorës, i cili mbylli sytë dhe u varros në qytetin e Strugës.

Këndi i kartmonedhave dhe i filaterisë gjithashtu është tepër i pasur. Kështu, për vizitorët janë të ekspozuara mbi 1200 kartmonedha dhe mbi 1350 pulla administrative nga më tepër se 150 shtete të botës.

Ky Muze ka shumëçka për t'i treguar, jo vetëm vizitorit të thjeshtë, por edhe arkeologjisë dhe historiaografisë shqiptare, por për këtë duhet një punë e madhe e studiuesve, historianëve, arkeologëve, etnologëve, kostumografëve dhe të tjerëve.

Është moment i fundit që ky Muze ti ngjaj institucioneve simotra që kanë mbirë si këpurdha në shumë qytete të Maqedonisë e që nuk posedojnë as gjysmën e kësaj pasurie muzeale, por për këtë duhen mjete dhe staf i profilizuar që do të bëjë deshifrimin, konzervimin ekspozimin adekuat të artefakteve, si dhe valorizimin e tyre.

SEVDAIL DEMIRI,
ITSHKSH – Shkup

SHTYPI SHQIPTAR NË MAQEDONI, SI TRASHËGIMI KULTURORE

Në rrethana kur mungonte komunikimi audiovizuel, shtypi kishte ndikim të jashtëzakonshëm në jetën shoqërore, politike, kulturore e ekonomike të njerëzve. Përmes shtypit të përditshëm, javor, mujor apo periodik, masat e gjera popullore informoheshin rreth zhvillimeve kryesore që ndodhnin brenda komunitetit të caktuar.

Varësisht nga vendi, koha dhe sistemi shoqëror, shtypi përbën një lëndë shumë të rëndësishme për të dokumentuar zhvillime shoqërore, ngjarje apo personalitete. Në këtë aspekt, shtypi i shkruar përbën një thesar shumë të çmuar edhe të trashëgimisë kulturore.

Shqiptarët, shikuar në kornizat e Maqedonisë së sotme, edhe pse historikisht në vazhdimësi të ndodhur nën sundues të ndryshëm, kanë zhvilluar një veprimtari të ngjeshur politike e kulturore, përmes organeve të ndryshme të shtypit, duke transmetuar informatat e tyre përmes gazetave dhe revistave, që botoheshin në këto hapësira.

Dy janë qendrat kryesore të Maqedonisë, të cilat ruajnë në vete një trashëgimi të pasur kulturore në aspekt të periodikut shqiptar: Manastiri dhe Shkupi. Që të dyja këto qendra, nëpër periudha të ndryshme kohore, do të bartnin barrën e rëndë të informimit të popullatës shqiptare me zhvillimet dramatike shoqërore të shekullit të kaluar.

Konkretisht, me Revolucionin e Turqve të Rinj të vitit 1908, krijohen kushte të reja për zhvillimin e identitetit kulturor dhe shpirtëror të popujve nën Perandorinë Osmane, e cila po shembej dita-ditës. Manastiri, “qyteti i konsujve”, ishte një nga qendrat kryesore të zhvillimit të jetës shoqërore e kulturore të shumë popujve ballkanik, e ku shqiptarët përbënin një ajkë të rëndësishme. Me organizimin e Kongresit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir në nëntor të vitit 1908, u krijuan edhe kushte të reja për zhvillimin e veprimtarisë botuese. Me vendim të Kongresit, u formuan shumë klube shqiptare nëpër viset e ndryshme shqiptare, me qëllim rizgjimin kombëtar të shqiptarëve në planin kulturor-arsimor, si dhe u sigurua një shtypshkronjë solide për kohën, ku u shtypën libra, gazeta, broshura dhe materiale tjera në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të tjera. Në këtë shtypshkronjë të quajtur “Ba-shkini”, u shtypën edhe gazetat e para shqipe në territorin e Maqedonisë së sotme, dhe të njëjtat u shpërndanë nëpër qendrat e ndryshme shqiptare në Ballkan dhe diasporë. Kështu, në periudhën e viteve 1909 – 1911, aty u shtyp gazeta „Ba-shkini i Kombit“, më vonë, në vitet 1911–1912 u shtyp gazeta „Drita“, gazeta „Shkupi“ me qendër në Shkup në vitet 1911–1912, revista „Lahuta e malcis“ më 1911. Në po të njëjtën shtypshkronjë u përgatitën kalendarët „Aferdita“ (1910), „Dija“ (1910–1911), dhe „Korça“ (1911–1912)¹.

Nga të gjitha këto organe të shtypit të asaj kohe, gazeta me një rëndësi të madhe për historinë e gazetarisë shqiptare të Maqedonisë dhe për historiografinë shqiptare në përgjithësi, është gazeta javore “Shkupi”, numri i parë i të cilës u botua më 29 gusht të vitit 1911 në Shkup, nën redaktimin e gazeta-

¹ Lutfi Turkeshi, *Historia e shtypit shqiptar 1908-1912*, Vatra, Shkup, 2001, fq.67;

rit të njohur dhe rilindësit, Jashar Erebara. Konkretisht, në muajin dhjetor të vitit 1909, klubi “Bashkimi” i Shkupit, i udhëhequr nga veprimtarët e çmuar si Bedri Pejani, Nexhib Draga, Rexhep Mitrovica, Hasan Prishtina, etj., e theksuan nevojën e hapjes së një gazete shqipe në kryeqytetin e Vilajetit të Kosovës – Shkup. Vendimi për hapjen e kësaj gazete u mor më 2 prill 1910, në Kongresin e Dytë të Manastirit².

Gazeta “Shkupi”, sikurse edhe gazetat „Bashkimi i Kombit“ dhe “Drita”, edhe pse dolën një periudhë të shkurtër kohore, për shkak të fillimit të luftërave ballkanike, lanë gjurmë të paslyeshme në historinë tonë kombëtare. Ato ishin dhe mbeten përgjithmonë një trashëgimi shumë e pasur kulturore e shqiptarëve andej dhe këndej kufirit, përmes të cilave tregohet qenësia e shqiptarëve në këto troje, dhe niveli i zhvillimit të tyre kulturor dhe kombëtar, pa mbetur mbrapa popujve tjerë të Ballkanit, të cilët po bënin përpjekje për çlirim kombëtar.

Deri më tani, nga studiues të ndryshëm, këto gazeta dhe revista janë sistemuar dhe studiuar në forma të ndryshme, madje edhe janë ribotuar komplet në formë librash. Mirëpo, fatkeqësisht, këto organe të shtypit shqiptar nuk janë të sistemuara nëpër bibliotekat apo institucionet tjera brenda Republikës së Maqedonisë. Ato momentalisht ndodhen në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë në Tiranë, ku mund të studiohen dhe hulumtohen. Konsideroj që është nevojë emergjente që këto thesare të trashëgimisë tonë kulturore, në tërësi të digjitalizohen sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe të jenë të disponueshme për çdo studiues apo të interesuar tjetër që dëshiron të hulumtojë në Bibliotekën Kombëtare dhe Universi-

² 100 vjetori i gazetës `Shkupi` (dokumente arkivore), përgatitur nga Skender Asani dhe Ardian Limani, Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, Shkup, 2011, fq.8;

tare të Shkupit apo në Bibliotekën e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

Pas Luftës së Parë Botërore (1919), me ripushtimin e këtyre trojeve nga Mbretëria Serbe–Kroate–Sllovene, ku fjalën kryesore e kishte Serbia, u shua çdo lloj i veprimtarisë kulturore e arsimore e popujve të tjerë, e sidomos e shqiptarëve.

Organizata politike e myslimanëve të Maqedonisë së Vardarit, “Xhemieti”, rreth të cilës ishin tubuar edhe shqiptarët, në periudhën e viteve 1920 – 1924, e botoi organin e saj, përkatësisht gazetën “Hak”, mirëpo ajo shtypej në gjuhën turke me shkrim arab dhe në gjuhën serbe me shkrim cirilik³. Kështu që, brenda kësaj periudhe nuk mund të flasim për shtyp shqiptar në Maqedoni. Fatkeqësia tjetër është se kjo gazetë, e tillë siç ishte, edhe pse botohej në Shkup, nuk është ruajtur në asnjë institucion vendor arsimor–shkencor të Maqedonisë. Ajo gjendet e sistemuar në Bibliotekën Kombëtare të Kroacisë në Zagreb.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore do të regjistrohen disa përpjekje për hapjen e gazetave në gjuhën shqipe në territorin e Maqedonisë së sotme, mirëpo ato nuk patën jetë të gjatë dhe ndonjë rëndësi të veçantë në zhvillimet e këtushme shoqërore, politike e kulturore.

Shtypi shqiptar në Maqedoni, bëri një hap para me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, kur prej 4 prillit të vitit 1945, do të nisë rrugëtimin e saj gati gjysmëshekullor, gazeta informative, politike e kulturore shqipe “Flaka e Vllaznimit”⁴ (më vonë “Flaka e Vëllazërimit”). Kjo gazetë, që nga viti 1945

³ Skender Asani, “*Aktiviteti i organizatës politike Xhemieti në pjesën e Maqedonisë së Vardarit (1919 – 1925)*”, Instituti i Historisë Nacionale, Shkup, 2013, disertacion i doktoraturës i pabotuar.

⁴ ДАМ, 1.464.1.168/387;

filloi të del si e përdyjavshme, prej vitit 1958 e përjavshme, tri herë në javë prej vitit 1971, që të botohet si gazetë e përditshme prej vitit 1994, dhe për fat të keq, të shuhet krejtësisht dhjetë vjet më vonë⁵.

Redaksia e gazetës “Flaka e Vëllazërimit”, më vonë u begatua edhe me revistat për fëmijë “Gëzimi” (1950) dhe “Fatosi” (1955), të cilat po ashtu luajtën një rol tejet të rëndësishëm në arsimimin dhe edukimin e brezave të rinj.

Nga gjiri i kësaj redaksie, në vitin 1962 nisi botimin edhe revista prestigjioze për art, shkencë dhe kulturë “Jehona”, e cila përbënte një organ të shtypit elitar shqiptar në Maqedoni, ku shkruanin pena të njohura jo vetëm nga Maqedonia, por edhe Kosova dhe viset tjera shqiptare në ish-Jugosllavi.

Ky shtyp shqiptar i pas vitit 1945 në Maqedoni, aktualisht ruhet në disa biblioteka shtetërore dhe komunale të vendit, mirëpo nuk e ka kujdesin e duhur. Në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Shkupit “Shën Klimenti i Ohrit”, ku është sistemuar i gjithë periodiku i kohës, mungojnë dy numrat e parë të gazetës “Flaka e Vëllazërimit”, sikurse edhe disa nga numrat e parë të revistës “Fatosi”. Për më tepër, edhe ato kopje që janë të disponueshme për lexuesit e interesuar apo studiuesit, janë në një gjendje të palakmueshme fizike, me shumë fletë të munguara apo të grisura qëllimshëm nga njerëz të pandërgjegjshëm.

Është për t’u ardhur keq që ky shtyp i krijuar jo më shumë se para 70 viteve, të mos e ketë pasur kujdesin e duhur shoqëror dhe institucional. Andaj, është koha e fundit që kjo pjesë e trashëgimisë tonë kulturore, sa më parë të vlerësohet, valori-

⁵ Sevdail Demiri, “*Shtypi shqiptar në Maqedoni (1945-1991), aspekti kulturor-arsimor*”, Instituti i Historisë Nacionale, Shkup, 2013, disertacion i doktoraturës i pabotuar.

zohet, sistemohet dhe të digjitalizohet, në mënyrë që të ruhet e pacenuar nga dhëmbi i kohës.

BUKURIE MUSTAFA,

ITSHKSH – Shkup

LOJËRAT POPULLORE NJË TRASHËGIMI E HARRUAR

Lojërat popullore, rrënjët e të cilave gjenden thellë në traditën popullore, flasin për aspekte të ndryshme të jetës e të botës fëmijërore e që shtrihet edhe në kulturën e përgjithshme popullore. Ato sot rrëfohen si lojëra të karakterit argëtues e garrues, por kështu nuk kanë qenë kur janë krijuar, duke marr parasysh lashtësinë e tyre, që e gjejmë në shtrirjen edhe te popujt tjerë fqinjë dhe askush nuk mund të dalë pronar i tyre edhe pse mendojë se dallimet shfaqen nga fshati në fshat dhe kjo të jep idenë e zhvillimeve të ngjashme. Lidhja e krijimit të lojërave fillimisht ishte në festat fetare dhe dikur kjo ndryshoi gjithandej, duke përfutur një funksion e karakter tjetër edhe sot gjejmë elemente të riteve brenda lojërave popullore. Kjo gjë mund të sqarojë edhe përhapjen e lojërave te popujt tjerë në Ballkan, por ka edhe të tilla që kalojnë këto kufij dhe sërisht shfaqen rregulla krejtësisht të njëjta (si p.sh. loja *kërc-bum*, që sqarohet në vazhdim). Kjo me siguri ndihmon që çështja e lojërave të shikohet si shumë e hershme në kulturat popullore, por pamundëson trajtimin historik e teorik të zhvillimit të tyre, duke u identifikuar si vlera të kulturës kombëtare.

Lojërat janë trashëgimi e bartur nga njëra gjeneratë te tjetra me elementet përbërëse të saja, por pa e ditur rëndësinë dhe nismën e tyre, gjë që nga vështrimi i sotëm është vështirë të kuptohet. Për lashtësinë e lojërave, thuhet se ka edhe të atilla

që janë nga periudha parakrishtere, kështu që ky evolucion kulturor nuk mund të përcillet si duhet. Kjo ndodh me tërë trashëgiminë kulturore, e cila ndryshon në kohë, duke rrezikuar seriozisht visarin popullor. Lojërat popullore, po ashtu hynë në këtë grup të rrezikuar, të cilat me kalimin e kohës nuk do të jenë as pjesë e kujtimeve të më të vjetërve, e ku më të interpretimit të lojërave. Mjedisi i zhvillimit të lojërave ka qenë fshati dhe fshatarët, të cilët me migracionin e hershëm kanë lënë pas këtë trashëgimi dhe tanimë gjetja e gjurmëve në terren janë të zbehura, thuajse të zhdukura.

Në Maqedoni është koha e fundit për të kuptuar rëndësinë e regjistrimit dhe të evidentimit të lojërave nëpër mikrosisteme, ku deri diku ende ka elemente të zhvillimit të lojërave, për fat të keq, në formë kujtimesh, duke marrë parasysh mungesën e dokumentimit të mëhershëm, kohë relativisht e vonë e humtimeve nga fakti i boshatisjes së fshatrave të shumtë, që sjell deri te rreziku i humbjes së plotë edhe të trashëgimisë kulturore. Në funksion të regjistrimit të kësaj trashëgimie merren parasysh të dhëna nga intervista të ndryshme të gjeratave më të vjetra edhe pse vërehet se gjenerata 50 vjeçe, shprehet se vetë si fëmijë kanë luajtur këto lojëra, por si të vegjël i kanë luajtur shpesh me gjyshërit e tyre. Subjektet e intervistuar, në pjesë të madhe, janë ata që janë shpërngulur që si fëmijë nga fshati dhe jetojnë në qytet dhe kjo është faktorë që rëndon mbledhjen e të dhënave origjinare apo besnikërinë e interpretimit të lojërave.

Elementet që e definojnë lojën në përgjithësi i gjejmë në lojërat tona popullore. Sociologu R. Kajoa⁶, lojën e definon si aktivitet që është i lirë, i veçantë, i papritur dhe që zhvillohet

⁶ Referat: Tradicionalne decije igre i njihova funkcija u savremenoj kulturi igre deteta, www.maturskiradovi.net/.../Tradicionalne%20decije%...; 12.11.2014).

me rregulla. Kjo gjë flet se lojërat popullore të fëmijëve nuk janë thjeshtë argëtim e zbavitje, këto kanë rregullat e veta, të cilat përcaktojnë mënyrën e zhvillimit të lojës, ku parashikohet numri i lojtarëve, pozicioni i tyre, humbja dhe ndëshkimi nga pala fituese etj. Lojërat, po ashtu, dallohen sipas vendit ku zhvillohen këto, që lidhet edhe me grup-mosha të ndryshme, në një anë janë ato që luhen nga të rriturit nëpër të a.q. oda burrash, zakonisht gjatë dasmave e tubimeve dhe nga ana tjetër, lojëra që janë luajtur në terren të hapur, duke u shërbyer si lodra, shkopinj të gurët. Lojërat, po ashtu ndahen edhe sipas gjinisë, kështu vajzat bënin kukulla nga materiale natyrore, me shkopinj dhe me arna, por luanin edhe lojëra me gurë. Jeta në fshat dhe veprimtaria që ata kryenin, mendohet këtu në bujqësinë dhe në blegtorinë, bënin që edhe fëmijët të përfshihen në këto punë, të cilët derisa kryenin punën e bariut, të zhvillonin lojëra të shumta, duke u bërë të njohura në popull edhe si *lojëra çobanësh*.

Lojërat tradicionale popullore kanë edhe një dimensionin tjetër tallës e ironik, i cili shprehet në formë të dënimeve nga më të ndryshmet për humbësin, me çka loja shndërrohet në një aktivitet më kompleks edhe në rrafshin sociologjik e psikologjik.

Lojërat tradicionale në përgjithësi nuk ndryshojnë në pikëpamje të rregullave, dallimi qëndron kryesisht në emërtimet e këtyre lojërave, të cilat kanë logjikën e tyre të shprehjes së kuptimit, duke u shndërruar në një pasuri tjetër të rëndësishme leksikore të kulturës popullore të shqipes. Lojëra të njëjta apo të ngjashme, sipas rajoneve e fshatrave, dallojnë në emërtime apo ndryshojnë nëpër variacione fonetike, si p.sh. *doskë/duckë* apo ato të cilat përdoren si sinonimike; atë që në Patishkë e quajnë *lojë çupesh*, në fshatra e tjerë të Karshiakës e quajnë *kacar* dhe kjo shtrirje është edhe më e gjerë, nëse

merren parasysh edhe të folmet tjera në Maqedoni e që për-caktojnë edhe gjeografinë gjuhësore të këtyre emërtimeve⁷. Humbja, përkatësisht harresa, si dhe mosekzekutimi i lojërave, do të ndikojë drejtpërdrejt edhe në fjalorin e gjuhës shqipe, të cilat i përkasin një leksiku arkaik popullor.

Të dhënat mbi lojërat e prezantuara në vazhdim janë marrë kryesisht nga fshatra të Karshiakës të rrethit të Shkupit, por të njëjtat i gjejmë edhe në fshatrat tjerë të regjionit të Maqedonisë e më gjerë. Pa trajtuar anën e hollësishme teorike të lojërave dhe të funksionit të tyre, do të ndalemni në përshkrimin dhe rregullat e lojërave.

Lojëra popullore që luhen në terren : Këto lojëra luhen në vende të hapura dhe si lodra përdorin shkopin dhe një top druri apo ndonjë send tjetër të origjinës shtazore e që mund të shërbejë si top, p.sh. *ashiku*.

1. *Doska*

Doska është lojë që luhet në terren me më shumë lojtarë. Kjo është lojë me shkopin dhe një *doskë* (top). *Doska* është e bërë prej një cope druri, e gdhendur, në formë sferike. Kjo lojë luhet ashtu që bëhet një gropë më e madhe në mes dhe dy gropa tjera anësh, sa për të vënë këmbët, për secilin lojtarë, duke marrë pozicionin. Qëllimi është që njëri të fus *doskën* në gropë, ndërsa dy të tjerët e pengojnë atë. Gjithashtu, ai që hedh *doskën* mundohet që ta hedh atë sa më larg, që tjetri të largojë këmbët nga gropa dhe në këtë mënyrë t'ia zë vendin. Ai që lëshon vendin, largohet nga gropa, del humbës dhe ai që ia zë vendin fiton. Edhe nëse e qëllon ta fus *doskën* në gropë, lojtarët që e pengojnë atë, duhet të ndërrojnë vendet,

⁷ Sa për ilustrim, *loja çupesh* në Dërven e quajnë *take-tuke* dhe pengesën e gishtave (që sqarohet në vazhdim) e quajnë *baba*, kalimin e gurit nëpër atë pengesë i thonë "*me bo babën*". Sadete Limani (1957).

por po ashtu duhet të kenë kujdes që ai që e hedh *doskën*, mos t'ia zë vendin ndonjërit prej tyre.

Në Patishkë, kjo lojë quhet *duckë*, “*asaj topkës i thonë duckë, ajo prej druni bonet*” dhe vlejnë të njëjtat rregulla të lojës, mirëpo, në lojë, topi i drurit është zëvendësuar nga *ashiku* (është i vogël i këmbës së deles).

2. *Doskë me spajnc*

Është lojë për më shumë persona, që luhet në rreth. Që të gjithë kanë shkopin dhe secili para vetes ka nga një gropë të quajtur *spajnc*, e cila shërben për të mbajtur shkopin e vet. Në mes qëndron njëri, i cili gjithashtu ka një shkop. Ky ua hedh *doskën* lojtarëve dhe duhet të pres momentin që ata të gabojnë dhe të largohen nga vendi i tyre me qëllim që ai të zë *spajcin*. Ai që humb, në këtë rast ai që ka humbur vendin, hy në mes dhe loja përsëritet.

3. *Shkapoll*

Luajnë një numër i pacaktuar i personave me shkopin të gjatë. Personat duhet shkopin ta hedhin në atë mënyrë që ai të bëjë rrotullime vertikale, këtë rrotullim e quajnë *pila*. Qëllimi është që shkopit të hedhet sa më larg. Ai që e hedh shkopin në largësi më të vogël, duhet të lë kësulën e vet në vendin ku ka rënë shkopit i tij, të tjerët pastaj duhet t'i bien kësulës, me qëllim që të shqyejnë atë. Kanë të drejtë vetëm nga një herë t'i bien kësulës.

4. *Çelik e çamak*

Çeliku, është loja më e përhapur në Karshiak e më gjerë dhe nga të intervistuarit kuptohet se është luajtur deri vonë (përfshihet këtu gjenerata 50 vjeçe). Emërtimi është *çelik* apo *çelik e çamak*, *çeliku* është shkop i gjatë prej 20 centimetra i prerë pjerrtas mënjanë dhe *çamaku* është shkop i gjatë prej një metër. Pozicioni prej nga niset lojtari është i caktuar, ashtu si

edhe largësia e hedhjes së çelikut, e cila përcaktohet me një gur dhe varësisht se kush është më afër cakut/gurit, caktohet edhe humbësi/fituesi; ai që është më larg cakut del nga loja dhe hy tjetri.

Të gjitha këto lojëra kanë karakter garues.

Lojëra popullore që luhen në oda

Lojërat që luhen në tubime të burrave janë:

1. *Loja me filxhanë* luhet me 9 filxhanë. Lojtarët ndahen në dy palë, me pjesëtarë të barabartë dhe të pozicionuar njëra përballë tjetrës. Në tepsi radhiten filxhanët dhe në njërën fshihet *mihiri* (unaza apo guri). Tepsia e vendosur në mes, rrotullohet, ashtu që të kërkojnë nën cilin filxhan gjendet unaza apo guri. Dy vetë kanë të drejtë të kërkojnë unazën, përkatësisht një nga njëra dhe një nga tjetra anë. Nëse me të parën herë e gjen *mihirin*, numëron dy pikë, nëse e gjen në të dytën apo të tretën herë fiton një pikë. Ka të drejtë vetëm tri të tërhequra të filxhanit që të gjejë *mihirin*. Luhet deri në 21 pikë, pala që humb është e detyruar që të kryejë urdhrat e palës fituese. Zakonisht është kërkuar të këndohet një këngë, të mbahet dikush në shpinë, të imitojë kafshët, të mbushë ujë, të vrapojë nëpër oborr etj. Mirëpo, ka pasur raste kur kjo lojë është paguar me jetë, kështu që kjo lojë më vonë është ndaluar.

2. *Loja me shami* është po ashtu lojë që luhet me një numër më të madh lojtarësh, të pozicionuar në rreth. Qëllimi është fshehja e unazës në njërën dorë të një lojtari, ashtu që të tjerët njëri pas tjetrit duhet ta gjejnë se cili është njeriu që e ka atë. Nëse nuk e gjen se te cili njeri është fshehur unaza, atëherë ai ndëshkohet, duke i rënë duarve me një shami a postiqe të përdredhur dhe të lidhur në fund, me qëllim të shkaktimit të

dhembjes kur i bie me të. Loja përsëritet derisa të gjejnë una-zën e fshehur dhe pastaj ndërrohen lojtarët.

Këto lojëra kanë më shumë karakter argëtues e tallës, që shprehet edhe në format e ndryshme të ndëshkimit të palës humbëse.

3. *Loja e shtombës*: Në një mënyrë kjo është lojë fjalësh, në të cilën lojtarët përdorin shprehje të caktuara që lidhen me marrje-dhënie të shtambës. Loja zhvillohet me të gjithë anëtarët pa dallim gjinie dhe me pyetje e përgjigje; përshtkrim i lojës:

– *Shkonjim mysafir e kishim një shtomb, uji si mbahet, e mbanja un kit shtombën e ti m'pyetën mu: "Pse e mban shtombën", thom "Po kujt t'ja jap", ti do t'thush "Jepja Hasibes", vajza do t'thore: "Pse Hasibes, jepja Ibes", ajo qi e mirte shtombën lipet menjiher fjalën ta fole, si mos t'fole, ajo do e mbanje shtombën ... ajo shtomba shkon te ti, shkon te vajza, shkon te Hasibja, shkon te une, me rend shkon*⁸.

Lojërat e vajzave nuk janë të shumta në numër, si ato që luhen nga djemtë. Këto më shpesh vetë i kanë punuar kukullat nga materiale natyrale, dru dhe arna, por kanë luajtur edhe lojën me gurë. E këtillë është loja çupesh në Patishkë, por në fshatrat tjerë e quajnë *kacar*. Loja *çupesh*, për të cilën shprehen si *lojna vashash*; thirren në lojë: "*ajde lujna çupesh*"; *un i kam luejt kur kam qon e vogel, kur kam qon klasa dyt, klasa tret ...*⁹ Loja luhet me 5 gurë, që në Patishkë i thonë *dyska/gur*, gjatë së cilës, lojtarja duhet të veprojë shumë shpejt. Lojtarja me njëren dorë hedh një gur lartë dhe me po të njëjtën dorë (dorën e djathtë), kap gurët një nga një. Kapja e gurëve, numri i të cilëve ndryshon, duhet të ndodh para se të bie guri i hedhur lart. Loja zhvillohet ashtu që hidhet një gur lart dhe


⁸ Istref Beqiri, f. Patishkë

⁹ Fatime Bilalli, f. Patishkë.

merret një gur nga poshtë dhe duhet të arrijë të kapë edhe gurin e hedhur para se ai të bie në tokë. E njëjta gjë, përsëritet edhe me gurët tjerë, duke kaluar në rrethinë e dytë me dy gurë, me tri gurë në të tretën dhe katër gurë në të katërtën. Kështu përfundon një pjesë e lojës. Pjesa e dytë e lojës përbëhet nga një pengesë gishtash të dorës së majtë, e cila krijon një kalim të ngushtë për të futur brenda saj gurët, një nga një, duke përsëritur veprimin e njëjtë me hedhjen e gurit lart dhe të veprimit të shpejtë. Ky kalim quhet *baba*, por diku *baba* quhet guri, i cili hidhet lart për gjatë tërë lojës. Në përfundim të lojës, gurët vendosen mbi shpin të dorës dhe të gjitha hidhen lart përnjëherë dhe përsëri priten në pëllëmbë të dorës.

Lojëra tjera

1. Loja tjetër ka më shumë emërtime të ndryshme: *kërc-bëm* apo *kërc-bum*, *bum*, e diku përdoret emërtimi *dom* e *dum*, derisa në turqishte është *dokus taş*, që do të thotë “9 gurë”, që në disa të folme ka dhënë emërtimin si *dagertash*, apo e një forme krejtësisht tjetër, *takërzhik*, *dagerzhik*. Kjo është lojë që luhet me skemë të përkufizuar dhe numër të caktuar gurësh, nëntë apo dymbëdhjetë gurë:



a. Skemë e lojës me 9 gurë

b. Skemë e lojës me 12 gurë

Është një lojë shumë e vjetër dhe e përhapur në më shumë vende tjera të huaja. Loja është për dy vetë dhe luhet me gurë të bardhë

e të zi, por në vendin tonë, në lojë janë përdorur kokrra misri dhe groshe, njëri ka 9 kokrra misër dhe tjetri ka 9 kokrra groshë. Loja zhvillohet me rregulla mirë të përkufizuara:

- Skema përbëhet nga 24 pika, nëpër të cilat do të pozicionohen dhe do të lëvizin gurët. Fillimisht zënë pozicionet me nga një gur (*grurë/groshë*, në vazhdim: *gur*). Qëllimi është vendosja e tri gurëve në vijë horizontale a vertikale, gjatë të cilës kundërshtarët, do të duhen të pengojnë njëri-tjetrin që mos të arrijë vendosjen e tri gurëve.

- Lojtarët vetë vendosin se kush do të fillojë i pari dhe gjatë lojës ndërrojnë vendet. Kur njëri prej lojtarëve arrin të vendosë tri gurë në një vijë, ai ka të drejtë të marrë një gur nga kundërshtari.

- Lojtarët vazhdojnë lëvizjet me qëllim të marrjes të gurëve të njëri-tjetrit, deri kur të arrijnë në tri gurë dhe në këtë rast ndryshon rregulla e lëvizjes.

- Në këtë fazë nuk ka përkufizim të lëvizjes, por lojtari mund të kërcejë në cilindo vend të lirë¹⁰.

Loja ka marr emërtimin *kërc bëm/kërc bam*, *kërc-bum*, nga emri i përbërë, me ç'rast përdoret shprehja *kërc*, kur i afrohet kundërshtarit dhe *bam* apo *bum*, diku thuhet edhe *dum*, në momentin kur e vendos gurin e tretë në një vijë dhe merr një gur nga kundërshtari. Te ne më shpesh luhet loja me nëntë gurë, rrallë ajo me dymbëdhjetë edhe pse ka edhe me tre dhe me gjashtë gurë.

2. *Lugati* është lojë shumë e vjetër dhe mendimet janë se kjo është e periudhës parakrishtere, e cila ka të bëjë me maskimin dhe ka një karakter tjetër nga lojërat që kishin karakter garues,

¹⁰ Historiku i kësaj loje daton që nga koha e Mbretërisë Romake, në Angli ka qenë e popullarizuar në Mesjetë, por luhet edhe në kontinentin e Afrikës. http://en.wikipedia.org/wiki/Nine_Men%27s_Morris

duke marrë parasysh se është luajtur kryesisht nga burra. Kjo lojë është praktikuar deri vonë nëpër dasma a tubime, nëpër oda burrash (udhëhiqem nga intervista e njerëzve 70 e më shumë vjeçar), mirëpo ka fituar karakter argëtues. Maska e lugatit është parafytyrimi i një krijese të imagjinuar dhe njeriu me identitet të fshehur, e lyen tërë fytyrën, ashtu si edhe duart me *fir*, duke dalluar vetëm sytë, ndërsa dhëmbët i bën nga qepa. I tëri vishet me të zeza për të krijuar pamje sa më reale të frikshme dhe me një gjilpërë, të fshehur mes gishtash, tenton të shpojë dikë nga turma e tmerruar, të cilët ikin për të mos i kapur lugati. Zakonisht, zë ndonjë më të dobët dhe që frikohet sa për të menduar se është reale.

Pak më ndryshe është në disa fshatra tjerë të Karshiakës, të cilët transformimin e arrijnë duke lyer fytyrën dhe duart me miell dhe vishen me këmishë të gjatë të bardhë (këmishë e grave). Për të plotësuar pamjen, në gojë ve një patate të prerë në gjysmë, në pjesën e prapme të patates ve një pare, mone-dhë dhe në gjysmën e përparme të patates shtie një gjilpërë. Ashtu i maskuar i shkon njerëzve kinse për të lëmuar dorën dhe në këtë mënyrë i shpon ata. Kështu qëndron për një kohë, duke e tallur e duke thënë: “vjen lugati”.

Të maskuarit, gjithmonë zhvillohen nga një person, i cili ka aftësi transformimi dhe aktrimi. Po kështu i veshur, ai mund të bëhet ajo dhe të hyjë në mes të grave me qëllim të aktrimit të vajtimit me zë të lartë, sikur të qajë ndonjë vajzë, e cila përgatitej të shkojë nuse.

Çështja është se a mund të ringjallet kjo trashëgimi apo si mund të ruhet në situatë kur më është më se e qartë se kultura materiale edhe ajo shpirtërore po zhduken, të vetëdijsëm se shumë pak do të gjejmë nga e kaluara në terren, atëherë është e arsyeshme të orientohemi në mbledhjen, regjistrimin dhe

përpunimin e të njëjtës, të organizohen etnofestivale, të cilat në një mënyrë do të nxisin promovimin e vlerave kulturore.

Nga intervistat që zhvillohen në terren, dalin edhe shumë lojëra tjera me emërtime interesante, të cilat presin të regjistronen e që kanë rëndësi shumëfishe, duke qenë edhe një prurje në kuadër të leksematikës dhe të etnografisë popullore, si vlerë e trashëguar kulturore të shqiptarëve.

Intervista: Istref Beqiri

Loja me filxhana: *E lunjim filxhana gjymsa oda e jemja, gjymsa e jotja, si kan ardhe t'bonje muhabet, gjer ktu esht e jotja, gjer ktu e jemja, kur t'sosën ata filxhanat, ... marin çymbet e shporetit, e marin një paçavër e e mshyen çymkën e shporetit brenda e i lyejn, se ka hup, me at thirin, insanin e luejn, ai si i ka hup filxhanat, ai si e ka marr, e merr at paçavrën e shtyen n'çymk, e lyen si e ka mund ai ma i pari, e lyen me thir, bonet i zi, e bajn sikur nuk luejn mir, hoka me bot, kryetari si i çon ato filxhanat, e mer një postaqi, atherë kishte postaqi, dhen sa t'duesh, e vërtite kshtu, rinjin unj, ajo partia si ka humb i sillnin krahve, bom e bom, me postaqi, e mbledh postaqin edhe unjin ata, e n'krahët u sillnin.*

Vjen rendi me pajtuet a e di, vjen rendi se nuk jemi idhnuet pajtojm, ani si na ke lyejt me qymyr t'zi, vjen rendi me pajtuet.

Sa lojtarë kanë luejt?

Sikundra t'vinjin mysafiri, ka 10 vet 15 vet, por na nuk i njënim ato,

... e mirnjim një shkop e mbanjim e u sillnim komve tap, gishtave t'komës, t'bore rend, t'bore drejt, t'vine oda t'zbrazet, hoka bonjim përpara ...

Lugati: *un i bojsha lugat, e mirnja një knish, përpara i mban—jin ata knisha t'gjata, gjer te komët, durt i bardh, e mirnja miell e bonja i bardh, e mirnja një pesdhet pare, athere kishte pesdhet para, gjashtdhet para, ... e mirnja një kompir e prinja e vinja at pesdhet pare n'kompir, mom hypne n'gjuh, e shtinja at gjylponën n'kompir e lujsha, s'ëm njohnjin se kush jam, e shkonja te ata insan, kurse limon dorën e i shponja, ... masan—dej ndenjëm njëher lugati, vampiri, vjen vampiri ...*

Të intervistuar:

Naif Mustafa (1941, f. Gaber)

Istref Beqiri (1928, f. Patishkë)

Zekir Feruki (1941, f. Alldincë)

Bilall Shaqiri (1951, f. Patishkë)

Fatime Bilalli (1952, f. Patishkë)

Shadie Fetai (1955, f. Paligrad)

Ibe Mustafa (1961, f. Patishkë)

IZAIM MURTEZANI,

Instituti i Folklorit – Shkup

KARNAVALI I BOZOVCËS

(Midis zhdukjes dhe institucionalizimit të tij)

1. Hyrje

Karnavali i Bozovcës paraqet një manifestim tejet të rëndësishëm të traditës sonë popullore, sidomos të shqiptarëve të Maqedonisë. Ai, madje është i vetmi i kësaj natyre që ka arritur t'i mbijetoj kohës dhe njëkohësisht të përdëftojë se etnokultura jonë është e larmishme dhe në brendinë e saj ngërthen vlera të shumëfishta që pasqyrojnë mendësinë, sidomos të njeriut me bindje pagane. Karnavali i Bozovcës që nga vendasit është pagëzuar si *karnaval ilir* ka mbijetuar vetëm në këtë fshat të malësisë së Sharrit,¹¹ edhe pse në të kaluarën është praktikuar edhe në fshatrat tjera fqinje të këtij rajoni malor. Ky karnaval është tejet domethënës, pasi përmban në brendinë e vet elemente të shumta pagane që gjithsesi se duhet të ruhen edhe në të ardhmen, pasi paraqesin një artefakt të rëndësishëm të etnokulturës sonë, sidomos të asaj me bazament tradicional.

Karnavali i Bozovcës, veneruar nga dioptria e klasifikimit të karnavaleve në dy grupe, përkatësisht në magjik dhe kritik, i përket kryekëput llojit të parë, apo atij magjik. Përndryshe,

¹¹ Meritat më të mëdha për mbajtjen në jetë të këtij karnavali i takojnë padyshim ideatorit dhe njëherit kryetarit të këtij manifestimi kulturor, Neshat Mehmedi nga i cili edhe i siguroam të gjitha të dhënat rreth manifestimit në fjalë.

veçoritë e karnavalit magjik ndërlidhen me autencitetin, apo lashtësinë e tij, ekzekutimin nëpër lokalitete kryesisht të karakterit blegtoral, pastaj praninë e shenjave të qarta të mbijetësive të besimeve magjike dhe riteve që i dedikohen pjellorisë, praninë e magjisë apotropeike dhe gjurmëve të paraardhësve që i hasim në to. Në të vërtetë, magjia e pjellorisë qëndron si zakonisht çdoherë në bazën e shumicës së kulteve të lashta. Pra, në frymën e këtyre veçorive, karnavali i Bozovcës, është fund e krye i karakterit magjik për dallim nga lloji i dytë i të ashtuquajturit karnaval kritik që haset kryesisht në mjediset urbane dhe ku del në shesh qëndrimi kritik i pjesëmarrësve të tij kundruall realitetit shoqëror, përkatësisht dukurive devijuese të shoqërisë. Edhe më i qartë në drejtim të distinkcionit mes dy karnavaleve është studiesi i njohur kroat Ivan Lozica i cili me të drejtë thekson se lloji i parë i karnavalit, apo i ashtuquajturi *magjik* ose *luperkalian* si tipik për mjediset rurale, karakterizohet me maskimin grupor të meshkujve në kostume të lëkurave zoomorfe dhe mbajtjes së kambanave në këto veshje. Ndërkaq, lloji i dytë i karnavalit i cilësuar si *kritik*, ose *saturnalist*, në shumicën e rasteve është i pranishëm në mjedise urbane dhe në epiqendër të tij ka raportin mes njeriut dhe shoqërisë, përkatësisht rendit shoqëror (Lozica, 1997: 192–193).

Megjithatë, që të kuptojmë më mirë konstatimet që u dhanë më lartë, por që do jepen edhe në vazhdim, paraprakisht do të paraqesim përmbajtjen e këtij karnavali që zhvillohet në f. Bozovcë të Tetovës. Ky karnaval në trajtën e tij klasike, nënkuptonte pjesëmarrje të protagonistëve që nuk e kalonin numrin mbi njëzet. Që të gjithë karnavalistët ishin të moshës madhore, shtatlartë, madje edhe të shkathtë, apo të zhdërvjelltë në kuptimin e ekzekutimit sa më efikas të ritualit në fjalë. Në mesin e këtyre karnavalistëve që ishin kryesisht nga fshati

Bozovcë, mund të kishte ndonjë edhe nga fshatrat tjera fqinje, por nevojitej që të dallohej në këtë veprimtari rituale. Karnavalistët kishin një udhëheqës të grupit të tyre e ky ishte kryeplaku, rolin e të cilit e luante ndonjë karnavalist i dalluar. Kryeplaku i maskuar ua diktonte urdhërat gjatë ekzekutimit të aktivitetit ritual. Ai qëndronte i hypur mbi gomar, apo e tërhiqte atë për kërpeshi, kurse pranë tij ishin edhe dy vajzat e reja, pastaj nusja e re, por edhe plaka. Që të gjitha këto femra – pjesëmarrëse të drejtpërdrejta në ritualin e karnavalit, nuk posedonin maska në kokë dhe e shfaqnin identitetin e tyre gjinor haptazi duke qenë të veshura me kostume tradicionale të fshatit në fjalë. Këto protagoniste femra, në të vërtetë, ishin meshkuj që aktrnin rolin e femrave. Të gjithë protagonistët tjerë posedonin maska në kokë, kryesisht me prapavijë zoomorfe. Si protagonist i karnavalit ishte edhe figura e Arapit të Zi i cili nuk posedonte maskë në kokë, por fytyrën e kishte krejtësisht të nxirë, apo të zezë.

Karnavalistët e fshatit pasi ekspozohen me maskat e tyre në sheshin e fshatit vazhdojnë pastaj me aktivitetin e tyre ritual, përkatësisht vizitën, apo përshkrimin e të gjitha shtëpive të fshatit. Me të nisur rrugën ky kortezh i karnavalistëve, nën tingujt e zhurmshëm të kampanave dhe lojës së tyre, dikush nga publiku i pranishëm, tenton t'ua grabit vajzat, apo nusen e re që janë nën mbrojtje të rreptë të karnavalistëve. Në funksion të neutralizimit të armiqve, karnavalistët posedojnë trasta të mbushura me hi dhe sipas nevojës i mbushin grushtat e duarve me hi dhe ua hudhin kah sytë atyre që tentojnë t'ua grabisin vajzat, apo nusen e re. Ata vazhdimisht janë nën trysninë e kësaj grabitjeje dhe vazhdimisht janë vigjilentë që të mos ndodh një gjë e tillë. Madje, karnavalistët edhe kur futen nëpër oborre të shtëpive, kryeplaku, apo prijësi i tyre, u jep

urdhër atyre që t'i ruajnë portat e hyrjes me qëllim që të mos depërtojë brenda ndonjë rrëmbyes gjoja i femrave karnavaliste. Karnavalistët në cilësinë e armës posedojnë edhe shkopinj të cilët edhe mund t'i përdorin nëse insistimi i rrëmbyesit është i fuqishëm. Madje ka pasur raste kur edhe është përdorur dhunë e skajshme kundër rrëmbyesve të vajzave dhe nuses së re.

Nëpër oborret e të gjitha shtëpive të fshatit ku futen karnavalistët, sidomos ato të gjinisë femërore, nën përcjelljen e tingujve të defit, këndojnë këngë të ndryshme. Këngët u referohen, si zakonisht djemve të rinj që janë pranë fejesës, ose martesës, madje duke ua përmendur edhe emrat e tyre. Në vazhdim i japim vetëm disa vargje të këngëve të kësaj natyre, si: *Nause do t'i zam Agron agës, / Nause do t'i zam pi Veshalle, / se e kemi gjalin me halle, ose Bilibili në lam, bilbili në lam, / Agron agës nausea do t'i zam, / Nause do t'i zam pi Brodeci, / se e kemi atë gjal hasreti*. Nëse në atë shtëpi ku hynin karnavalistët nuk kishte djem për martesë, atëherë kënga u referohej fëmijëve që ishin në prag të synetisë, si: *Ka hip Shpëtim aga përmbaj çeshëm, / do bahem sinet se jam i heshëm, apo Ka dal Riza aga me ni kodër, / do ta bajm sinet se asht i vogël*. Në çastin kur përfundonte kënga, karnavalistëve në cilësinë e peshqeshit, u jepej mish i freskët qengji, yndyrë, vezë, groshë, sheqer, kos, etj. Peshqeshet futeshin nëpër thasë të veçantë që i mbante gomari. Gjatë rrugëtimit të këtij kortezhi lemeritës, karnavalistët afroheshin shpinë për shpine dhe tringëllonin kambanat e tyre që sa më shumë të bënin zhurmë. Dikush vallëzonte nën tingujt e defave, kurse publiku argëtohej e qeshej duke u krijuar një atmosferë tejet e veçantë. Në përfundim të këtij aktiviteti, pasi do të përshkonin çdo shtëpi të fshatit, protagonistët e karnavalit, akumulonin të gjitha këto peshqeshe dhe përgatitnin një drekë të majme,

kurse pjesën e peshqeshit që mbetej si tepricë ia jepnin ndonjë të varfëri në fshat. Karnavalistët përgatitnin fli, birjan (mish me oriz), bakërdar, kurse e pashmangshme ishte edhe përgatitja e hallvës (Murtezani, 2014: 282).

Kjo ishte përmbajtja e shkurtër e karnavalit në fjalë, kurse për aspektin teorik të kuptimësisë së tij duke përfshirë analizën tejet të gjerë të të gjitha kategorive semantike të karnavalit, si kohëhapësirën, protagonistët, objektet dhe përkimet e tij me manifestime tjera të kohës antike, jemi ndalur në mënyrë detajuese në një trajtesë tjetër shkencore të publikuar në vitin 2014 në revistën Gjurmime albanologjike – Folklor dhe etnologji. Si rrjedhojë e këtij fakti, përkatësisht publikimit të tillë, në vazhdim do të ndalemi vetëm në aspektin e mundësisë së institucionalizimit të kësaj ndodhie kulturore që është edhe synimi kryesor i kësaj trajtese shkencore.

2. Legjislative e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore

Karnavali në fjalë, apo lojërat me maska që praktikohen edhe më tej në këtë fshat ndodhen para zhdukjes së tyre, si rrjedhojë e interesimit joadekuat të shoqërisë sonë, por njëherit edhe vetëdijes së ulët në drejtim të ruajtjes së trashëgimisë etnokulturore. Nënkuptohej se edhe koha në të cilën jetojmë, përkatësisht globalizmi gjithnjë e më shumë po i zhदारit vlerat me taban tradicional duke nxjerr në sipërfaqe vlera të reja kulturore me prapavijë universale si rrjedhojë e unifikimit të proceseve që zhvillohen në mbarë globin tokësor. Ky fakt është i mjaftueshëm që të konstatohet se vlerat e trashëgimisë sonë shpirtërore, por edhe atyre materiale gjithnjë e më shumë po zhbëhen dhe nevojitet një përkujdesje më e madhe në rigjallërimin dhe kultivimin e tyre. Megjithatë, edhe përkundra vështirësive të kësaj natyre, karnavali i Bozovcës, ka arri-

tur së paku të mbijetojë, andaj nevojitet një aktivitet më gjithëpërfshirës që do të shoqërohej edhe me ndonjë ndihmesë më solide të natyrës financiare, nënkuptohet nga institucionet adekuate me qëllim që ky aktivitet të standardizohej dhe të begatohej edhe më tepër në strukturën e tij përmbajtësore. Ky aktivitet gjithsesi se duhet të mbijetojë në cilësinë e një monumenti, apo dëshmie të rëndësishme të identitetit tonë kolektiv në një periudhë tejet të lashtë kohore, madje ndoshta edhe në vetë fillet e saj.

Në kontekst të ruajtjes së vlerave etnokulturore në Republikën e Maqedonisë, para disa vitesh është miratuar ligji i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore nëpërmjet të cilit përcajtohen dhe definojnë detajisht të gjitha çështjet që i referohen kësaj sfare. Në të vërtetë, sipas ligjit në fjalë, qëllimet themelore të mbrojtjes së trashëgimisë janë si vijon: ruajtja e trashëgimisë kulturore në gjendje burimore, krijimi i kushteve sa më të volitshme për mbijetesën e trashëgimisë kulturore dhe për ruajtjen e integritetit të të gjitha të dhënave që ajo i bart me vete si dëshmi, burim dhe dokument i llojit të vet, pastaj përhapja e njohurive që u dedikohen vlerave dhe rëndësisë së trashëgimisë kulturore, si dhe rolin e saj në identifikimin kulturor, pastaj aftësimin e trashëgimisë kulturore që sipas destinimit dhe rëndësisë së saj të shërbejë për përmbushjen e nevojave kulturore, shkencore, edukative, estetike, fetare, ekonomike, turistike dhe nevojave tjera të qytetarëve dhe të shoqërisë. Ndërkaq, qëllimi operativ i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore është ndërmarrja e aktiviteteve për pengimin e veprimeve, dukurive dhe ndikimeve me të cilat mund të dëmtohet, asgjësohet, apo degradohet çdo lloj i kësaj trashëgimie. Qëllimi përfundimtar i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore është bartja e saj te gjeneratat e ardhshme.

Ligji në fjalë përcakton dhe definon edhe llojet e trashëgimisë kulturore, pastaj kategoritë e saj, identifikimin, mënyrat e vënies nën mbrojtje dhe instrumentet tjera të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, regjimin e mbrojtjes, shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore e kështu me radhë. Po ashtu, përcaktohen edhe subjektet e autorizuara për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore me ç'rast theksohet se realizimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore është para së gjithash detyrë dhe përgjegjësi e shtetit dhe organeve të tij, si dhe shërbimeve publike. Gjithashtu, kujdesi për trashëgiminë kulturore dhe respektimin e saj është detyrë edhe e çdo qytetari. Me qëllim që të administrohet dhe menaxhohet më mirë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në kuadër të Ministrisë së Kulturës ekziston një institucion i veçantë i pagëzuar si Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.

Ndërkaq, në kontekst të trashëgimisë kulturore të shqiptarëve të Maqedonisë, në vija të përgjithshme, mund të thuhet se ajo është e rrezikuar tejmasë, pasi nuk i kushtohet ndonjë vëmendje e veçantë institucionale duke pasur parasysh mungesën e kuadrit profesional, por edhe një varg faktorësh tjerë që tani nuk janë pjesë përbërëse e trajtesës sonë shkencore. Sido që të jetë, në kushtet e tanishme duhet bërë përpjekje që edhe trashëgimia jonë kulturore të përfitojë vendin e duhur në kuadër të tentativave për ruajtjen dhe mbrojtjen e saj. Në kuadër të kësaj trashëgimie kulturore, një vend të theksuar zë edhe trashëgimia shpirtërore e cila është e llojllojshme dhe tejet e pasur. Një margaritar i kësaj trashëgimie është padyshim edhe karnavali i Bozovcës, apo lojërat me maska që ngërthejnë në brendinë e tyre një numër të madh të vlerave kulturore me prapavijë kryesisht të karakterit pagan.

Në frymën e ligjit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në të cilin parashihet mes tjerash edhe valorizimi i trashëgimisë kulturore, autori i këtij punimi hartoi elaboratin e lojërave me maska që ekzekutohen në fshatin Bozovcë të Tetovës me qëllim që ky manifestim të shpallet si vlerë e rëndësishme kulturore e shqiptarëve të Maqedonisë dhe të përfsihet nën tutelën e mbrojtjes shtetërore. Valorizimi nënkupton vlerësimin profesional dhe shkencor të vlerave dhe vetive të një njësie kulturore të trashëgimisë sipas kriterëve të përcaktuara më parë, në funksion të vënies së saj nën mbrojtje dhe përkuqdesje adekuate. Hartimi i një elaborati të tillë, apo konkretisht i lojërave me maska në fshatin Bozovcë nënkupton posedim të njohurive paraprake me qëllim që të jepen përgjigje adekuate në pyetjet dhe kërkesat e parashtruara. Theni lojërat me maska e jo karnavali i Bozovcës, pasi në klasifikimin nacional të trashëgimisë kulturore në R. e Maqedonisë, nuk ekziston ndonjë nëndarje në të cilën do të ishin përfsihire edhe karnavalet në cilësinë e vlerave të trashëgimisë kulturore, apo më konkretisht të asaj shpirtërore. Duhet theksuar se klasifikimi nacional i trashëgimisë kulturore, është rrjedhojë e sigurimit të qasjes së unifikuar në identifikimin e trashëgimisë kulturore dhe krijimit të një sistemi informativ të trashëgimisë kulturore me një krahasim cilësor dhe përdorim të lehtësuar të të dhënave. Në mungesë të karnavalit si pjesë përbërëse e klasifikimit nacional të trashëgimisë kulturore u detyruam që të gjejmë ndonjë nëndarje tjetër më të përshatshme dhe kjo gjithsesi se kishte të bënte me lojërat me maska që kishin gjetur vendin e tyre në kuadër të klasifikimit të sipërpërmendur.

3. Tentativa për shpalljen e Karnavalit të Bozovcës si vlerë kulturore

Në kuadër të plotësimit të elaboratit për valorizimin e karnavalit, apo lojërave me maska në fshatin Bozovcë të Tetovës figurojnë një numër i madh i kërkesave në formë të parashtrimit të pyetjeve që duhet t'u jepen përgjigje të duhura me qëllim që të arsyetohet kërkesa për shpalljen e kësaj njësie kulturore si vlerë e trashëgimisë kulturore në R. e Maqedonisë. Në vazhdim do të japim disa nga kërkesat themelore të elaboratit dhe nënkuptohet përgjigjet ndaj tyre duke pasur parasysh gjithnjë lojërat me maska, apo karnavalin e Bozovcës. *Datimi.* Shumë vështirë është të jepen të dhëna precize në raport me kohën e paraqitjes së këtij rituali, përkatësisht maskimit, apo karnavalit të Bozovcës, pasi në literaturën shkencore etnologjike, mungojnë dokumente të shkruara që do të ndërlidheshin me ndonjë kronologji konkrete historike. Megjithatë duke u nisur nga elementet përbërëse që hasen në përmbajtjen e tij, mund të supozohet se karnavali, apo lojërat me maska janë shumë të lashta dhe janë të ndërlidhura me kohën e besimit pagan, ose thënë më konkretisht me kultin e pjellorisë, kurse njëkohësisht edhe me kultin dedikuar paraardhësve tanë. Me vetë faktin se lojërat me maska në f. Bozovcë të Tetovës ekzekutohen në kohën e krenimit të Ditës së Verës (14 Mars) mund të konkludohet se nëpërmjet tyre shënohet kalimi nga një periudhë kohore në një periudhë tjetër kohore, apo thënë më mirë, në aspektin kohor shënohet kalimi prej errësirës drejt dritës, apo prej kaosit kah kozmosi ose thënë më thjeshtazi – prej dimrit kah vera, kurse nga prizmi i kodit socio-ekonomik, shënohet edhe një lloj kalimi prej pasivitetit shoqëror kah aktiviteti shoqëror, pasi natyra fillon të

zgjohet dhe kjo është shenjë se mund të fillohet me aktivitete që janë të ndërlidhura me bujqësinë dhe blegtorinë.

Karakteristika të veçanta. Ky ritual, apo lojërat me maska zhvillohen, siç thamë më lartë, me rastin e tranzicionit nga një periudhë kohore, siç është dimri, në një periudhë tjetër kohore, siç është vera, pasi sipas logjikës pagane, viti kalendarik ka qenë i ndarë në dy pjesë, përkatësisht vetëm në dimër dhe verë, stinë të cilat janë ndërruar, apo shkëmbyer në mënyrë ciklike. Edhe pse, kohëve të fundit, këto lojëra me maska në f. Bozovcë zhvillohen rreth festës të Ditës së Verës (14 Mars), nuk përjashtohet mundësia që në të kaluarën të jenë zhvilluar edhe rreth festës së Krishtlindjeve, apo pas festës së Buzmit kur fillon dita të zmadhohet dalëngadalë dhe në këtë mënyrë të paralajmërohet se koha fillon të lëvizë kah vera. Edhe me këtë rast, përkatësisht poqese ishte ekzekutuar rituali në fjalë edhe në këtë periudhë kohore bëhet fjalë për një rit të mirëfillt të kalimit, pasi me kremtimin e Buzmit fillon rruga e kthimit të diellit për në verë. Duhet shtuar me këtë rast se në etnologji, koha e kalimit nga një periudhë e vjetër në një periudhë të re kohore, njihet me termin kohë *liminale*. Antropologu Viktor Turner thekson se faza liminale që shënon njëkohësisht fundin e një periudhe kohore dhe njëkohësisht kalimin në një periudhë të re kohore, apo shoqërore, karakterizohet me simbole të shumta të vdekjes, mes tjerash edhe me errësirë, pastaj me elemente të bipolaritetit gjinor e kështu me radhë. Po në këtë fazë, është e pranishme edhe dukuria e paraqitjes së protagonistëve me prapavijë demoniake dhe të lemeritshme (Turner, 1969: 95). Këto elemente janë të pranishme në fazën liminale, pasi bëhet fjalë për një “vdekje” simbolike rituale të një kohe, apo statusi shoqëror të skaduar. Këto elemente janë të pranishme në karnavalin e Bozovcës

duke përfshirë bipolaritetin gjinor në cilësinë e marrjes së rolit të femrave nga ana e meshkujve, pastaj praninë e protagonistëve me maska të lemerishme e kështu me radhë.

Edhe pse pjesëmarrësit e këtij kortezhi, përkatësisht lojërave me maska, nuk e dinë se cila është prapavija e vendosjes së maskave në fytyrat e tyre, megjithatë, sipas shumë studimeve të ndryshme të karakterit krahasimtar, mund të konstatohet se maskat paraqesin personifikim të të vdekurve, të cilët pikërisht në periudhat kohore që shënojnë kalim nga një periudhë në një periudhë tjetër kohore, përzihen me të gjallët dhe në këtë mënyrë krijohet një ndërveprim i llojit të vet mes të vdekurve dhe të gjallëve. Në këtë drejtim, studiuesi zviceran Mojli thotë se njëherë në vit, pikërisht në këtë tranzicion kohor (kalim nga dinri në verë) hapet bota nëntokësore dhe të vdekurit mund të shëtiten lirshëm edhe në këtë botë. Studiuesi i religjioneve, Mirça Elijade, thotë se në këtë ditë kur kalohet në kohë të re, bota konsumohet, apo harxhohet dhe fuqitë ktonike janë të shumta dhe kështu ndodh një kontakt i llojit të vet mes të gjallëve dhe të vdekurve. Pra, logjika e këtyre lojërave me maska mund të ndërlidhet me faktin se viti që po skadon, apo kalon afrohet kah dita e fundit, përkatësisht kah pika më e largët e Kaosit, ose asgjësimit, apo rrënimt, kurse njëkohësisht në ardhje e sipër është një lindje e re, përkatësisht Kozmosi. Kështu, në këtë pikë kritike ndodh takimi i llojit të vet mes fuqive të Kaosit – të personifikuara në imazhin, apo fytyrat e të vdekurve ose maskat e tyre dhe fuqive të Kozmosit, të personifikuara në fytyrat e të gjallëve (sipas Elijade, 2011: 465).

Në trajtë të sintetizuar mund të thuhet se në bazën e lojërave me maska të f. Bozovcë fshihet magjia e pjellorisë, pasi maskat janë të ndërlidhura me të vdekurit, përkatësisht me botën

nëntokësore. Sipas logjikës tradicionale, nga bota nëntokësore mugullojnë bimë të ndryshme nga të cilat sigurohet ekzistenca biologjike e njeriut. Personat e maskuar, përkatësisht shpirtrat e të vdekurve, pikërisht në ditën e kalimit në një periudhë të re kohore i vizitojnë të gjitha shtëpitë e fshatit, kurse si kundërpërgjigje fitojnë peshqeshe nga vendasit me qëllim që gjatë kthimit të tyre në botën nëntokësore të ndikojnë në ndjelljen e pjellorisë së bimëve dhe viti agrar të jetë më frytdhënës gjatë vitit në vazhdim. Në këtë mënyrë, gjatë këtij komunikimi të të vdekurve dhe të të gjallëve vendoset njëlloj marrëdhënieje mes dy botëve. Në funksion të pjellorisë janë edhe tentimet e publikut të pranishëm në karnaval, ose lojërat me maska që të grabitet ndonjë pjesëtare e gjinisë femërore (meshkuj të transformuar në femra) që është pjesë përbërëse e kortezhit të maskuar. Tentimi i grabitjes shkaktohet si rrjedhojë e dëshirës për “marrëdhënie seksuale” me protagonistet e gjinisë femërore të kortezhit të maskuar. Kështu, të dy vajzat e pranishme në karnaval (lojërat me maska) paraqesin personifikim të energjisë potenciale për pjellori e cila ende nuk është aktivizuar, kurse nusja paraqet mishërim të energjisë së pjellorisë e cila posa është aktivizuar. Plaka paraqet protagoniste me fuqi të konsumuar të pjellorisë që mund të mishërohet me dimrin si periudhë pasive e vitit kalendarik.

Lojërat me maska në fshatin Bozovcë të Tetovës, në strukturën e tyre të brendshme, fshehin shumë elemente që janë të ndërlidhura me kultet e lashta antike të Greqisë së Lashtë dhe Romës. Një manifestim i këtij lloji është organizuar për nder të hyjneshave Dhemetra dhe Persefona. Kështu, në Greqinë e Lashtë, për hir të perëndeshave të njohura si Dhemetra dhe bija e saj – Persefona organizoheshin kremtet e njohura si mistere eleusine. Kështu, “eleusinet e mëdha bëheshin në

vjeshtë (rrëmbimi i Persefonës dhe martesë e saj me Hadin – simbol i vjeljes së rrushit dhe të lashtave). Eleusinet e vogla organizoheshin në pranverë (kthimi i Persefonës në tokë – simbol i zgjimit të natyrës). Gjatë eleusineve të vogla që mbaheshin në pranverë, në muajt shkurt – mars, mes tjerash, rishitarët hynin në faltore ku mbretëronte një errësirë e madhe. Në ndërkohë, kubetë e tempullit, përshkoheshin prej vetëtimate – drita që linin të dukeshin aty-këtu fantazma të frikshme dhe figura të përbindshme” (sipas FM, 1988: 78). Nga kjo përmbajtje e shkurtër mund të vërehet se reflektimi i dritës që krijonte figura të përbindëshave ndoshta përkon me figurat reale, apo të maskuara të karnavalit të Bozovcës që me siguri u referohen shpirtave të ndjerë të cilët shëtiten në këtë botë në ditën e fundit të përmbylljes së një periudhe të vjetër kohore që në perceptimin mitologjik identifikohet me Kaosin, përkatësisht me përfundimin e dimrit dhe lindjen e një periudhe të re kohore, përkatësisht verës që identifikohet me Kozmosin. Në përmbajtjen e lojërave të tilla mund të shënohen edhe elementet që mund të ndërlidhen me kultin e përndisë Dionis. Gjithashtu, lojërat me maska mund të ndërlidhen edhe me disa festa romake, veçmas me luperkalitë që i dedikoheshin perëndisë Pan. Këto lojëra me maska ndërlidhen edhe me rite tjera të ngjashme të popujve të lashtë (saturnalitë, bahanalitë, etj).

Një veçori e rëndësishme e këtyre lojërave me maska është edhe kategoria e komikes e cila mund të ndërlidhet me magjinë e pjellorisë dhe mëkëmbjen e Botës. Nëpërmjet këtyre lojërave argëtohen dhe gëzohen njerëzit në vetë ditën kur ndodh kalimi në një vit të ri kalendarik. Të qeshurat zvogëlojnë tensionin shpirtëror, të shkaktuar nga droja se do të

mbretëroj dimri në mënyrë të amshueshme dhe se ndërrimi i viteve kalendarike do të ndërpritet.

Prejardhja. Në plotësimin e përmbajtjes së elaboratit të valorizimit të lojërave me maska në f. Bozovcë është paraparë edhe përgjigja rreth prejardhjes së këtij aktiviteti me prapavijë etnologjike dhe folklorike. Në këtë kontekst mund të thuhet se lojërat me maska burojnë nga një kohë shumë e lashtë, ndoshta që ndërlidhet edhe me fillet e zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Në këtë konstatim shpie prania e shumë elementeve që hasen në përmbajtjen e tyre, por ai në kryesori ndërli-dhet me maskën si një rekuizit i domosdoshëm i lojërave në fjalë. Nëpërmjet maskës, njeriu mund të shndërrohet në hyjni, në shpirtra të të parëve tanë, në kafshë–paraardhës, apo stërgjyshër, përkatësisht në të gjitha llojet e fuqive mbinatyrore, qofshin ato me prapavijë kreative, apo destruktive. Në planin religjioz–magjik, maska ushtron funksionin e ndërmjetësit me ndihmën e së cilës arrihet të vendoset komunikimi mes kësaj bote që është e banuar me njerëz të vdekshëm dhe të pafuqishëm dhe botën e hyjnive të gjithëfuqishme dhe të amshueshme, por edhe paraardhësit mitikë nga të cilët priten të dhurojnë pjellori dhe ta mbrojnë bashkësinë nga veprimet e dëmshme, apo të liga.

Në kuadër të përcaktimit të prejardhjes së lojërave me maska duhet të theksohet fakti se ato përveç me kultin, apo solemnitetet dedikuar Dhemetrës dhe Persefonës që i përshkruam më lartë, përkojnë edhe me disa solemnitete ose lojëra të kultit që janë ushtruar për nder të hyjnisë Dionis. Ndryshe, solemnitetet dionisiane janë kremtuar në muajin gamelion (janar–shkurt) – Lenetë, antesterion (shkurt–mars) – Antesteritë dhe në muajin elafeboleon (mars–prill) – Dionisitë e Mëdha. Solemniteti kryesor i Dionisive fshatare përbëhej nga kortezhe

të lojtarëve të maskuar që bartnin një falus me dimensione kolosale. Marshimi i tyre nëpër fshat shoqërohej me këngëtimin e këngëve dhe fljimin e kuleçve. Duhet shtuar se kulti i Dionisit është stacioni i fundit në historinë e këtyre hapësirave gjeografike deri ku mund të arrijnë njohuritë tona për ritualin i cili ka tentuar ta rimëkëmbë botën. Së këndejmi, rezulton se nuk kemi dokumente të shkruara për lojërat me maska para solemniteteve destinuar Dionisit. Ndoshta, lojërat me maska kanë ekzistuar edhe para Dionisit, pasi njeriu me vetëdije pagane ka tentuar të vendos një lloj lidhjeje me fuqitë mbnatyrore që nga kohërat më të hershme. Nënkuptohej se këto lojëra janë zhvilluar një kohë të gjatë, andaj supozohet se në përmbajtjen e tyre janë përfshirë disa shtresa – tipike për kohën e tyre. Kështu, si shtresë më e lashtë mund të konsiderohet ajo që është e ndërlidhur me kultet antike për nder të pjellorisë së *nënës* – *tokë* dhe *natyrës*, kurse shtresa e dytë ndërlidhet me mesjetën e hershme që vazhdon deri në shekullin e XVI dhe ka të bëjë me *kultin e paraardhësve dhe të vdekurve*. Më vonë, në këto lojëra përfshihen edhe elemente të ndërlidhura me *komiken*, *grotesken* etj. Lojërat me maska në f. Bozovcë i posedojnë të gjitha këto elemente, por nga distanca e sotme kohore vështirë deshifrohet përmbajtja e tyre, pa mos u mbështetur në një literaturë shkencore që ekziston për këto lloje të aktiviteteve me prapavijë pagane.

Vlera dhe rëndësia e artefaktit kulturor. Lojërat me maska që ekzekutohen në f. Bozovcë të Tetovës kanë vlerë dhe njëherit peshë të madhe për shkak të faktit se në përmbajtjen e tyre fshehin elemente të shumta pagane nëpërmjet të cilave mund të shpaloset funksionimi i logjikës së vetëdijes arkaike, sidomos në raport me shpjegimin e dukurive dhe fenomeneve që kanë të bëjnë me realitetin objektiv. Npërmjet këtyre lojë-

rave mund të venerohet evolucioni i vetëdijes njerëzore duke filluar nga koha parake e deri më sot. Në epiqendër të këtyre lojërave është komunikimi mistik që realizohet ndërmjet njeriut të rëndomtë dhe qenieve me prapavijë mbinatyrore. Në funksion të sqarimit të prapavijës së kortezheve me maska, Elijade nënvizon se “maskat që mishërojnë paraardhësit, shpirtrat e të vdekurve që solemnisht vizitojnë të gjallët, përdëftojnë se kufijtë e mëparshëm janë shfuqizuar, andaj është shkaktuar një përzierje e të gjitha llojeve të jetës. Në këtë moment kundërtthënës, apo të përmbysur ndërmjet dy “kohëve”(= dy gjendjeve të Kozmosit) bëhet i mundshëm komunikimi mes të gjallëve dhe të vdekurve” (Elijade, 2011: 465). Pikërisht nga këto arsye, me interpretimin e drejtë të këtyre lojërave mund të zbulohen rrugët nëpër të cilat ka kaluar mendimi religjioz duke filluar nga politeizmi, apo sistemi shumëhyjnor drejt besimit në një perëndi, apo sistemit monoteist. Me të gjitha këto elemente që i kanë në brendinë e tyre, lojërat në fjalë posedojnë vlera shkencore, historike, kulturore etj.

Rëndësia e tyre parësore në cilësinë e artefaktit kulturor qëndron në të dhënë se në përmbajtjen e tyre mund të venerohen mënyra të ndryshme të shpjegimit të ndryshimit të motit, përkatësisht të kohës kalendarike. Sipas logjikës pagane, ndryshimi i motit (ftohtë: ngrohtë, apo dimër: verë) është rrjedhojë e ndikimit të hyjnive të mbinatyrshme të cilat sipas vetëdijes mitike, kanë në duart e tyre fatin e njeriut, mes tjerash edhe nëpërmjet krijimit të kushteve të volitshme klimatike që do të ishin vendimtare në pjellorinë, ose jopjellorinë e prodhimeve bujqësore. Ndërkaq, me depërtimin më të thellë në esencën e përmbajtjes së lojërave në fjalë mund të kuptohet në mënyrë më efikase edhe çdo përmbajtje tjetër me prapavijë mitike që do të ndërlidhej me rituale tjera të kësaj na-

tyre, jo vetëm te ne, por edhe më gjerë, veçmas në raport me disa pjesë tjera të mitologjisë greke, ose romake të cilat kanë arritur te ne në formë të dokumenteve të shkruara që nga kohërat më të lashta dhe sot paraqesin bazë të çdo interpretimi, veçmas të religjionit pagan. Duke i pasur parasysh faktet e sipërpërmendura, këto lojëra duhet të kultivohen edhe më tej dhe të dëshmojnë në mënyrë më autentike për vlerat shpirtërore të një kohë shumë të lashtë të historisë së njerëzimit, përkatësisht për atë kohë në të cilën ka mbretëruar vetëdija mitike e shpjegimit të dukurive natyrore.

Disa kriteret dhe funksione që ndërlidhen me veçoritë kulturore të lojërave me maska: Lojërat me maska në f. Bozovcë të Tetovës në përmbajtjen e tyre ngërthejnë shumë elemente që janë tejet arkaike dhe njëherit tipike për një manifestim të këtij lloji. Ato i posedojnë disa nga karakteristikat e mëposhtme, por njëherit edhe disa funksione me prapavijë të ndryshme:

Autenciteti. Lojërat me maska në fshatin e apostrofuar dallohen me ekzekutimin e tyre autentik, pasi praktikohen në mjedis rural, njësoj siç janë praktikuar edhe në të kaluarën, nënkuptohet me modifikime të caktuara. Jo vetëm nga aspekti i hapësirës, por edhe nga aspekti i kohës janë autentike, pasi praktikohen rreth 14 marsit, kur sipas besimit tradicional, mendohet se fillon pjesa kreative e vitit, siç është periudha verore. Edhe nga aspekti i objekteve (maska teriomorfe, këmbana, etj.) që shfrytëzohen në trajtë të rekuizitave rituale, këto lojëra janë autentike, madje edhe shkopinjtë që përdoren, por edhe u-shqimi që përgatitet me këtë rast, është krejtësisht burimor, apo tipik për zonën në fjalë. Të përkujtojmë se kjo zonë veçohet me kushte të volitshme për zhvillimin e blegtorisë.

Rariteti. Këto lojëra me maska, apo karnavali i Bozovcës karakterizohen me një raritet të veçantë, pasi nuk aplikohet në vende tjera, veçmas te pjesëtarët e popullsisë shqiptare në Maqedoni. Në të kaluarën, me siguri se lojërat e tilla kanë qenë të pranishme në një masë më të gjerë, por ato kohëve të fundit jo vetëm që nuk praktikohen më, por është harruar krejtësisht edhe funksioni dhe destinimi i tyre. Lojërat me maska të Bozovcës janë të vetmet që kanë mbijetuar te shqiptarët e Maqedonisë, andaj si të tilla meritojnë një vëmendje të veçantë.

Funksioni edukativo–arsimor: Në përmbajtjen e karnavalit në fjalë, apo lojërave me maska vërehen shumë elemente që ngërthejnë në vetvete karakterin edukativo–arsimor. Karakteri i tillë vjen në shprehje duke pasur parasysh të dhënë se nëpërmjet këtij rituali, përkatësisht nëpërmjet njohjes së tij, mund të zhvillohet dashuria dhe respekti ndaj një pjese të traditës sonë popullore, apo ndaj etnokulturës të cilën e kanë kultivuar stërgjyshërit tanë. Njëkohësisht nëpërmjet njohjes përmbajtësore të këtij rituali zhvillohet edhe vetëdija, sidomos te të rinjtë për ruajtjen dhe kultivimin e këtyre trajtave kulturore si dëshmi e një kohe të kaluar nëpër të cilën kanë kaluar paraardhësit tanë. Po ashtu funksioni edukativo–arsimor ka të bëjë edhe me faktin se me interpretimin e drejtë të kësaj pjese të traditës popullore mund të kuptohet më mirë edhe gjendja e sotme në raport me religjionin, qoftë shumëhyjnor, apo njëhyjnor, përkatësisht evolucionin e vetëdijes religjioze nëpër periudha të ndryshme historike, sidomos nëpër ato parake.

Funksioni shkencor. Ky ritual me maska posedon shumë elemente që ndërliken edhe me kultin e magjisë së pjellorisë, fillet e së cilës datojnë që nga agsholi i historisë njerëzore. Në këtë kohë të hershme, por edhe shumë më vonë pretendohet se ndryshimet që ndodhnin në natyrë ishin produkt i ndikimit

të fuqive hyjnore. Në këtë kontekst, edhe maskimi teriomorf (me figura të deleve, dhive, demave, etj.) i pjesëmarrësve të kortezhit të maskuar është i ndërlidhur me besimin se ato (maskat) janë përfaqësues të fuqive demoniake të vegetacionit, ose të vetë hyjnisë së pjellorisë – Dionisit. Studiues të shumtë konsiderojnë se të vdekurit sjellin ushqim, pjellori dhe jetë, kurse publiku i pranishëm në këto manifestime, sidomos në të kaluarën, i ka përjetuar si stërgjyshërit e vet të vdekur, shpirti i të cilëve ka zënë vend nën maskat e protagonistëve të kortezhit. Së këndejmi, nëpërmjet zbulimit të këtyre elementeve, si dhe elementeve tjera në përmbajtjen e tyre mund të thellohen njohuritë jo vetëm nga lëmia e etnologjisë, por edhe nga mitologjia krahasimtare, folkloristika, antropologjia kulturore, sociologjia e kulturës, historia e religjioneve, historia e artit e kështu me radhë.

Funksioni kulturor. Lojërat me maska në f. Bozovcë të komunës së Tetovës paraqesin artefakt kulturor të llojit të vet për shkak të posedimit të shumë elementeve me vlera kulturore në strukturën e tyre përmbajtësore. Në këtë drejtim, sjellja specifike e pjesëmarrësve në kortezh, e ndërlidhur me ekzekutimin e një varg veprimesh rituale me prapavijë kryesisht magjike, pastaj maskimi i tyre specifik, ushqimi që për gatitet me këtë rast, si dhe një varg aktivitete tjera, por edhe dhe prania e publikut në këtë manifestim paraqesin elemente të mjaftueshme për ta cilësuar këtë manifestim si një ndodhi të veçantë kulturore. Pra, vetë lojërat me maska dhe bartësit e tyre, si dhe prania e audiencës paraqesin një dialogim me përmasa të një ndodhie të mirëfilltë kulturore.

Funksioni komunikativ. Lojërat me maska në fshatin Bozovcë posedojnë në brendinë e tyre edhe funksionin komunikativ i cili mund të hetohet në praninë e një numri të madh të pro-

tagonistëve të drejtpërdrejtë, por edhe praninë e publikut në manifestimin në fjalë. Po ashtu, ekzekutimi i lojërave në fjalë ndikon në mobilizimin e protagonistëve që të vendosin kontakt midis tyre në realizimin sa më efikas të këtij rituali nëpërmjet të cilit kontribuohet drejt koherencës së bashkësisë fshatare duke pasur parasysh faktin se pothuajse i tërë fshati merr pjesë në këtë manifestim. Po ashtu vendoset edhe një lloj komunikimi me publikun, madje ndonjë pjesëtar i tij merr pjesë të drejtpërdrejtë në këtë ritual nëpërmjet tentativës për të grabitur ndonjë protagoniste të gjinisë femërore që është pjesë përbërëse e kortezhit të ritualizuar. Funkzioni komunikativ hetohet edhe me aktin e hyrjes së këtij kortezhi në çdo shtëpi të fshatit me ç'rast realizohet një lloj dialogimi midis kryefamiljarit dhe udhëheqësit të kortezhit. Po ashtu, vetë akti i ekzekutimit të këtij rituali vendos një lloj komunikimi me paraardhësit e ndjerë në trajtë të vazhdimësisë së kultivimit të traditës së tyre, por edhe në trajtë të simbolikës që rezulton nga interpretimi teorik i përmbytjes së manifestimit në fjalë.

Funksioni artistik. Në përmbytjen e këtij manifestimi të lojërave me maska, apo karnavalit janë të pranishme edhe elemente që mund të venerohen edhe nga prizmi artistik. Kreativiteti artistik reflektohet nëpërmjet cilësisë së krijimit të maskave, cilësisë së aktrimit të lojërave, apo sjelljes rituale me maska, këndimit të këngëve e kështu me radhë. Nënkuptohej se cilësia e aktrimit në këto lojëra është parësore dhe ndikon që ky manifestim të konsiderohet edhe si një dramë, apo teatër i llojit të vet që zhvillohet nëpër rrugicat dhe oborret e shtëpive të fshatit.

Mënyra e mbrojtjes. Mbrojtja e këtij artefakti kulturor, përkatësisht lojërave me maska, apo karnavalit të Bozovcës, do të duhej të bëhej në trajtën e tij burimore, apo autentike, ashtu

siç është praktikuar në të kaluarën. Gjithsesi se më rëndësi të veçantë do të ishte edhe popullarizimi i këtij manifestimi i cili do të nënkuptonte inçizimin e tij nëpërmjet video–kamerave dhe pastaj transmetimin e këtij materiali në televizionet e ndryshme me karakter shtetëror dhe lokal. Në funksion të popullarizimit të tij do të ishte edhe përgatitja e emisioneve dokumentare në të cilat do të dilnin në shesh vlerat e këtij manifestimi, apo rituali. Njëkohësisht, do të ishte me rëndësi edhe trajtimi i tij shkencor dhe nënkuptohet publikimi i materialeve të kësaj natyre. Me rëndësi do të ishte gjithashtu edhe arkivimi i tij në institucionet adekuate që zhvillojnë veprimtari të natyrës hulumtuese–shkencore.

Në fund do të kishim shtuar se mbrojtja e artefakteve kulturore është e një rëndësie të veçantë, pasi ajo reflekton vlerën dhe njëherit qytetërimin e një populli, kurse gjeneratave të ardhshme u siguron një bazament të çmuar në drejtim të njohjes dhe shijimit të një pjese të identitetit kulturor të etërve, apo stërgjiyshërve të tyre.

Bibliografia dhe shkurtesat:

Elijade, Mirča (2011): *Rasprava o istoriji religiji*. “Akademska knjiga”. Novi Sad.

FM (1988): *Fjalor i mitologjisë*. Hartuar nga Todi Dhama. “Rilindja”. Prishtinë.

Lozica, Ivan (1997): *Hrvatski karnevali*. Goldeng marketing. Zagreb.

Murtezani, Izaim (2014): *Karnavali i Bozovcës (Sprovë për të depërtuar në hermeneutikën e tij)*. *Gjurmime albanologjike. Folklor dhe etnologji*. Nr. 43/2013. Instituti Albanologjik. Prishtinë. 2014.

Turner, Victor (1969): *The Ritual Process*. London.

BEXHET ASANI,

Universiteti FON – Strugë

NJË MBISHKRIM I LASHTË NË UNAZË

Një ekspeditë arkeologësh kanë bërë gërmime në nekropolin Seteli të Dollogozhdës, në afërsi të qytetit të Strugës. Gjatë këtyre gërmimeve, arkeologët kanë zbuluar eksponate me vlera të çmuara arkeologjike, historike, gjuhësore etj. Në këtë lokalitet janë zbuluar: enë të ndryshme, vathë, unaza, byzyllë, qafore. Për rëndësinë arkeologjike të këtij lokaliteti është shkruar fare pak. Të dhëna të thata, mund të gjenden në hartën arkeologjike të Maqedonisë. Vetëm kaq dhe asgjë më shumë.

Në lokalitetin e Setelisë siç e quajnë banorët e Dollogozhdës apo Shën Ilia (Sveti Ilia), siç është shënuar në hartën arkeologjike, thuhet se janë zbuluar disa epigrafe të shkruara me alfabetin grek! Një mbishkrim i tillë, i cili gjendet në një unazë – vulë prej argjendi më ra në dorë, kohët e fundit. Unaza e cila mban këtë mbishkrim është botuar si fotografi në vitin 1998 në kalendarin e Komunës së Strugës. Unaza – vulë ruhet në muzeun e Strugës.

Enkelejtë, fisi i cili ka jetuar në këto troje, në fushëgropën e Strugës, duket se ka pasur një kulturë mjaft të zhvilluar. Enkelejtë, në bazë të epigrafeve të cilat janë gjetur në nekropolin e Setelisë, kanë shkruar gjuhën e tyre që e kanë folur, kanë pasur ligje nëpërmjet të cilave kanë vënë rregulla, drejtësi e qetësi në këto hapësira. Ata kanë pasur të zhvilluar po thuaj të gjitha artizanatet, kështu ata kanë bërë përpunimin e metaleve, qeramikës, veçanërisht vlen të theksohet përpunimi i qelqit me lloj lloj mozaiqesh sidomos nga flora etj.

Mbishkrimi i cili gjendet në këtë unazë – vulë, përveç vlerave arkeologjike, ai mbishkrim ka edhe vlera të çmuara sa gjuhësore e historike, po aq edhe vlera juridike e administrative. Unaza e argjendtë apo më mirë të thuhet unaza – vulë e cila i përketë shekullit të III – II p.e.s., me formën e saj të rrumbullakët, eliptike përveç mbishkrimit (të cilin do ta komentojmë më poshtë) ka dhe një figurë njeriu me qëndrim në këmbë e që më së shumti ngjan që të jetë një mashkull në profil. Ky njeri, krahun e majtë dhe dorën me pëllëmbë të hapur e ka të ngritur lartë, si kur thuhet ndalë! Në kokë ka paruke, pak a shumë e ngjashme me paruket që i kanë mbajtur apo edhe i mbajnë ende gjyqtarët anglezë gjatë seancave gjyqësore. Ndërsa nga beli deri poshtë gjunjëve është i mbështjellur me një peshtirkë të rrudhur dhe të lidhur përpara. Këmbët dhe pulpat muskulatore i ka lakuriq. Qëndron në këmbë në një vijë horizontale, me këmbën e djathtë të hedhur përpara. Peshë e trupit rëndon mbi këmbën e majtë.

Vera Bitrakova Grozdanova në studimin e saj “ Unazat “ botuar në veprën “ Përmendore nga periudha helenistike në Republikën Socialiste të Maqedonisë “ Shkup, 1987. Fq. 79. (Вера Битракова Грозданова – „ Споменици од хеленистичкиот период во Социалистичка Република Македонија „ Скопје 1987 - страна 79), midis tjerash shkruan: Unazat me kokë të rrafshët me prerje rrethore të hallkës paraqesin grup tjetër në rajonin tonë. Unaza e argjendtë nga Dollogozhdi ka kokë në formë eliptike dhe hallkë të rrumbullakët (TIV– 4). Në pjesën e plakës me relief të cekët është paraqitur një figurë njeriu në profil, i mbështjellur me himation (nga greqishtja: gunë, pallto etj., shënimi im) deri nën gjunjë, dora e majtë e ngritur lart, ndërsa në dorën e djathtë e mban veshjen dhe një degë me

pesë gjethe. Veshja përpara është e ngritur dhe më e shkurtër si disa paraqitje në artin etrusk. Në anën e djathtë ka mbi-shkrim grek. Në mbishkrim përmenden dy emra: TATA që është vërtetuar si emër femre ilire në rrasat e mbishkrimeve të përmendoreve të Diharionit; Subrinos nuk është i njohur në onomastikën greke dhe atë ilire; si duket është me prejardhje etruske (në kreun – Përmendoret epigrafeke –).

Siç e shohim edhe në studimin e Vera Bitrakova Grozdano-va, ajo nuk ka njohuri për alfabetet pellazge, ilire dhe etruske, sepse alfabetin i cili është përdorur në unazën e Dollogozhdit ajo e quan alfabet grek...! Ndërsa për emrin TATA ajo vë në dukje se është emërfemre ilire...! Gjë që nuk ka të bëjë me të vërtetën. Emri Tata është mjaft i përhapur te shqiptarët, bile edhe te një pjesë e popullit maqedonas ku babait i thonë Tata. Le të shohim tani se çka fshihet në të vërtetë në epigrafin i cili gjendet pas kësaj figure. Mbishkrimi në fjalë mund të deshi-frohet vetëm nëpërmjet të dialekteve dhe të nën dialekteve të gjuhës shqipe. Ky mbishkrim i shkruar me këtë alfabet është mjaft i afërt me mbishkrimet të cilat janë gjendur në Apolloni dhe në Butrint.



Unazë – vulë e argjendte shekulli III – II p.e.s.

ILIRISHT	SHQIP	FRENGJISHT	ITALISHT
ΣΥΒ = HYNİ	HYNI	DIVINITÉ	DIVINITA
ΠΗΨ = RIJU	RUPMË	GARDEMOI	FAMMI LA GUARDIA
Ο = O	O	O!	O!
Σ = M	MOS	DE NE PAS	DI NON
ΦΙΨΩ = FUKHSH	FIKEM	PERDRE	PERDERE
TATA = TATA	TATA	PERE	PADRE
I = I	I	IL	LUI
ΔΙ = DI	DI	SAVOIR	SAPERE
ΔΟΙ = DOI	DOI	DIGNITE	DIGNITA

INTERPRETIMI:

Hyjni ruajmë o mos fikem (mos humb).Babai i di (të gjitha të dhënat në shkresë) denjësisht.

Nga kjo,mbase e ka burimin edhe frazeologjia: “Mos ia trego babës arat”. Fjala e parë është një lutje drejtuar Hyut (Perëndisë),që ai ta ruaj, që të mos vulos çdo shkresë sepse ka përgjegjësi për atë dokument të cilin duhet ta vulosë.

Nga fjalja e dytë kuptojmë se njeriu i cili e mban vulën në gisht të dorës, në këtë rast Tata, e që në trajtën nëndialektore të popullsisë së trevës së Strugës thuhet Tota por edhe Tata, pra, babai di se çka të shkruar në atë letër të cilën duhet ta vulosë ai, prandaj, ato të dhëna, në shkresë i di dhe i mbron denjësisht. Këtë unazë – vulë mund ta ketë mbajtur: kryetari i fisit, kryetari i vendbanimit apo kryetari i familjes në këtë rast edhe babai.

Le të shfletojmë për një çast fjalorin e Gjuhës së sotme shqipe. Në faqen 2188 lexojmë: Vulë– a. Mjet i vogël zyre ku janë gdhendur emri i ndërmarrjes a i institucionit e shenja të tjera, e cila zakonisht ngjyhet me bojë dhe vihet mbi shkresat për të dëshmuar vërtetësinë e tyre për t'u dhënë fuqi zbatimi; pajisje e tillë që përdoret për të lënë shenjë në dyllë të kuqe, në plumb etj.; shenja që lë ky mjet në letër, në dyllë etj... vulë vetjake...etj.

HIDAJETE AZIZI,

ITSHKSH – Shkup

IDENTITETI KOMBËTAR DHE FETAR NË PROCESIN E EMËRVËNIES

Një pyetje që sot duhet parashtruar, ndër pyetjet e shumta që parashtrohen në lidhje me trashëgiminë kulturore e shpirtërore të shqiptarëve të Maqedonisë është edhe kjo: cili është niveli i ndërgjegjësimit onomastik te shqiptarët e kësaj ane? Sa jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e emrave që bartim të gjithë ne dhe çfarë reflektojnë ata?

Do të thosha që emrat që bartim ne janë uni ynë, otëkuptimi ynë. Por në fakt, ata janë botëkuptimi i brezit që na pagëzoi me këta emra, pra botëkuptimi i prindërve tanë. Ndërkaq, botëkuptimi ynë mbetet të reflektohet tek emrat e brezit të ardhshëm, tek emrat e fëmijëve tanë. Në këtë mënyrë, brez pas brezi krijohet një zinxhir, secili rreth i të cilit reflekton një mendësi që ka identitetin e vet, identitet ky i cili gjithsesi, herë më shumë e herë më pak, dallon nga identiteti i rrethit tjetër të zinxhirit dhe i cili asnjëherë nuk do të mbyllet po do të vazhdojë të rritet për aq sa do të shtohen brezat e rinj. Më në fund, gërshetimi i të gjithë këtyre rrathëve, nga më i vjetri e deri te më i riu, rezulton me një të përbashkët, me një mendësi të cilën do ta quanim mendësia ndër shekuj e një populli të caktuar, e në rastin konkret, mendësia e shqiptarëve të Maqedonisë.

Se çfarë reflekton te shqiptarët e Maqedonisë ky rreth si tërësi dhe pjesët përbërëse të tij do të mundohemi ta ilustrojmë me

të dhënat në vazhdim. Por, para se t'i shpalosim këto të dhëna, të themi dy-tri fjalë për emrat vetjakë në përgjithësi.

Emrat që bartim ne nuk janë thjesht vetëm një shenjë gjuhësore me të cilët dallohem nga të tjerët. Ata janë një botë e pasur dhe e larmishme. Duke ngërthyer në vetvete një kompleks të dhënash, ata herë pasqyrojnë identitetin kombëtar e herë atë fetar, shpeshherë edhe kulturor, social, besëtytnor, krahinor e jo rrallë edhe shijet tona individuale. Duke qenë lëndë e vjetër sa edhe vetë njerëzimi e vetë gjuha, me të drejtë nga studiues të shumtë¹² janë quajtur si arkiv gojor e histori e pashkruar ndërkaq, rëndësia e tyre del në sipërfaqe sidomos për gjuhë, çfarë është shqipja, e vjetër, por me një dokumentim të vonë shkrimi. Në këtë mënyrë, emrat tanë rezultojnë si një pasqyrë më e mirë e shpirtit dhe e karakterit të një populli, jo vetëm për periudha dhe ngjarje të ndryshme historike të dokumentuara, por edhe për ato të padokumentuara. Kjo, sepse secila kohë ka fondin e vet emëror karakteristik me të cilin konstatohen njëkohësisht edhe ecuritë shoqërore në periudha të caktuara duke qenë se sistemi i emërtimit është kategori dinamike, i nënshtruar nga ndryshimet shoqërore e kulturore të vendeve të ndryshme, nga ndryshimet e pandërprera të krijimeve të reja dhe të zhdukjeve.

Nëse analizojmë ditarin e emrave vetjakë të familjeve shqiptare, aty mund të gjejmë një *Muhamed*, një *Gjon*, një *Agron*, *Kastriot*, *Ukë*, *Tomor*, *Urim* e kështu me radhë.

Në këtë laramani emrash, shikuar nga këndvështrimi kronologjik, si më të vjetër, nga njëra anë na dalin emrat me karakter kombëtar, duke filluar nga emrat ilirë, si: *Ilir*, *Bardh*, *Agron*, *Teuta* etj., për të vazhduar me një shtresë të emrave shqiptarë të moçëm të cilët paraqesin dëshmi për zhvillimin

¹² E. Çabej, Gj. Shkurtaj, Q. Murati, R. Doçi, B. Baliu e të tjerë.

historik të gjuhës shqipe e herë–herë edhe të trashëgimisë së saj ilire, si: *Ukë, Lul, Kalosh, Zoge, Hanë* etj. dhe për të përfunduar me një shtresë më të re të emrave që nxjerrin në pah identitetin tonë kombëtar dhe vazhdojnë traditën e vjetër pozitive që në fakt janë emra të marrë nga leksiku i gjuhës shqipe, si: *Besnik, Agim, Rron, Lindita, Borë* etj. dhe të cilët në një farë mënyre janë tregues të vijmësisë e të ngritjes së vetëdijes dhe ndërgjegjes kombëtare. Nga ana tjetër, është e njohur se në historinë më të hershme të shqiptarëve kudo, përfshirë këtu edhe shqiptarët e Maqedonisë, janë krijuar tri mbishtresa më të mëdha të emrave të huaj në gjuhën shqipe, kryesisht me karakter fetar. Mbishtresa e parë¹³ e ndikuar nga pushtimi i truallit ilir nga Roma, lindi emrat me gurrë latino–romane si fryt i përhapjes së besimit katolik. Mbishtresa e dytë në antroponiminë shqiptare lind nën ndikimin e ideologjisë fetare krishtere të ritit ortodoks e që janë përdorur dikur nga shqiptarët ortodoksë të Rekës së Epërme, të cilët të ndikuar nga kisha ortodokse sllave dhe nga shumë arsye të tjera, sot pothuajse janë asimiluar tërësisht në maqedonas. Mbishtresa e tretë e cila la gjurmë më të thella në fondin tonë emëror është ajo orientale (perso–arabo–turke) të mbështetur në ideologjinë fetare të besimit mysliman¹⁴.

Se çfarë na thotë gjendja aktuale e sistemit emëror të shqiptarëve të Maqedonisë, cilat janë aspiratat e prindërve dhe cili identitet, ai kombëtar apo fetar do të mbizotërojë në këtë sistem në periudha të caktuara kohore të cilat do të jenë objekt i studimit tonë, do të shohim në vazhdim pas një analize

¹³ Jusuf Shpuza, Vëzhgim për emrat familjarë të shqiptarëve. Shkodër: Idromeno, 1998. f. 147

¹⁴ Ferit Duka, Vështrim rreth islamizimit të shqiptarëve të Maqedonisë (shek. XV–XVII). Shkup, 1994. f. 145

të detajuar të lëndës antroponimike të vjelë në terren për har-kun kohor nga viti 1900 e deri sot.

Në analizën tonë janë përfshirë emrat me burim nga shqipja dhe emrat me burim oriental.¹⁵ Duhet të theksojmë se jo çdoherë motivi kryesor për tu përcaktuar për një emër shqip-tar dhe për një emër oriental është reflektimi i identitetit kombëtar, nga njëra anë, dhe atij fetar, nga ana tjetër, sepse motivet për përdorimin e tyre mund të jenë nga më të ndryshmet, si bie fjala, motivi që mbështetet në trashëgiminë e emrave të të parëve të rrethit më të ngushtë familjar, shijet individuale, moda, besëtytnitë, bukurtingëllimi e shumë të tjera, megjithatë, ashtu siç thotë edhe Ç. Bidollari '*...në qoftë se një emër ndihet si shqiptar, grek, italian, francez, rus, anglez etj., ai ka diçka në përbërjen e vet a në formësim, që e bën të tregojë përkatësinë nacionale*'.¹⁶ Pra, shikuar nga ky këndvështrim, emrat me burim nga shqipja, para së gjithash, do të reflektonin një identitet kombëtar, ndërkaq ata të huaj, në rastin konkret, me burim oriental, një identitet fetar.

Nga analiza që i është bërë materialit antroponimik për sa i përket raportit ndërmjet emrave me burim nga shqipja dhe emrave me burim oriental, kemi konstatuar këtë gjendje: nga 10592 emra vetjakë të vjelë në territorin e Maqedonisë¹⁷,

¹⁵ Në këtë analizë në grupin e emrave me karakter fetar janë përfshirë vetëm emrat e huaj me burim oriental me të cilët në të shumtën e rasteve reflektohet një identitet fetar, ai islam, duke përjashtuar kështu nga analiza emrat e huaj me karakter ndërkombëtar, pa ngjyresa fetare dhe emrat e huaj me karakter fetar krishterë, të rritit katolik e ortodoks, të cilët në trojet e Maqedonisë takohen në numër simbolik sepse shqiptarët e Maqedonisë kryesisht i përkasin besimit islam.

¹⁶ Çlirim Bidollari, Tradita dhe risi në fondin e emrave të shqiptarëve (antroponimikoni shqiptar). SF 1-2/2001. f. 53

¹⁷ Në këtë analizë janë përfshirë rajoni i Dibrës, i Strugës, i Kërçovës, i Tetovës dhe i Shkupit. Për të dalë me rezultate më të plota, krahas zonave urbane, janë përfshirë në studim edhe zonat rurale me ç'rast janë konstatuar edhe mjaft dallime me interes.

3382 emra na dalin me etimologji shqipe, të cilët në të shumtën e rasteve reflektojnë një identitet kombëtar, kundrejt 7210 emrave të tjerë me etimologji të huaj, nga të cilët 6990 emra na dalin të traditës myslimane me burim oriental e të cilët gjithashtu reflektojnë në vetvete një identitet fetar. Shprehur me përqindje, gjendja paraqitet e këtillë: 32 % emra me burim të shqipes; 68 % emra me burim të huaj, nga të cilët, 66 % emra të traditës islame, në të shumtën e rasteve me karakter fetar.

Për të nxjerrë në pah ecurinë e zhvillimit të këtij sistemi, fondin e vjelë në terren e kemi klasifikuar në pesë periudha kohore. Periudha e parë përfshin emra të regjistruar në regjistra të ndryshëm që nga viti 1900–1970.¹⁸ Nga regjistrat e kësaj periudhe janë vjelë 2789 emra gjithsej, nga të cilët 10.5 % kanë rezultuar me etimologji shqipe dhe 89.5 %, emra me etimologji të huaj nga të cilët 89 %, emra të traditës myslimane. Periudha e dytë përfshin emra të vjelë në terren nga viti 1970–1980. Nga 1825 emra gjithsej, 25.5 % dalin me etimologji shqipe, ndërkaj me etimologji të huaj 74.5 %, nga të cilët, 73 % rezultojnë emra të traditës myslimane. Periudha e tretë përfshin emra të regjistruar nga viti 1980–1990. Nga 1695 emra gjithsej, 36.5% dalin me etimologji shqipe dhe 63.5 %, emra me etimologji të huaj nga të cilët, 60% emra të traditës myslimane. Në periudhën e katërt, 1990–2000, janë vjelë 1403 emra gjithsej, nga të cilët: 46.5 % me etimologji

¹⁸ Shtatë dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XX i kemi përmbledhur në një periudhë të vetme për arsye se kemi takuar shumë raste kur persona të caktuar jenë regjistruar në regjistrat e gjendjes civile, jo në vitet kur kanë lindur, por shumë vite më vonë. Një motiv shtesë për t'i përmbledhur këto periudha në një të vetme ka qenë edhe fakti se nuk kemi hasur në ndonjë dallim për të cilin do t'ia vlen të analizoheshin më vete secili dhjetëvjeçar veç e veç. Më tutje, periudhat e ardhshme përfshijnë çdo dhjetëvjeçar të ardhshëm.

shqipe dhe 53.5 % me etimologji të huaj nga të cilët 51 % emra me burim oriental. Periudha e pestë dhe e fundit përfshin emra të regjistruar nga viti 2000 e këndeje. Në këtë periudhë, nga 1464 emra gjithsej, 41 % dalin me etimologji shqipe ndërkaq 59 % me etimologji të huaj nga të cilët 55.5 % të traditës myslimane.

Këto lëvizje nëpër periudha, duke pasur parasysh faktin e rritjes së përqindjes së emrave me burim të shqipes nga 10.5 %, aq sa arrin në periudhën e parë e deri më 46.5 %, aq sa arrin në periudhën e katërt për tërë territorin e Maqedonisë nga ku kemi vjelë material antroponimik, paraqesin njëkohësisht edhe pasqyrë e dëshmi të rritjes, nga periudha në periudhë, e nivelit të zhvillimit të kulturës kombëtare gjuhësore e me këtë edhe të ndërgjegjësimit onomastik në fushë të antroponimisë në të mirë të karakterit kombëtar. Megjithatë, siç shihet nga pasqyra e dhënë, kjo përqindje e emrave me burim të shqipes nuk arriti asnjëherë epërsi në krahasim me emrat me burim oriental. Për të qenë edhe më keq se kaq, në periudhën e pestë takohemi me një fenomen të ri ku përqindja e emrave shqiptarë nuk shënon më rritje si në periudhat e mëparshme por, përkundrazi, shënon ulje, duke rritur kështu për këtë periudhë, përqindjen e emrave orientale të cilët deri në periudhën paraprake kishin rënie graduale. Pra, përkundër prezencës së emrave të mbështetur në paradigmen kombëtare, paradigme kjo e cila realizohet përmes emrave të personaliteteve të njohura nga historia, kultura, letërsia, emrave nga leksiku toponimik dhe nga leksiku i përgjithshëm që tregojnë qëndresë, luftë çlirimtare, krenari historike, durim etj., e emrave nga bota shqiptare në përgjithësi, me anë të cilëve shprehen idetë shpesh të parealizuar të shqiptarëve të territorit të Maqedonisë, emrat e mbështetur në paradigmen fetare të motivuar

nga trashëgimia e emrave të personaliteteve të njohura nga historia fetare, emra profetësh, familjarë e të afërm të tyre, si dhe emra të motivuar nga leksiku i përgjithshëm i gjuhëve orientale të cilët janë konceptuar nga popullata si emra me karakter fetar, edhe atëherë kur nuk kanë pasur një karakter të tillë, bindshëm mbizotërojnë. Nga kjo pasqyrë rezulton se në procesin e emërvënies të shqiptarët e Maqedonisë, synimet për të reflektuar identitetin fetar janë më të mëdha sesa synimet për të reflektuar identitetin kombëtar. Prandaj edhe mund të themi se motivi fetar është motivi bazë në procesin e emërvënies që përshkon shoqërinë e shqiptarëve të Maqedonisë.

Të dhënat që dolën nga analiza e parashtruar japin një pasqyrë të përgjithshme për parapëlqimet a impulset motivuese në procesin e emërvënies për të gjitha rajonet e Maqedonisë të banuara me shqiptarë të cilat qenë objekt i studimit tonë. Mirëpo, po që se fondi i emrave vetjakë analizohet sipas shtrirjes rajonale, përkatësisht sipas rajoneve të veçanta, dalin në pah dallime të konsiderueshme të cilat, për më shumë arsye, mendojmë se duhet të përmenden. Nga analiza që është bërë në këtë drejtim, kemi konstatuar se në rajonet e Maqedonisë Perëndimore, duke filluar nga Dibra e Struga, rajone këto të cilat prijnë me numër më të madh të emrave me burim nga shqipja e të cilat gjeografikisht gjenden pranë kufirit me Shqipërinë, me ç'rast nuk përjashtohet mundësia e ndikimit nga atje,¹⁹ e duke zbritur nga rajonet e Kërçovës, Tetovës e deri në Shkup, numri i emrave me burim nga shqipja vjen gjithnjë duke u zvogëluar. Sa për ilustrim po japim të dhëna për përqindjen e emrave me burim nga shqipja vetëm për periudhën e parë (1900–1970): Dibër: 30%, Strugë: 20%, Kërçovë 3%, Tetovë 5% dhe Shkup 2.5% dhe për periudhën e fundit,

¹⁹ Mbase ky ndikim mund të jetë edhe vendimtar.

përkatësisht të pestën (nga viti 2000 e këndej): Dibër: 68%, Strugë 57%, Kërçovë 75%, Tetovë 64% dhe Shkup 27%. Që nga periudha e dytë e këndej, emrat me burim të shqipes çdohërë janë në përqindje më të madhe se sa emrat orientale, përveç në rajonin e Shkupit, ku nga periudha e parë e tek e fundit, mbizotërojnë emra të burimit oriental dhe në rajonin e Tetovës, ku emrat e burimit oriental prijnë vetëm deri në periudhën e tretë. Pra, siç edhe shihet nga të dhënat, shtrirja rajonale e emrave vetjakë është element kyç që ndikon në ndryshimin e pasqyrës së dhënë për gjendjen e përgjithshme të sistemit të emërvënies në tërë arealin ku banojnë shqiptarët e Maqedonisë, përkatësisht rajoni i Shkupit është ai i cili në masë të madhe ka ndikuar në zvogëlimin e numrit të emrave me burim nga shqipja për tërë këtë areal. Përndryshe, në tërë territorin e Maqedonisë në përgjithësi, nga periudha e parë e deri tek e fundit, ku më shumë e ku më pak, përqindja e emrave të burimit të shqipes vjen duke u rritur, përveç në Dibër e në rajonin e Strugës, ku kjo përqindje, megjithëse mbizotëron krahasuar me rajonet e tjera, vetëm në periudhën e pestë pëson ulje, kuptohet krahasuar me periudhat paraprake. Kjo tregon se gradualisht, identiteti kombëtar në procesin e emërvënies, po vjen e po mbizotëron mbi identitetin fetar.

Fakti që numri i emrave me burim nga shqipja është dukshëm më i vogël në Shkup me rrethinë, në krahasim me rajonet e tjera, mund të lidhet sipas të gjitha gjasave me mentalitetin e përgjithshëm të kësaj ane që është krijuar si rezultat i nivelit të ulët të arsimimit të popullatës shqiptare të kësaj ane. Kjo mund të ketë ndodhur si pasojë e mungesës së ndikimit nga Shqipëria, në krahasim me rajonet e tjera në të cilat ky ndikim është ndjerë në masë të madhe nëpërmjet të kanaleve të ndryshme dhe kontakteve sado të kufizuara. Në krahasim me

Shkupin me rrethinë, në rajonet e tjera pati një vale të madhe të rinjsh të cilët u arsimuan në Kosovë për shkak të mungesës së institucioneve me arsim të lartë në gjuhën shqipe në Maqedoni dhe ky ishte çelësi i ngritjes së vetëdijes onomastike për shqiptarët e kësaj ane, gjë që nuk ndodhi edhe në Shkup me rrethinë. Mbase, një fakt tjetër mund të ketë qenë edhe presioni më i madh i pushtetit në këto anë, në një kohë kur ishin krijuar pengesa të ndryshme administrative në procesin e emërvënies dhe në përgjithësi në fushën e onomastikës, ndërkaq në viset e tjera me numër më të madh të shqiptarëve, ndikimi nga ana e ofiqarëve që kanë regjistruar emrat e fëmijëve mund të ketë qenë më i vogël.

Dallime të konsiderueshme kemi konstatuar edhe për sa i përket përdorimit dhe shtrirjes së emrave sipas zonave rurale e urbane. Në këtë rast kemi krijuar një përshtypje të përgjithshme që flet për faktin se në zonat rurale, në krahasim me ato urbane, numri i emrave me burim të shqipes është më i vogël. Ky konstatim vlen sidomos për periudhën e parë për të gjitha rajonet në fjalë, ndërkaq ecuria e zhvillimit të emrave nëpër periudhat e mëvonshme flet për faktin e rritjes së numrit të emrave shqiptarë edhe në zonat rurale. Gjendja e krijuar e sistemit emëror në periudhën e katërt tregon se epërsia e emrave shqiptarë në zona urbane vjen duke u zvogëluar. Kjo epërsi për zona urbane vazhdon të ekzistojë në qytetin e Shkupit dhe të Kërçovës, ndërkaq në rrethin e Strugës, kalon në zonat rurale. Periudha e pestë na del me një pasqyrë krejtësisht të re, që tregon rritjen në masë të madhe të përqindjes së emrave me burim nga shqipja në zonat rurale, përveç në rajonin e Karadakut e të Karshiakës, ku përqindja e emrave me burim nga shqipja akoma vazhdon të jetë më e ulët,

ndërkaq në Veleshtë, kjo përqindje barazohet me atë të Strugës.

Sa i takon historisë, zhvillimi i sistemit antroponimik i shqiptarëve të Maqedonisë është i ndërlidhur ngushtë me antroponiminë e shqiptarëve kudo që janë sepse ky sistem ka shumë pika takimi me sistemin emëror të shqiptarëve si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë e gjetiu, megjithatë dallon dukshëm nga rajonet e tjera kur është fjala për periudhën më të re, sidomos nga periudha e komunizmit e këndej. Përderisa gjendja e tanishme e fondit emëror e shqiptarëve të Shqipërisë paraqet një brengë të madhe për shkak të tendencës së vënies së emrave me burim të huaj ‘modernë’, ai i shqiptarëve të Kosovës lë më shumë për të shpresuar në këtë drejtim. Shumica e emrave, sidomos në periudhën para dhe pas luftës së fundit në Kosovë, janë emra me burim vendës, megjithëse vërehet edhe tendenca e vënies së emrave të huaj amerikanë e evropianë, por jo në përmasa të tilla si në Shqipëri. Ndërkaq, për shqiptarët e Maqedonisë, siç shihet edhe nga ajo që u tha deri më tani, gjendja e përgjithshme e sistemit antroponimik sot e kësaj dite vazhdon të jetë e karakterizuar me një ngarkesë shumë të madhe të emrave orientale.

Arsyet për këtë mund të jenë të shumta. Rrethanat që u krijuan nga ndikimi i politikës e institucioneve shtetërore e fetare në Maqedoni e që rezultuan me një zhvillim tejet të ulët të arsimit nga pamundësia e shkollimit në gjuhën shqipe, me ç’rast, për një kohë të gjatë, kjo popullatë mbeti në një terr arsimor e kulturor, e si rezultat i kësaj edhe në një injorancë të konsiderueshme nuk kanë se si të mos kenë ndikuar dukshëm dhe në mënyrë të drejtpërdrejt edhe në procesin e emërvënies te shqiptarët e kësaj ane. Kjo injorancë vjen e shtohet edhe më shumë nga ndikimi në masë të madhe i fesë, nga njëra

anë, dhe nga predikimi jo i duhur i fesë nga predikues fetarë të paarsimuar, nga ana tjetër. Deri vonë, predikuesit fetarë myslimanë nuk i lejonin prindërit që fëmijët e tyre t'i emërojnë me emra me burim nga shqipja, por vetëm me emra fetarë – myslimanë, me pretendimin se myslimanët duhet të emërtohen vetëm me emra nga libri i shenjtë, Kurani. Kjo përqindje e emrave me ngjyrim fetar shfaqet jo vetëm si rezultat i ndikimit të drejtpërdrejt të fesë, por edhe i ndikimit nga tradita shekullore për të lënë emra turko-arabë, apo edhe nga shijet estetike të individëve të cilët i emërojnë fëmijët e tyre me emra të kësaj gurre vetëm se tingëllojnë bukur, duke mos ia ditur as kupimin e tyre. Në këtë vijë ndihmon shumë edhe trashëgimia e emrave të familjarëve, gjyshërve e prindërve, e që njëherit paraqet një ndër motivet më dominuese në lënien e emrave këtu te ne, sidomos të fëmijëve të parë në familje. Më shumë se kudo, këtu numri i emrave të ashtuquajtur ‘modernë fetarë’ apo orientalë, po merr hov të madh kohëve të fundit. Këta emra, si bie fjala: *Esra, Jusra, Edina, Bushra* etj., i hasim me të madhe viteve të fundit në Maqedoni. Pra, sipas nesh, një ndër arsyt kryesore mund të jetë ndikimi dhe roli i madh që ka luajtur religjioni, jo vetëm në të kaluarën, por edhe sot, në popullsinë e viseve të Maqedonisë. Megjithatë, me të drejtë arrijmë të konstatojmë se gjendja e tanishme e fondit emëror vetjakë të shqiptarëve të Maqedonisë, zbulon prezencën gjithnjë e më të madhe të emrave shqip, që do të thotë se gradualisht është rritur dhe po rritet vetëdija kombëtare në lidhje me lënien e emrave vetjakë e sidomos kur kihet parasysh fakti që ky territor ka qenë ndër më të prekurit nga ndikimi i emrave të nomenklaturës orientale.

Në kronologjinë e ngjarjeve, në të mirë të karakterit kombëtar të emrave vetjakë, nuk janë për tu nënvlerësuar edhe lëvi-

zjet, megjithëse jo shumë të mëdha, të cilat më shumë krijo-
hen falë ndikimit nga Kosova e Shqipëria, sesa nga ndërgje-
gjësimi i masave të gjëra të popullit. Ndikimi nga Shqipëria,
përkundër kufijve të mbyllur në kohën e komunizmit, reali-
zohej përveç tjerash, edhe nëpërmjet Televizionit Shqiptar (i
cili mund të ndiqej vetëm në disa zona, sidomos kufitare) dhe
arsimtarëve të ardhur nga Shqipëria menjëherë pas LDB-së,
ashtu si edhe në Kosovë, ndërsa ndikimi nga Kosova ka të
bëjë me studimin e shumë të rinjve atje, për shkak të munge-
sës së universiteteve në gjuhën shqipe te ne. Këta studentë,
dhe një numër i konsiderueshëm i arsimtarëve të ardhur nga
Kosova ndikuan edhe në ndërgjegjësimin onomastik. Një
numër i madh i emrave me origjinë topike nga Shqipëria,
vijjnë e shtresohen edhe si rezultat i kontakteve me kosovarët,
te të cilët kjo paradigmë antroponimike kishte marrë hov të
madh. Megjithatë, jo vetëm ky ndikim nga Kosova e Shqipë-
ria, por edhe gjendja politike shoqërore e krijuar në Maqedo-
ninë komuniste ishin faktorë që ngacmuan ndërgjegjësimin e
shqiptarëve dhe ngritjen graduale të vetëdijesimit kombëtar.
Pengesat që dalin nga administrata shtetërore si bie fjala, cen-
zurimi i emrave kombëtarë shqiptarë, pas LDB-së, me anë të
ligjit për emrin personal, me çka prindërve shqiptarë u ndalo-
hej t'i emërtojnë fëmijët e tyre me emra që kanë karakter dhe
domethënie nacionale shqiptare, si: *Kushtrim, Liridon, Ka-
striot, Arbëresha, Alban, Albana, Valon, Shkodran* etj.²⁰,

²⁰ Një të dhënë të tillë na e jep Q. Lita (2011 : 74), marrë nga Arkivi Shtetëror i RM-së (ДАРМ -ДРЖАВЕН АХИВ НА РМ) 1.427.520.33/285-304, Закон за именување и дополнување на Законот за личното име “Сл. Весник на СРМ“ бр. 41/85, ku thuhet: ‘*Në librin amzë të lindjes nuk mund të regjistrohet emri personal me të cilin nxitet urrejtja apo jotoleranca nacionale apo fetare apo me të cilin ofendohet morali publik*’. Në një dokument (ДАРМ. 1.427.515.16/300-331) tjetër thuhet: ‘*... janë shfrytëzuar edhe forma perfide për manifestimin e nacionalizmit dhe seperatizmit shqiptar. Kështu për shembull me emërtimin e*

shtrembërimi i patronimeve të shqiptarëve me anë të shtimit të prapashtesave sllave: *-ov*, *-ovski*, *-oski*, dhe në disa raste edhe: *-iq*, *-viq* a *-oviq*; *Abazov / Abazovski / Abazoski / Abazoviq* e që la gjurmë të thella deri në ditët e sotme, ndalimi i përdorimit të toponimeve në gjuhën shqipe nën direktivën e institucioneve shtetërore, me çka në administratë, emrat e qyteteve: *Shkup*, *Tetovë*, *Ohër*, *Kërçovë*, *Dibër*, *Manastir* etj., duhej të shkruheshin dhe të shqiptoheshin vetëm sipas veçorive gjuhësore të gjuhës maqedonase: *Skopje*, *Tetovo*, *Ohrid*, *Kiçevo*, *Debar*, *Bitola* etj., në mënyrën e vet, ndikuan edhe pozitivisht në aspektin e ngritjes së vetëdijesimit kombëtar e me këtë edhe të ndërgjegjësimit onomastik.

Sot, liria e zhvillimit të arsimit në gjuhën amë, dhe sidomos tani me arsimin e mesëm të obliguar, hapja e univresiteteve në gjuhën shqipe, komunikimi i lirshëm kombëtar në trojet ku jetojnë shqiptarët dhe bashkëpunimi i tyre në fusha të ndryshme, lufta e fundit e shqiptarëve në Maqedoni, si dhe shumë faktorë të tjerë kontribuojnë edhe më shumë në ngritjen e vetëdijes kombëtare si rezultat i së cilës edhe vazhdon të zgjerohet rruga drejt emrave kombëtarisht të motivuar e me etimologji shqipe. Mirëpo, fatkeqësisht, ky ndërgjegjësim nuk arriti as në të kaluarën, e as sot, deri në atë shkallë sa ka arritur, për shembull në Kosovë. Por, duhet të përsëritet edhe një herë fakti se ky ndërgjegjësimi nuk është i njëtrajtshëm për tërë arealin ku banojnë shqiptarët e Maqedonisë, dhe jo vetëm këtu. Përpjetëzën më të madhe e ka marrë në shtresa inek-

foshnjës së posalindur që asocion në qytete, male dhe lumenj të Shqipërisë (Berat, Valon, Shkodran, Labinot), në simbole nacionale (Flamur, Shqipe) dhe në heronj kombëtar (Martanesh, Kastriot), ndërsa hasen edhe kësi emrash: Kushtrim, Liridon, Arbnesht-Arbëresha, Alban-a, të cilët nxisin nacionalizëm dhe në njëfarë mënyre i përshkruajnë ngjarjet dhe figurat karakteristike nga historia e Shqipërisë...'

ktualisht më të ngritura dhe në qendra më të zhvilluara në pikëpamje komunikative dhe kulturele. Në viset anësore, konservative, ky proces është më i ngadalshëm. Prandaj edhe me të drejtë Bidollari (2001 : 53)²¹ thotë se emrat vetjakë *‘shërbejnë edhe si dëshmi e nivelit kulturor të brezit që i vë’*.

Duke u mbështetur në të gjitha këto që u thanë, krijohet përshtypja se, jo vetëm sot, por edhe në të gjitha periudhat nëpër të cilat ka kaluar, nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm e sidomos të atyre kombëtarë e fetarë, dhe nën ndikimin e mendësisë së përgjithshme të etnikumit përkatës, emrat vetjakë të shqiptarëve të Maqedonisë kanë qenë në një luftë të pandërprerë midis asaj që quhet kombëtare dhe asaj që quhet fetare. Dualizmi dhe reflektimi i identitetit kombëtar dhe atij fetar është prezent edhe sot e kësaj dite në këtë sistem emëror, por me tendencë, megjithëse jo shumë të suksesshme, për rritjen në vazhdimësi të vetëdijes kombëtare e me këtë edhe të reflektimit të identitetit kombëtar nëpërmjet të procesit të emërvënies.

²¹ Vep. e cit.

AFRIM REXHEPI,

Instituti i Letërsisë – Shkup

ESTETIKA E ISO-POLIFONISË

Diskursi i shkencave humane, definohet përmes disa paradig-mave teorike: **pozitivizmi** (kuptimi i veprës artistike kërkohet në shkaqet jashtë veprës, në biografizmin, sociologjizmin apo historicizmin); **fenomenologjia** (vepra artistike përcaktohet përmes transformimit të gjuhës në energji psiqike); **semiotika** (vepra artistike është strukturë e cila vetprogramohet) dhe **dekonstruksioni** – (shkatërrimi ontologjik i strukturave). Duke qenë paradigmë e theksuar e teorive te sotme, dekonstruksio-ni tregon në faktin që njeriu është i krijuar në bazë të dallimit. Në fakt, Pse komunikon njeriu? Sepse nuk është Zot, sepse nuk mund ta sheh të plotën, kurse jotëplotën e definon për-mes kundërvënies. Është dhënë esenca e qenies si e tillë. Në vet zanafillën e njeriut, ka një zbrazëti, ka një ndarje, ka një Mungesë. Unë e ripozicionojë veten, në bazë të pamundësisë të mosqenurit Zot. Opservimet teorike të Platonit, të Niçes dhe të Hajdegerit, e vënë në funksion objektin e mendimit si Diferrance (Dallim që lidh). Stiv Geret, kështu e përshkruan takimin me themeluesin e dekonstruksionit Zhak Derida, “Thonë që ke thënë se ka pafundësisht kuptime. Jo, kam thë-në që nuk mund të ketë një kuptim të vetëm për objektin. Thonë që ke thënë se asgjë nuk është reale sepse gjithçka ë-shtë konstruksion kulturor dhe historik. Jo, kam thënë që nuk ekziston qenie jashtëkohore me të cilën do të krahasoheshim. Thonë që ke thënë se gjithçka e ka vlerën e njëjtë, jo kam

thënë që ç'ështëja duhet të mbetet e hapur". (Chris Garrett, *Postmodernism*, Oxford, 2007;35)

Shkatërrimi ontologjik i strukturës, që realizohet përmes Dekonstruksionit në proces, nuk e bën lojën në botë, por lojën e botës, që logjizohet përmes interpretimeve të gjurmëve që sendërtojnë pikën e prëbashkët të dallimeve. "Pra, është e nevojshme të thuhet se esenca (qenia), ekziston" – definon Hajdegeri. Qenia e Hegelit, është e plotë, e përsosur dhe ap-solute. Qenia e Hajdegerit, është joeplohtë, është joepërsosur, është relative. Pyetemi, Pse Hajdegeri (Martin Heidegger) u përcaktua për formën Da – sein? Sepse forma Da – sein (Qenëzimi), e funksionalizon logjikën dekonstruktive (dallimin që lidh). Një pragmë e tillë teorike është kruciale për mendimin postmodern, sepse nxit shkatërrimin ontologjik të strukturës. Dhe ja pozicioni nxitës i mendimit postmodern: Da – sein (Qenëzimi) nuk referon qenien njerëzore, por pragmen ekzistenciale të saj. Duke e theksur dekonstruksionin midis qenies dhe ekzistencës, ai fjalën Dasein e ndan me një vijëzë në mes Da – sein, për të shenjuar shumësin "të jesh atje (këtu)". Da – sein (Qenëzimi) është entitet pa esencë, esenca e Da – seinit (Qenëzimit), ndodhet në ekzistencën e vet.

„Da – sein (Qenëzimi), është mundësia e vetvetes...nuk është i dhënë paraprakisht si fenomen i definuar dhe real, por si mundësi e formave të ndryshme të ekzistencës. Qenëzimi është lëshuar në ekzistencë për ta definuar qenien apo identitetin e vet". (Michael Inwood, Heidegger – një hyrje e shkurtër, Ideart, Tiranë, 2007; 35)

Në veprën *Politeia*, Platoni theksoi realizimin e harmonisë, përmes artit.

"Arti është funksional, sepse natyra e saj është të formëzojë zbrazëtira përmes shpirtit njerëzor". Opservimi kritik i Par-

menidit, e funksionalizoi idenë e Anaksimandrit, për harmoninë e të kundërtave. Sipas Gadamerit, ai përcaktoi kritikën e mendimit, që çdo gjë është e lidhur në rendin e botës. Pra, vepra artistike, logjizohet përmes harmonisë. Definohet si njësi estetike, me kodin e vet të përcaktuar. Definohet si kompozicion harmonik që tërheq, si objekt estetik hipnotizues, që ekziston për ne dhe brenda nesh. Duke i opservuar principet e estetikës, Parkeri përcakton disa paradigma të formave strukturore të veprave artistike: njësi në dallime, dominim dhe baraspeshë. “Secila vepër artistike, është shumës i elementeve. Nëse një element hiqet, deformat të plotën”.

Njësia e dallimeve, dominimi dhe baraspesha, qenëzohen të funksionalizuara përmes interaksionit, simetrisë apo evoluimit të efektit që definon harmoninë estetike. Harmonia estetike definohet përmes kualitetit emocional. Ngjyra, toni, fjala, janë organizma estetik, që efektuizojnë emocione. Efektet e efektizuara nga organizmat estetik, shprehen përmes analogjisë dhe kontrastit. Tonet e larta, përkundër toneve të ulta, ngjyrat e hapura, përkundër ngjyrave të mbyllura, fjala ditë, përkundër fjalës natë, të kontrastuara bashk, krijojnë proeksione harmonike. Ekziston edhe disonanca apo kolizioni, që i jep intensitet dinamik harmonisë proektive. Principet në fjalë, janë interaktive midis vete, duke qenë simetrike krijojnë të plotën, pra harmoninë estetike. Në art, pjesët nuk mund të funksionojnë të veçuara, por të njësuara përmes proporcioneve estetike. Nëse në një vepër artistike, funksionojnë tre principet e shënuara, vepra shfaqet para nesh përmes efektit të saj tërheqës. Në kontekst, është funksional definicioni i estetit francez Alen Badju,

“E vërteta e artit është kompasibile, është formulë e botës që shënon harmoninë në perfeksion”. Alain Badiou, “Fifteen

theses on contemporary art”, [http: www. 16 beavegroup. org / journalism / archives / 006. Php](http://www.16beavegroup.org/journalism/archives/006.Php))

Objekti estetik, është proektim i energjisë që estetikisht hipnotizon. Në estetikë, materia nuk ekziston. Ekziston, energjia e cila tërheq. Nëse zbulohet një artefakt arkeologjik, për estetët, nuk është zbuluar materia, por energjia, efekti i saj që harmonizohet përmes teknikave perceptive. Një pragmë e tillë teorike, është teoria e estetit amerikan Rudolf Arnhajm,

“Për perceptimin visual, objektet janë dinamike, me energji të brendëshme. Kulla Piza në Romë, është objekt dinamik, sepse perceptualisht ose largohet nga boshti ose afrohet”. (Rudolf Arnheim, *Art and visual perception*, University of California Press, 2005, p. 79)

Polifonia në vazhdimësi e ka nxitur potencialin energjik të harmonisë. Një lëvizje prej objektit estetik kah efekti estetik, është i patjetërsueshëm në përcaktimin e veprave artistike. Të sqarojmë përmes muzikës, sepse arti i saj është mënyra më e vjetër e shprehjes së energjisë estetike. Të qarat përmes zërit, ishte ekspresioni i parë i frikës, instrumenti i parë i shprehjes së tingujve. Shembull tipik, është iso – polifonia shqiptare.

Përcaktojmë dekonstrukcionin e strukturës së iso – polifonisë, për të theksuar vlerën estetike:

Sipas strukturës së definuar nga Vasil Tole:

- Iso – polifonia si artefakt etnomuzikologjik, e ka strukturën si vijon: zëri i parë – shpërndahet; zëri i dytë – pranon; zëri i tretë – kthen dhe zëri i katërt apo iso zëri – harmonizon;

Sipas strukturës së definuar nga Ismail Kadare:

- Struktura e estetizuar e iso polifonisë: Zëri i parë (këndon) zë i dridhshëm; Zëri i dytë (këndon) zë akoma më i

dridhshëm; Zëri i tretë (këndon) ligjërim; Zëri i katërt (këndon) vajtim.

E veçanta e iso – polifonisë, në esencë është tragjike dhe katarzike, është të qarit jo në botë, por të qarit me botën, një lidhje midis të gjallëve dhe të vdekurve. Karakteristikë kjo që iso – polifoninë shqiptare, e dallon nga polifonitë tjera. Duke qenë krijim tragjik, iso – polifonia shtron dilemën estetike, e formëzohet botën kulturalisht përmes tragjikës sepse tragjika është në vetë njeriun apo kultura është ajo që e determinon perceptimin tonë për botën? Përgjigja ndoshta ndodhet në pikprerjen tragjike të qenies midis natyrës dhe kulturës. Megjithatë, estetika e ka definuar ç’ështëjen që arti është një lloj terapie sado – mazohiste për njeriun, i cili është i aftë të vë në funksion inteligjencën emocionale. Në shembullin e iso – polifonisë, trashëgimia kulturore përmes interpretimit, restaurimit apo reciklimeve të mundshme, zhvillon vetëdijen estetike dhe ngrit njeriun në dimensionin kulturor. Për estetët, sfida e trashëgimisë kulturore është teoria e reciklimit apo e restaurimit. Iso – polifonia si artefakt etno–muzikologjik dhe iso – polifonia si artefakt (objekt) estetik, dallojnë përmes teorive interpretative. Toeritë estetike, siç janë ato të Çezare Brandit dhe Umberto Baldinit, restaurimin e definojnë,

“si proces interpretativ që përftohet nga perceptimi i objektit të dhënë (material dhe fizik). Objekti i trashëguar, realizohet kur formëzohet përmes principeve të estetikës: simetrisë dhe harmonisë”. (Cesare Brandi, *Theory of restoration*, trad. Cynthia Rockwell; rev. Dorothy Bell; cur. Giuseppe Basile) Firenze (Nardini), 2005)

Pra, objekti i trashëguar, është i hapur për restaurim apo intervenim nga perceptuesi. Involvimi i shkencës në teoritë e

restaurimit, e ka ndryshuar pragnën. Më tepër teknika shkencore e restaurimit realizohet në vendet anglo – saksone, kurse teknika estetike e restaurimit më tepër realizohet në vendet e mediteranit. Megjithatë, restaurimi më i mirë i objektit të trashëguar, është kombinimi i teknikave.

Postmodernizmi si asnjë formacion më parë, na mësoi që trashëgimia është proces kulturor. Një pragnë e tillë diskursive, është Heterotopia e Mishel Fukosë.

“Heterotopia është kod e jo sistem, është dekonstruktive, e jo strukturore, është postmoderne, e jo moderne. Ç’ështëja e fatalitetit të pikprerjes kohë / hapësirë, është e zgjidhur”. (Re-thinking Architecture: A Reader in Cultural Theory. Edited by Neil Leach. NYC: Routledge. 1997. pp.330)

Fuko është tejet eksplisit, kur mendon që ritmi ekzistencial i epokës tonë, në esencë, më shumë ka lidhje me hapësirën, se sa me kohën. Koha sikur copëzohet në sistemin programues e dekonstruktiv të hapësirës – thekson Fuko. Gjithnjë sipas tij, programimi i ekzistencës njerëzore, do të bëhet përmes sistemit autoregullativ të hapësirës. Sistemet e tilla, bëjnë konfigurimin ekzistencial e të qenurit në botë. Dhe ja sfida postmoderne e trashëgimisë kulturore, ideja të shkruhet një histori e hapësirës, që njëherit është edhe histori e fuqisë – definojnë Fuko. Ka dy arsye, pse teksti **Hapësira Tjetër** (1968), është mjaft tërheqës për mendimin teorik sot.

- E para: shënon një analizë të re për hapësirën. Hapësira është esenca e ideve proektive, me tendencë të ripozonimit. Epoka aktuale, është epokë e hapësirës, sepse bota sot, është bërë sferë që lidhë kuptimet fragmentare në qenësinë e vet. “Me duket që ndodhemi në kohën kur përjetimin e botës e realizojmë, jo përmes kohës, por përmes lidhjeve të dallimeve kuptimore, në hapësirë”.

- E dyta: shënon estetizimin e ekzistencës, përkundër diskursit dominues. “Pasqyra i gjason heterotopisë, sepse ka efekt kthyes. Kthehem nga vetvetja dhe ripozicionohem” – definon Fuko. Pra, heterotopitë janë hapësira alternative, janë funksionale kur njerëzit ndodhen në një pikë ekzistenciale të ndërprerjes absolute të kohës, përkundër kohës së tyre kontinuale.

Dekonstruksionistët thonë që e ardhmja është dekonstruktive: një pjesë e së ardhmes i takon vullnetit dhe dëshirave tona, pjesa tjetër i takon vullnetit dhe dëshirave të Tjetrit. Heterotopitë zbulojnë ligjin e tërheqjes kah kodet. Kodet nuk janë konstruksione praktite, por fakte historike dhe kulturore që na ripozicionojnë. Umberto Eko, është i mendimit që kodet mund të jenë klinamena të epikurit (të nxisin procese shoqërore – politike) ose ligje të polisit (të bëjnë harmonizimin e proceseve shoqërore – politike). Sipas tij, nëse kodet janë proeksione të sistemeve të tilla, atëherë janë metafora. Nëse janë metafora, krijohen nga ngjashmëria. Nëse ngjashmëria ka ekzistuar, ka ekzistuar edhe dikush që i ka perceptuar si të ngjashme. Përmes ngjashmërisë nuk krijohet silogjizmi, por të paktën krijohet një vetëdije e zbehtë, sa mund ta dallojë kodin estetik nga kodet e tjera. Në kontekst, heterotopitë e Fukosë, janë metafora konstruktive të tjetërsimit të hapësirës, të njeriut dhe të lirisë së subjektit. Nëse arkeologjia e dijes, e ka definuar pragnën që njeriu sot nuk jeton në ekzistencë, por në teorinë e ekzistencës, atëherë i vetmi ligj universal që e tërheq atë, është ligji i kodeve.

RINI USEINI,

ITSHKSH – Shkup

MBI KUJTESËN APO NGULMIN, MANIFESTIMI I SOTËM I VESHJES POPULLORE

Ne qoftë si studiues apo si qytetar të zakonshëm kudo që shkojmë jemi të interesuar të njohim ambientin që na rrethon. Kjo njohje vjen si një veçori njerëzore e aprovuar në fjalën "kureshtje" mirëpo nuk i pergjigjet tërësisht nënvetëdijes e cila ka nevojë për qasje më interaktive ndaj përceptimeve të cilat i hyjnë në analizë. Bie fjala, skemi kureshtje ndaj skemave sportive nëse kemi injorancë dhe abstenim ndaj sportit. E kundërta ndodhë në atë që është induktive brenda nesh, për të ruajtur vlerat e përgjithshme kulturore. Të gjitha këto mund ti bëjmë me shabllone të caktuara, në tërheqjen e individëve ndaj krijimit popullor, apo turistit të artefakteve. Etnologjia si mendësi, është e përditshme, ne çdo ditë jetojmë me të, krijojmë mënyra të reja me mbishtresim ndaj gjërave të vjetra. Pra shoqëria është gjithmonë një mjet krijimi, duke u paraqitur me forma të ndryshme dhe situata kohore. Mënyra si inkorporohet individi brenda një grupimi të caktuar, ka një rëndësi të madhe për tu studiuar në aspektin etnologjik. Disa institucione kulturore e profesionale të Evropës japin përkufizimin se: trashëgimia etnologjike e një shteti përfshinë format specifike të ekzistencës materiale dhe organizimin social (shoqëror) të grupeve që të njëjtën e krijojnë, dijet e tyre, prezantimet e tyre, dhe, thënë përgjithësisht të elementeve që krijojnë bazën e çdo grupi shoqëror dhe që i bën të njëjtit të

dallueshëm nga të tjerët (Raporti i Ministrisë së kulturës të Francës, nga interneti).²²

Si vjen e ndërthurur një konglomerat i caktuar kulturor tek njeriu, si ai e ndërton një vlerë të caktuar kulturore, vjen si rezultat i shumë faktorëve të ndryshëm duke filluar nga ai ekonomik, social, apo religjioz. Nëse për shembull marrim për bazë organizimin e një dasme, në të janë të ndërthurur elemente me rite të paganizmit, rite të reja që lidhen me shprehjen ekonomike të familjes, rite që vijnë si rezultat i psikozës njerzore apo të ashtuquajturit kontroll shoqëror etj. Disa nga këto rite janë të patjetërsueshme nëse aplikohen, kanë mënyrat rigoroze të zhvillimit të tyre. Bie fjala te veshja popullore në të kaluarën ka qenë e përcaktuar çdo fines e veshjes, duke filluar nga veshja e vajzave të reja, atyre që janë të fejuara, uara, grave të reja, dhe atyre në moshë të vjetër. Dalimet kanë qenë dhe te veshjet e femrave me statuse të ndryshme sociale, grua e lëshuar nga burri ka pasur diku përparësinë e veshur mbrapsht apo thekët e përparësës të prera (A Gjergji), gjë e cila e përcakton statusin e saj momental në shoqëri.²³

Për veshjet kombëtare shqiptare në viset etnike, e në veçanti ato në Kosovë, është shkruar mjaft shumë, sidomos nga Mark Krasniqi, Rrok Zojzi, Mark Tirta, Andromaqi Gjergji, Afërdita Onuzi, Ikbal Bihiku, Maks Velo, Drita Statovci, Ukë Xhemaj, Shpresa Siqeca e shumë të tjerë. Dhe, konstatim i këtyre shkrimeve është se viset shqiptare janë të pasura me

²² Drita Halimi-Statovci, *Trashëgimia kulturore dhe aktualiteti*, <http://www.epokaere.com/index.aspx?SID=13&PMID=9&LID=2&ACatID=8&ID=35522&Ctype=1>

²³ Shiko: Andromaqi Gjergji, *Veshjet shqiptare në shekuj: origjina, tipologjia, zhvillimi*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, 2005, fq.151-153.

veshje popullore, që karakterizojnë kohë të ndryshme, e të cilat nga ndikimet e kohëve moderne, e sidomos nga ndikimet e lëvizjeve të popullatës kah shtetet e perëndimit, dukshëm ka rënë interesimi për punimin e veshjeve popullore shqiptare.

Një sjellje kështu me siguri se do ta varfërojë fondin edhe ashtu të vogël të veshjeve popullore. Në anën tjetër, nga literatura për veshjet kombëtare shqiptare të autorëve të përmendur, del si konstatim tjetër se në viset etnike shqiptare, deri më tash janë të njohura së paku 140 forma të ndryshme veshjesh popullore, të realizuara në më se 5000 tipe e variante, të cilat janë të grupëzuara sipas gjinisë në zona të ndryshme etnografike.

Me shumë vlerë konsiderohen studimet e bëra për klasifikimin e veshjeve shqiptare, veçanërisht për klasifikimin e veshjeve popullore shqiptare e hartuar nga Prof. Rrok Zojsi, i cili ka edhe meritën më të madhe për grumbullimin e tyre në fondet muzeale, studini madhor i Prof. Andromaqi Gjergji i titulluar Veshjet Shqiptare në Shekuj, si dhe një varg studimesh e botimesh të tjerë të kryera nga A. Dojaka, S. Shkurti, M. Tirta, Ll. Mitrushi, A. Onuzi, Y. Selimi etj.

Klasifikimi i bërë është bazuar në fazën e zhvillimit të kostumeve popullore në fillim të shek. XX.

Bile, fustanella iliro-arbëro-shqiptare është vërejtur edhe nga autoritetet e huaj, si nga A. Bue, i cili thotë se për fustanellë, që dominonte në shumë krahina të banuara me shqiptarë, nevojitej shumë material, përkatësisht udhëshkruesi anglez Spenser, duke kaluar nëpër viset shqiptare, kishte konstatuar se fustanella nuk e mbanë nxehtësinë.²⁴

²⁴ MARK TIRTA, Nga simbolika në artin e zbatuar popullor, «Kultura popullore», Tiranë, 1990, 2, f. 91-93.

Ndër veshjet që ende deri diku ruajnë disa elemente me vlerë për kulturën shqiptare, sidomos në trevën e Strugës dhe rrethinës janë veshjet rituale dhe ato të esës, më saktë të dhën-dërrisë dhe nusërisë.

Veshja rituale e ka humbur funksionin utilitar por e ka vetëm atë apotropeik por edhe e pakuptueshme nga masa e madhe. Duke filluar nga ritet që ndërlidhen me lindjen e fëmijëve hasim disa elemente me karakter ritual. Lireku apo mbështjellësa e foshnjës, në pjesën e kokës ka formën rrethore jo vetëm që ka funksion utilitar por edhe magjik. Forma rrethore ka kuptimin e Diellit e bëhet me qëllim që foshnja në jetë të jetë i fort dhe i bekuar. Një tjetër formë është edhe mbrojtja e foshnjës nga syri i keq, për këtë qëllim në njërën anë të mëngores në pjesën e shpatullës i kanë vënduar nishandër (nishan), e cila përbëhej nga një grafic metalike rrethore ku janë të vendosura tre kokrra të qiqrave.

Kur fëmija rritet, ndërmjet moshës një deri në pesë vjet në këmishën e fëmijës i vendojnë një rrotullar e cila fillonte nga shpina deri te mënga e përparme e dorës së djathtë ndërsa e dorën e majtë vihej nga pjesa e pasme. Këto veshje rituale i vishnin prej Ditës së verës më 14 mars e deri në ditën e Shën Gjergjit. Fëmijët e tjerë deri në kohën e pubertetit në ditët e njëjta mbanin veroren apo një lloj biziliku të thurrur nga peri i bardh dhe i kuq, kurse në shtat vishnin xhamadan, këmishë dhe çorape në ngjyrë të kuqe dhe të bardhë. Vajzat në ditën e Shën Erenisë kishin një rit të caktuar, ato shkonin tek një e fejuar që të ju'a pres flokët, ritë të cilin e kanë praktikuar pas një plepi, pastaj kanë marrë një degë dhe e kanë vënduar në flokë me qëllim që tju rriten. Tek vajzat e fejuara poashtu përdoret shamija e bardhë me kombinime të së kuqes, të cilën

e lidhin dyshe ndër gushë.²⁵ Gjatë Ditës së Verës sëbashku me vajzat tjera shkojnë për të mbledhur kukurek apo lulet e para të verës. Nusja gjatë ditëve të festave pagane, Ditës së Verës, Shën Gjergjit dhe Shën Mitrit, do të vishte brezin e nuses me më shumë kolorit dhe të shëndritshme, zakonisht me vija horizontale në ngjyrë të kuqe dhe dy qetkat të cilat i ka të lidhura me gajtan dhe që në fund mbaronin me dy tufa të gjata që arrinin deri te thembrat, kurse në kokë mbante një shami të bardhë. Ky ritë zgjaste derisa nusja e re të bëhej me fëmijë. Kurse te gratë e tjera nuk kishte ndonjë veshje të përcaktuar rituale. Në ditët rituale, dmth gjatë ditës së verës, Shën Gjergj, Shën Mitër, Sulltan Nevruz gratë nuk duhet as të qëndisin e as të thurin veshje, pasi mund të dalin përgjatë ciklit vjetor bolla dhe gjarpërinjë, poashtu nuk duhet as të prekin sapunin me dorë, dmth të lajnë tesha, pasi mund të dalin kërmij. Në ditën e Arifes, apo një ditë para ditëve rituale i dërgohen veshje apo peshqeshe nuses (të fejuarës), ky zakon përsëritet edhe në ditët festive.

Për ditën e verës nënat përgatisin për fëmijët veroren, apo penjtë e thurur me ngjyra të kuqe e të bardhë. Pas thurjes mbi penjtë vendosen para të vjetra metalike të cilat janë të performuara. Verorja vendohet në shpinën e fëmijës, kurse anëtarët e tjerë të familjes në bizilikon e dorës me qëllim që dora të mos ndaloj të punoj, poashtu dhe te gishti i madh i këmbës së djathtë që të mos pengohen dhe të rrëzohen gjatë ditëve verore. Fëmijët paralajmërohen që ti heqin veroren menjëherë sapo ti shohin zogjtë shtegtar dhe ti vendosin në ndonjë kaçube.

²⁵ Shpresa Tuda „Te dhena per zakonet e vdekjes dhe vajtimet ne Struge dhe rrethine”, Gjurmime albanologjike-Folklor dhe etnologji, VII-1977, Prishtine , fq.172.

Në ditën e Shën Eremisë gratë shkojnë në fshatin Shum, tek burimi i fshatit, që të mbesin shtatëzëna, apo ti heqin magjit e këqija. Aty paraqitet një grua plakë e cila i bënë këto rite. Për ta realizuar ritin i nevojitet një pe nga veshja të cilën e hedh në burim, dhe më pas grat lahen me ujin nga burimi i njëjtë. Që të ketë rezultat ky rit plakës i dhurojnë ndonjë dhuratë si këmishë, peshterkë etj.¹

Veshja martesore

Tek dhëndurët mbahej fustanella (te toskët), e bardhë e punuar nga pambuku, me shumë kinde e gjatë deri në gjunjë. Në pjesën e sipërme veshnin këmishë të gjatë deri në bel, me mëngë të gjata dhe të hapura. Mbi këmishë vishnin jelekun nga shajaku i zi, nga soha apo somotka (kadife), e zbukuruar me gajtan të mëndafshët. Ndër këmish vendoset potkoshuli (apo maica) me mëngë të gjata. Në këmbë mbanin kalçinj prej sohe apo somotke me të cilët i mëshillnin këmbëzat e brekëve. Pjesë përbërëse e kësaj veshje ishin edhe çorapet e kuqe, brezi i kuq dhe opinzat e bardha me dekorim të pasur qëndisës. Përderisa tek gegët pjesë përbërëse ishin tirqit me shumë zbukurime nga gajtani i zi, në pjesët anësore dhe tek xhepat, përderisa këmisha, jeleku dhe opingat janë të qëndisur me gajtan të bardhë. Në kokë mbanin kësulë dibrane (lloj kapele me origjin nga Dibra, e punuar nga mjeshtërit dibran).²⁶ Nuset mbanin dullak me dimensione 5–6 metra, në formë të katërkëndëshit këndëdrejt nga materiali i pambukut apo kadifes, më shumë në ngjyrë të kuqërremt. Bashkëkrushka apo dasmorja e parë nga ana e burrit ja heq me dorë para grave të tjera përderisa ata i këndojnë në shtëpinë e saj gjatë aktit të shkuarjes për ta marrë dhe më pas prap e mbulon që

²⁶ Dr.Nebi Dervishi „Etnokultura e fushegropes se Ohrit”, Cabej, Tetove, 2005, fq.334.

përsëri të ja heq burri i saj në shtëpinë e re. Prej pjesës së duvakut e deri te thembrat mbanin një tufë prej penjëve të argjendët e ashtuquajtur allk, kurse tjetrën që mungon nga ana tjetër do tia vendoj bashkrushka nga pjesa anësore e ballit. Në kokë gjithashtu mbante lule prej materialit plastik, e zbukuruar me lule të argjendëta (apo teli i shëndrritshëm). Këmisha e endur në vek, e qëndisur me tel të shëndrritshëm ku vendoseshin pesë alltane apo para të vjetra metalike, një të madh dhe 4 më të vogla, të cilën e lidhnin me ushkur deri te brezi i leshtë. Poashtu pjesë e veshjes ishte edhe jeleku i zi i cili ishte qëndisur me pe të bardhë, në mes kishin brezin e nuseve, e punuar poashtu me tel të shëndrritshëm në vek (apo e emëruar të disa fshatra si razboj).

Poashtu në mes mbante një çever, dy mindilka të mëdhaja të qëndisura me pulla të cilat veendoseshin mbi bofshë. Nusen e kanë marrë me qerre druri, e mbuluar me jorgane të kuq dhe tepik, që të mos e shohin njerëzit të mos e marrin mësysh. Ditën e parë nusja ua lante këmbët ose duart më të vjetërve të cilët i jepnin para, në ditën e dytë mbante një bofsh dhe qëndronte në këmbë para të gjithëve me sy të mbyllur apo nusëronte, kurse në ditën e tretë, të ën apo të shtunën shkonte të mbush ujë me bofshën e nusërisë.

Ndikimi i modernizmit ne veshje

Shumë dyqane me suvenire e përdorin si mjet fitimi riprodhimin e traditës pa kurrfarë kriteri. Mjafton të bësh një para-lele krahasuese, përmes një kostumi origjinal popullor të çfarëdo krahine, me një që blihet në dyqanet me suvenire të riprodhuara, jo vetëm që ka ndryshime të dukshme, por ka një tjetërsim total deri në humbjen e gjurmëve të tij.

Organet përkatëse që licencojnë duhet të japin urdhër të shkruar edhe në kontratë, që riprodhimi i kostumeve popullore dhe suvenireve nga këto dyqane të mos bëhet pa u konsultuar me specialistë të traditës popullore.

Qe në pamje të parë ato janë lehtësisht të kuptueshme, sepse nuk janë e njëjta gjë, pasi kuptohen që nga ngjyra, materiali, kombinimi i ngjyrave etj.”. Me të vërtetë gratë që prodhonin kostume aso kohe nuk mund të dinin të shkruanin as emrin e tyre, por kombinimi i ngjyrave dhe ruajtja e skemës kompozicionale ishte perfekt. Mjaftojmë të japim një shembull, , kostumi i Struges është ngjyrë e bardhe, ai nuk pranon asnjë lloj ngjyre tjetër. Zbukurimi i tij domosdoshmërisht duhet me gjatë të zi dhe me tela, dhe nuk pranon tjetërsim.

Në fondet muzeale të Instituteve shqiptare ruhen një numër i konsiderueshëm kostumesh popullore, dhe jo thjesht si numër, por variante të shumta që përfaqësojnë të gjitha tipet e veshjeve popullore shqiptare.

Variante që konsistojnë në veshje ceremoniale, në veshjet e përditshme, në veshjet sipas grupmoshave, në veshje për fëmijë, vajza, për gra të një moshe të kaluar. Po, përsëri nevoja e riprodhimit është domosdoshmëri, pasi shumë prej kostumeve, që janë në fondin muzeal, kanë nevojë për riparime. Por edhe riparimi i tyre bëhet në laboratorin e specializuar dhe nga njerëz kompetentë e të specializuar në këtë fushë. Do të thotë se në çdo ndërhyrje për riparim ruhet skema kompozicionale, ngjyra, përbërja e materialit dhe qëndisja. Ndërsa riprodhimi nga njerëz jo kompetentë shmang çdo gjurmë që të çon drejt origjinës së veshjes; dhe kjo është për të ardhur keq.

Pse duhen ruajtur kostumet popullore

Mbledhja e këtyre kostumeve popullore ka filluar pas Luftës së Dytë Botërore, më saktë në vitin 1947, kur u ngrit sektori i etnografisë, i drejtuar nga etnografi i mirënjohur Rrok Zojzi. Për veshjet popullore duhet ruajtur origjinaliteti i tyre, se janë një shprehje e qartë e identitetit shqiptar. Në një festival folklorik, të zhvilluar jashtë shtetit, ne duhet të përfaqësohemi me kostumin tradicional. Edhe bota i ruan dhe i mirëmban shumë. Është një element identiteti. Gjinden forma të ndryshme për organizimin e festivaleve folklorike. Me të vërtetë, një festival i bërë para 30 vjetësh nuk ngjan me një festival të bërë sot, por forma të tilla duhen ruajtur, pasi janë vlera të trashëgimisë kulturore të pakontestueshme të çdo populli. Kostumet kanë rëndësi për procesin studimor.

Elementet etnologjike janë në rrezik nga dëmtimi më shumë se elementet arkeologjike për arsye se kanë materiale organike, të cilat kërkojnë standarde specifike për ruajtje. Më të rrezikuara janë veshjet popullore të cilat veçanërisht janë të ndijshme në lagështi dhe dritë, sikurse dhe elementet e drurit, të cilat duhet të ruhen në kushte të përshtatshme dhe të konservohen. Ka raste kur dhe në mënyrë të papërshtatshme i ruajnë edhe vetë muzeumet këto elemente, por ndodh që dhe koleksionerët privat ti dëmtojnë me tendencë. Disa prej tyre për shembull i ekspozojnë drejtëpërdrejt në diell, që për to është në masë të madhe e dëmshme.

Këtu pasqyrohet edhe historia e zhvillimit ekonomik e kulturor të një vendi, të një krahine e të një fshati. Njëpërmjet një veshjeje ne kuptojmë edhe nivelin e zhvillimit kulturor, si dhe psikologjinë e një vendi. Krahina e Strugës ka një kostum femëror në formë kokete dhe të zbuluar, gjë që tregon lir-

shmëri. Ky kostum në Kukës është ndryshe, i mbyllur deri në fyt. Në një formë, tregon fanatizëm. Të gjitha këto elemente, të marra një nga një, kompletojnë fizionominë e krahinës.

Bibliografia

Drita Halimi–Statovci, *Trashëgimia kulturore dhe aktualiteti*, <http://www.epokaere.com/index.aspx?SID=13&PMID=9&LID=2&ACatID=8&AID=35522&Ctype=1>

Andromaqi Gjergji, *Veshjet shqiptare në shekuj: origjina, tipologjia, zhvillimi*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, 2005, fq.151–153.

Mark Tirta, *Nga simbolika në artin e zbatuar popullor*, «Kultura popullore», Tirane, 1990, 2, f. 91–93.

Shpresa Tuda „Te dhena për zakonet e vdekjes dhe vajtimet në Struge dhe rrethine”, *Gjurmime albanologjike–Folklor dhe etnologji*, VII–1977, Prishtinë

Dr.Nebi Dervishi „Etnokultura e fushegropes së Ohrit”, *Ca-bej*, Tetovë, 2005

AFET JASHARI,

Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë

PEHLIVANIZMI – VLERË E TRASHËGIMISE KULTURORE NË MAQEDONI

Prej kur ekziston mundja ose *pehlivanizmi* është rëndë të thuhet, por të dhënat flasin se sporti i mundjes është shumë i vjetër dhe ka ekzistuar tek të gjithë popujt e lashtë, duke filluar nga grekët, egjiptasit, romakët etj. Ky fakt vërtetohet edhe ne veprën e Iliadës së Homerit. Aty poeti ka përshkruar dyluftimin mes Ajantit dhe Odiseut. Nga ajo kohë është dashur të kalojnë shumë vjetë që mundja të transformohet në mundje folklorike ose *pehlivanizëm* me të gjitha tiparet e saj. Duke pasur parasysh se mundja më tepër është e theksuar te popullata shqiptare dhe myslimane që jeton në Maqedoni por edhe jashtë saj, ky etnosport është paraqitur me zgjerimin e Perandorisë Osmane. Në këtë periudhë mundja ka qenë mjaft e popullarizuar. Ndryshe të dhënat përs *pehlivanizmin* mund të gjejmë edhe te udhëpërshkuresi Evlija Çelebija i cili thekson se “*shkolla*” për mundje janë themeluar në kuadër të teqeve. Sipas tij nga shekulli XVII në disa nga këto shkolla numri i anëtarëve ka qenë deri ne 300 pjesëmarrës, të cilët kanë ushtruar dhe janë përgaditur çdo ditë në orët e mëngjesit.

Mundja, si një etno sport, ka një traditë të gjatë, gati se pesëshekullore edhe në Karshiakën e Shkupit. Në fillim, sistemi i garave ka qenë, veçanërisht në forma folklorike të mundjes, me karakter lokal dhe janë mbajtur në një fshat të caktuar apo festa familjare (si dasma, synetllëk etj). Më pas janë zhvilluar

edhe format tjera të garave, si festivale apo turne të ndryshme që janë organizuar me rastin e ndonjë feste shtetërore.

Në Studeniçan që graviton në Karshiakën e Shkupit, mundja ka marrë nuanca të karakterit multietnik, që vazhdon ende të kultivohet, sidomos kur dihet se në këto lojëra, sidomos kohëve të fundit, marrin pjesë garues të përkatësive të ndryshme etnike. Me gjithë traditën e krijuar në katër vitet e fundit mundja sërisht është rikthyer, si vlerë kulturore e Karshiakës e cila mbështetet nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë dhe Komunës së Studeniçanit, ndërsa Shoqata Qytetare për Arsim, Kulturë, Sport dhe Ekologji AKSI-Karshiakë ka filluar nismën që këtë etno sport të shpallë trashëgimi kulturore në Maqedoni, ku Studeniçani është marrë si shembull. Studiuesi i folklorit Izain Murtezani nga Instituti i Folklorit “Marko Cepenkov” në Shkup ka përgaditur Elaboratin për sportin tradicional në Studeniçan, ndërsapritet që Këshilli Kombëtar i Kulturës pranë Ministrisë së Kulturës së Maqedonisë, t’i miratojë epitetin “*trashëgimi kulturore*”.

Karakteristikat e mundjes ose pehliuanizmit

Ky etno-sport ka shumë protagonistë duke filluar nga pehliuanët, referët, surlaxhijntë, daullet, audienca, udhëheqësi i manifestimit etj. Kuptohet se protagonistët kryesorë në *seire* (siç quhet manifestimi i mundjes tradicionale) janë mundësit. Para ndeshjes pehliuanët luajnë lojën rituale *perde*. Bëhet fjalë për lëvizje rituale (nga dy, tre ose më shumë mundës) në formë të vallës me daulle dhe surle. Qëllimi i *perdes* është që pehliuani të tregojë forcën dhe aftësinë e tij para publikut. Pehliuanët janë të veshur me *kismete* (pantolle prej lëkure), janë të lyer me vaj në tërë trupin dhe sipas kategorivë dalin para publikut për të luajtur vallen e pehliuanëve.

Protagonistët e mundjes tradicionale

1. **Pehlivanët** (mundësit),
2. **Referët** (gjyqtarët që përcjellin dyluftimin e mundësve),
3. **Surlaxhijntë dhe Daullet** (gjatë gjithë kohës përcjellin me tingujt vallen dhe dyluftimin e mundësve),
4. **Audienca,**
5. **Udhëheqësi i manifestimit.**

Po ashtu pehlivanët janë të ndarë në kategori dhe ashtu dalin para publikut. Ata ndahen në 5 kategori. Meqë emri pehlivan është me origjinë nga gjuha turke, po ashtu edhe klasifikimet emërohen me turqizma. Kategoria e parë quhet **Bash Pehlivan** që janë mundësit më të fortë. Dyluftimi mes tyre zgjat më shumë dhe ngjall me tepër interes tek publiku. Pastaj **Bashallti** (kategoria e dytë). Në këtë kategori janë pehlivanët të cilët sipas forcës janë të ranguar menjëherë pas Bashave. Pastaj kategoria e tretë e quajtur **Bujuk-orta**, ku janë pehlivanët me forcë të mesme të madhe dhe kategoria e katërt që njihet si **Kyçyk-orta**, pehlivanët me forcë të mesme të vogël, si dhe kategoria e 5-të dhe e fundit, janë fillestarët ose **Kyçyk**. Tek fillestarët bëjnë pjesë edhe fëmijët.

Kategoria e Pehlivanëve (mundësve)

1. **Bash Pelivan (I),**
2. **Bashallti (II),**
3. **Bujuk-orta (III),**
4. **Kyçyk-orta (IV),**
5. **Kyçyk (V).**

Mundësit pas fitores shpërblehen sipas kategorive, në të cilët ndeshen. Më parë si shpërblim kryesor ka qenë dashi, demi etj, por tani shpërblimet jepen në të holla. Sipas pehlivanëve shpërblimi nuk është edhe aq me rëndësi, sa është popullariteti dhe krenaria e tyre. Në Studenican si pehlivanë më i fortë

flitet se ka qenë Tefik Pehlivani, por edhe shumë të tjerë të cilët kanë qenë në numër të madh. Përveç mundjes popullore këta mundës kanë marë pjesë edhe në gara të regullta profesionale, madje edhe në suaza ndërkombëtare. Tefik Demiri në vitin 1962 ka qenë pjesëmarës në kampionatin botërorë të mundjes në Mançester dhe e ka marë vendin e dytë.

Studenica – shembull për t'u shpallë trashëgimi kulturore
PEHLIVANLLËKU

Ky vendbanim gjithmonë ka qenë i njohur me pehlivanë që brez pas brezi e kanë trashëguar. Tefik Demiri, Ibrahim Ibrahim, Xheladin Iseni, Nevzat Latifi e shumë të tjerë në shtetin e ish-Jugosllavisë kanë qenë pjesë e repretezacionit të mundjes së atij shteti. Ndërsa sot ndër pehlivanët më të njohur janë: Ali Demiri, Qenan Ibraimi, Xhezair Latifi, Muhamed Vejseli, Sabedin Jashari, që janë dëshmi se trashëgimia nga parardhësit e tyre e ruan traditën e vjetër shekullore.

Duke u bërë epiqendër e këtij etno-sporti në Studenica marin pjesë edhe mundës nga të gjitha viset tjera të Maqedonisë, por edhe nga Shqipëria, Kosova, Bullgaria, Turqia etj.

Materiali burimor reth pehlivanizmit si sport tradicional në Studenica është në shkallën më të lartë të rrezikut nga shumë faktorë, duke filluar nga ata ekonomik por edhe faktori kulturor. Megjithatë momentalisht një herë në vit mbahet turneu në formë manifestimi në Studenica, megjithatë mungon një interes më i madh nga ana e institucioneve në drejtim të financimit dhe riafirmimit të këtij etno sporti në Maqedoni. Tani ky sport është në agoni dhe është shumë vështirë për t'u rigjallëruar, nëse institucionet e sistemit nuk intervenojnë, duke e ditur faktin se shumë mundës *pehlivan* kanë qenë pjesë

e ekipeve apo klubeve profesionale, të cilët garuan në shumë kampionate shtetërore dhe botërore.

Vlera e kësaj tradite rrjedh nga fakti se në përmbajtjen e saj mund të shihen shumë elemente arkaike që lidhen me zë (instrumente muzikore), veprimi i aktorëve (pehlivanët) dhe audienca. Rëndësia e këtij etno-sporti është se në këtë mënyrë promovohen vlerat popullore, të cilat në të ardhmen Karshiaka e Shkupit mund ta shndërrojnë në destinacion turistik në Maqedoni.

ARLIND FARIZI,

Fakulteti i Filologjisë, USHT – Tetovë

“KONTRIBUTI I LETËRSISË PËR RUAJTJEN E TRASHËGIMISË – SIMBOLI MITIK I GJARPRIT TE ‘LULET E FTOHTA TË MARSIT’ TË ISMAIL KADARESË”

Letërsia shqiptare është unikale për sa i përket veshjes së saj me pektun trashigimisë kulturore. Ajo merr frymë përmes miteve, zhvillohet përmes mekanizmave të saj dhe qenësisht përmes tyre mbetet e gjallë dhe e fresktët. Kontributi i letërsisë shqipe në ruajtjen e trashigimisë kulturore është i madh. Aq sa e bën atë të ketë status ontologjik. Kënaqësia për të rrëfyertë *ta-shmen e pakryer*, e shoqëruar me dëshirën për të dëgjuar raposdi dhe folklor të pastër shqip, e bëjnë të pavlefshme krizën e trashigimisë tonë të përgjithshme kulturore. Kështu, njeriu ballkanik nuk shteret, nuk e ndjen të panevojshëm rrëfimin, fiksionin, përkundrazi e ndjen si një nevojë ontologjike që lidhet me ekzistencën, me strukturën e tij psiko-kulturale, me konservatorizmin e tij, madje në një mpleksje të vazhdueshme të ndodhive reale me mitin. Miti dhe letërsia bashkëjetojnë me njëra-tjetren në këto treva ku lehtëzi mund të ndër këmbëhen. Miti bën pjesë në një realitet të përjetshëm që mbart të vërtetat e përjetshme, që mbart kumte që luajnë një rol shumë të rëndësishëm në jetën e qenies ballkanike, që sjell mekanizmat e krijimit të tij për të shpjeguar ngjarjet e sotme.

Shkrimtari Ismail Kadare si rrallëkush ndër shkrimtarët ballkanikë njeh në mënyrë të nrekullueshme thelbin, mënyrën e ekzistencës, trillet e mitit. Prozatori në gjithë veprën e tij dal-

lohet për respektin që i kushton mitit dhepërdorimit efikas të tij, paktit midis krijimeve të tij dhe mitit, përzgjatjen e ndodhive të zakonshme në mit, tëçastit në përjetësi, të të zakonshmes në tëjashtëzakonshme, të të veçantës në të përgjithshme, si dhe mekanizmin e kundërt të zberthimit të mitit si ndodhi e zakonshme, e përjetësisë në çast, e të pergjithshmës në të veçantë. Nga këto marrëdhënie të vazhdueshme bashkëpunimi dhe pjesëmarrjeje proza e Ismail Kadarese ruan si tipar tipologjik nëmatricën e saj krijuese mitin e për pasojëdy operacione të kunderta: mitizimin dhe çmitizimin. Kodi i zberthimit të ngjarjeve gjendet në mit, në mënyrën mitologjike të të menduarit, në menyren mitologjike të zberthimit të ngjarjeve dhe dekodifikimit të tyre... Ismail Kadare bën interkalinin e objekteve mitikepërmes ligjërinut në këtë lojë të vazhdueshme që merr trajtat e rrahjeve alternative të tekstit që e bëjnë atë të pulsojë e të marrë jetë. Por mund të flasim për mite shumë të vjetra, por jo të perjetshëm, sepse historia e njerëzimit, e konverton realen në të folur dhe vetëm ajo përgjigjet për jeteën dhe vdekjen e gjuhës mitike. Pak a shumë e larguar, mitologjia nuk mund te themelohet veçse historikisht, sepse siç thotë Barthes—imti ështëshqiptimi i vendosur i historisë: ai nuk mund të shfaqet nga natyra e sendeve.

Kadare është mjeshtër i krijimit të mekanizmave të shqiptimit të mitit, e end tekstin duke shkruar mitin historik me krijimin e të perditshmes mitike, demitizon, trajton deziluzionin, përdor ironinë e alegorinë.Proza e tij afrohet me mitin sepse mund të konsiderohet vete mit.Perspektiva narrative është sociale, morale, filozofike. Motivet apo naremat (njësite më të vogla narrative) janë të lira e dinamike dhe ndërtojnë një metaforë të gjerë arketipale, gjitha këto i gjejmë të theksuar të romani *Lulet e ftohta të Marsit*...

Ky roman hapet me dy fëmijë që zbulojnë një gjarpër, të cilin Mark Gurabardhi e sheh si metaforë për rikthimin e praktika-ve sociale të padëshiruara në vakumin politik të Shqipërisë. Pasi ka jetuar vitet e fundit të regjimit, Marku e sheh marrëdhënien e tij me të dashurën më të vogël si një mundësi për të prerë lidhjet me të kaluarën dhe të lidhjet me të ardhmen. Por, e dashura i thotë se shumë shpejt një xhaxha do t'i vizitojë dhe do u bëjë me dije nëse janë apo jo të përfshirë në një gjakmarje të para komunizmit. Me këtë lugat dhune mbi kokën e familjes së saj, e dashura e Markut nuk është më një guidë drejt të ardhmes, por edhe vetë ajo “*mbërthehet nga një gremç i lashtë dhe i ndryshkur.*”

Ky raporti mitit dhe krimit trajtohet te *Lulet e ftohta të mar-sit*, megjithëse në kohën pas-regjimit. Jeta e Mark Gurabardhit është e ndarë në dysh nga trauma e së kaluarës që vazhdon të ndikojë tek e ardhmja e tij. Struktura e romanit e reflekton këtë, teksa secili kapitull që ka të bëjë me jetën e tij të përditshme theksohet me një kundër-kapitull që gërmon te miti, folklori dhe halucinimet. Marku shpreson që këto deklamime mitike do e lejojnë të pranojë të tashmen dhe ta lirojnë prej frikës nga e kaluara.

Duke kërkuar për mitin ‘e duhur’, ai e fillon me përrallën e vajzës që detyrohet të martohet me një gjarpër në mënyrë që familjes së saj t’i falet një krim i panjohur. Megjithatë, tmerri i saj i fillimit kthehet në gëzim teksa çdo natë gjarpri transformohet në një bashkëshort të bukur dhe të kujdesshëm para se të rimarrë formën e gjarprit në mëngjes. E irrituar që nuk mund të ketë një jetë publike me bashkëshortin, ajo natën, teksa ai fle, i djeg lëkurën e gjarprit. Historia në fillim e lejon Markun të negociojë ndarjen midis ekzistencës së tij në kohën e regjimit dhe një të ardhme të hapur, megjithatë teksa vajza

është e paaftë të zgjidhë situatën e saj, shpresat e Markut për të ardhmen ngadalë shuhën me përparimin e romanit. Mbase një nga format më interesante të shfaqjes së arketipit të metamorfozës në poetikën e prozës të Kadaresë është kthimi i njeriut në gjarpër dhe anasjelltas. Metamorfozat, duke qenë *figura-vizion*, kanë si kusht të zhvillimit të tyre ndryshimin e trajtës njerëzore dhe mbartjen e saj në kafshë, bimë apo gur. Tek *Lulet e ftohta të marsit* metamorfoza vjen e lidhur me personalitetin e shumëfishtë të njeriut dhe kolektivitetit, dhe me pasojat e një zhvillimi të shpejtë e transformues shkuan studiuesja e letërsisë Viola Isufaj.²⁷ Në veprën *Lulet e ftohta të marsit*, mund të shohim, hetimin e krimit brenda byrosë politike. Të shfaqësh burimin, kjo është pra të zbërtheshmekanizmin e aluzionit për ta lejuar më pas të shprehë në mënyrë të tërthortëdomethënien. Disa dukuri dhe psikoza, veçmas mënyra e eliminimit të krerëve të politikës rivalë a kundërshtarë, drejton përfytyrimin e një marrësi të vëmendshëm kah imazhi i gostive të hershme, në shtëpinë e atridëve, dhe bashkë me këtë, të zgjojnë dhe drejtojnë kujtesën kah vrasjet brenda fisit në lashtësi.

*Ishte dëgjuar vetëm një zë, ai i Hasobeut, gjysmë britme, gjysmë rënkim: portat ishin të mbyllura nga brenda!... Ministër i Brendshëm dhe nuk e paskësh ditur se në vrasjet e mëdha, portat mbylleshin gjithmonë nga brenda!*²⁸

Tek *Lulet e ftohta të marsit*, personazhi i Markuti cili shfleton fjalorin mitologjik për të zbuluar sa më shumë të dhëna për ngjarjen mitike të *vjedhjes së pavdekësisë*, ai kundron pikturen e vetme që shoqëron tekstin: Tantali në skëterrë duke vuajtuar dënimin – i ndëshkuar si një grykës i zakonshëm.

²⁷ Viola Isufaj, f. 107

²⁸ Kadare, I., Vepra e plotë, Vëllimi 13, Onufri, Tiranë, 2009, f. 479

Paraqitja e një dënimi të rëndomtë bëhet shkak që mendja e personazhit të rindërtojë ngjarjen mitike duke këmbëngulur të gjejë të vërtetën e një ndëshkimi të tillë dhe duke paralelizuar gjithnjë me ngjarje të bashkëkohësisë totalitare. Në kuadër të maskimit, fshehjes së këtyre krimeve, padyshim, kanë qenë të pashmangshme shantazhet, presionet, kurthet. *Flitej se diktori, sa më shumë plakej, aq më fort i lidhte anëtarëte Byrosë Politike me gremça të tillë. E në qoftë se ai i kishte mbërthyerme dosje shantazhi të tjerët, pasardhësin e tij, do ta kishte lidhur dyfish, trefish*

Julia Kristeva ngulmon mbi mënyrën e shndërrimit, veçori kjo endërtekstorisë të cilën po rrekemi ta nxjerrim në pah në artin e Kadaresë. Ne përcaktuam burimin, vumë theksin mbi një origjinë të palëvizshme, qëna rezultoi e veçueshme, e vrojtueshme, e qëndrueshme, e kapshme dhe enjohshme. Mirëpo duke qenë se ndërteksti është menduar edhe si një force e shpërndarë e cila mund të shpërhapë gjurmë pak a shumë të pakapshmenë tekst, po vëmë theksin në këtë trajtim në dy procese thelbësore nëpër të cilët kalon parateksti: zvetërimi i modelit tragjik dhe domethënia e re që ijepet temës së trashëgimisë. Elementet e refleksionit mitik gjenden kështu në gjysmë të rrugës, nëmes dy perceptimeve dhe dy koncepteve. Mirëpo ekziston një ndërmjetësim midis shenjuesit dhe konceptit: kjo është shenja. Në zhvlerësimin që Kadareja i bën fantastikes, ka njëpërplasje forcash: midis asaj që ka ndodhur dhe asaj që është shpallur. Ky konflikt ndodh brenda shenjës. Le të hetojmë sesi i shenjuari i kundërvihet shenjuesit në shembujt emëposhtëm të marrë nga *Lulet e ftohta të martës*. Martesa me gjarprin, netët e dashurisë. Në romanin *Lulet e ftohta të martës*, shenjuesi është ajo që quhet “martesë me gjarprin” dhe mund t’ureferohet aspekteve që kanë të bëjnë

me një detyrim për të mbajtur njëgjarpër në shtëpi. (*që nuk të habiste dhe aq mes aq shumë gjërave të marraqë kishte bota*). Kapaciteti i palimituar që ka shenja, imazhi shenjuesmbulon një koncept tjetër: detyrimi merr kuptimin e njëfarë dënimi, njëfarëdamke, takse që duhej paguar për të shlyer një faj të madh. Si imazhi, edhe shenja janë konkrete, por kanë fuqi referenciale; kanë një mundësi tëpakufizuar për të shenjuar: Mbajtja e gjarpërinjve nëpër banesa s'është dheaq e pazakontë. Vetë përdorimi i fjalës së vjetër "*rrita gjarpurin që të mëhante kryet*" tregonte se kjo punë njihej mirë dikur. Refleksioni këtu mbetet në mes të magjisë e shkencës. Gjarpri, i kthyer në djalosh, në mesnatë ka fjetur me vajzën e pastaj, në të gdhirë, ështëkthyer në trajtën e tij prej reptili. Vajza është zhvirgjëruar. Ajo çka paraqitetme anë të magjisë, shkencërisht është e pamundur. Por a mund të shkonimmë tutje, duke konsideruar çudinë e magjisë, si shprehje të pavetëdijes sëkolektivitetit? Zhdukja e gjarprit dhe pezmatimi i vajzës. Shpjegimi që i referohetmagjisë është ky: vajza i ka djegur cipën që e kthen në gjarpër, duke i djegur kështu $\frac{3}{4}$ e kohës. Ajo i ka vrarë kohën e gjarprit; ai s'mund të jetojësi njeri, pasi si i tillë qëndronte vetëm $\frac{1}{4}$ e kohës. Shpjegimi që i largohet magjisë është ky: vajza vetë ose vajza bashkëme prindërit mund ta kishin hedhur në zjarr, jo lëkurën e gjarprit, por atëvetë duke dashur t'i jepnin fund, qoftë edhe me rrezik, njollës së turpërimtublik. (Në analogji me njerëzit kur shqyenin, në një çast dëshpërimishenjat damkosëse nga rrobat, nga portat e shtëpive). Lumturia e vajzës pas natës së parë të dasmës, mund të shpjegohejme premtimin e dikujt (të prindërve, ndoshta të fisit), se tmerri do tëishte i përkohshëm. Pra, nuk ka pasur shndërrim të gjarprit në djalë, netëdashurore, ëmbëlsi, lumturi, nuk ka pasur magji. Një nga të dhënat e motivit mitik-

virgjëria e humbur—zhvlerësohet meanë të përdorimit të elementëve më të rëndomtë të jetës shoqërore.(Kishte kaq shumë raste —thotë narratori— për ta humbur në kushtet e familjeve të mëdha, ku djemtë dhe vajzat kushërira jetonin nën një pul-laz.)Dallimi midis fantastikes dhe të rëndomtës mund të perceptohet.A qenka ai një konvencion a shprehje e së pavetëdijshmes kolektive? Nëaksin e kundërshtimeve midis natyrës dhe kulturës, duket se autori dëshironte jetë deri në fund krejtësisht transparent ndaj realitetit, sado zhgënjyes të duket ai: zhgënjimi prej natës së parë të martesës, tragjedia më e rëndomtë:shëmti trupore, gjymtime, pafuqi seksuale.Kishte mundësi, gjithashtu, për shembull, që përveç turpërimit publik,gjithë vazhdimi i ngjarjes: dhëndri i bukur, dashuria etj., nuk ishte veç njëpjellë e trurit të vajzës në kushtet e një trandje të rëndë — vijon arsyetiminnarratori.Në këtë mënyrë, “të vërtetat” e mitit ofrojnë disa shpjegime jashtë“çiltërsisë” së mitit, përmes lojës së tropeve, alegorisë, metaforës, metonimisë, simbolit. Atëherë besimet religjioze në fiksione, elementët fantastikë, nuk janë të vërteta për t’u zbuluar, sado që presupozohen të jenë të vërteta, por shtylladrejtuese tek një e vërtetë, e cila tashmë mund të qëndrojë në një formë tërë dhe në vetë letërsinë.Tek *Lulet e ftohta të marsit*, grotesku përmban edhe të shëmtuarën estërzmadhuar, të llahtarshmen dhe të përbindshmen. Ndërthurja e komikes ose qesharakes me të çuditshmen bëjnë qësimboli mitik i gjarprit të humbasë tmer-rin, frikën dhe nderimin që mbarttedikur. Ai është “dhëndri” që vjen me shportë mbi kalë, bashkë me dasmorëte tjerë; ai thirret “i shoqi”—ky është një emërtim grotesk— dhe atij autori I përshkruan veprime e shërbime që kryejnë rëndom nusia me dhëndrin. Poashtu ai është bashkëshorti—gjarpër, me të cilin, të mbledhur kutullaç në njëshportë, nusja e re shkon

kudo, p.sh.me të ajo shkon në kishë të dielën.Ja një situatë groteske:*Mbasdite vonë, hipur mbi kuaj mbërritën pronarët e gjarprit, gjithëdihatje e kërcënim.“Dhëndrin” thirrën te pragu. “Duam të shohim dhëndrin.”*

Te “Lulet e Marsit” kemi një shfaqje tjetër personazhi, në vend që të jetë mitologjia ajo që i jep forme realitetit, mbetet thjeshtë një histori mitologjike, **personazhi mitologjik dhe ai historik**.Në kontrast me të, heroi i njëromani më të vonshëm “Lulet e ftohta të marsit”, largohet nga të dyja edhenga vrazhdësia e Shqipërisë së vjetër dhe nga stilet moderne perëndimore qëpo e shkatërrojnë atë. Personazh kryesor është Mark Gurabardhi, një piktor i ri i admiruarqë jeton në një qytet verior. Ai varet nga një qendër arti, që frekuentohet ngainteligjenca lokale dhe vizitorët nga Evropa Perëndimore, dhe që udhëhiqetnga një drejtor i cili kthehet nga një udhëtim jashtë vendit i veshur me njëkëmishë ku shkruan “Boss”.Marku e ka një të dashur joshëse që shkon nëudhëtime tregtare në Tiranë në kërkime shpresëdhënëse të modës perëndimore.Diktatura dhe pasardhësit e saj të menjëhershëm kanë shkuar me kohë dhe janëzëvendësuar nga konfuzioni i korruptimit, politika e pistë dhe shumë parregullsipërreth.Shoqatat e homoseksualëve janë gati për t’u legalizuar, një ShoqatëPost–pesimiste lulëzon dhe një grup universiteti planifikon të protestojë nënparullën “Poshtë populli”.Por e gjithë kjo rrëmujë, të them të vërtetën, disi e thjeshtë ështëëparaqitur pothuajse si një skelet. Kjo të bën të besosh se sikur e kaluara –jovetëm diktatura e Hohxhës, por edhe gjakmarrja dhe njerimi i shekujve të kaluar–kishte ëndërruar të tashmen dhe ishte koha tani të zgjoheshin. Midis kapitujshqë kanë të bëjnë me jetën e sotme Kadare ka futur kundërkapitujt e mbushur melegjenda, halucinacione dhe fantazi. Jo vetëm që këto të duken më reale se sa eta–

shmja, por që ato të fillojnë ta filtrojnë atë. Kundërkapitulli kryesor dhe çelësi i librit është legjenda e një nuse, familja e së cilës e detyron atë të martohet me një gjarpër për të paguar një borxhtë gjakut. Dhëndri arrin në një shportë, të ftuarit klithin dhe askush nuk vjen. Nusja duket shumë e lumtur. Gjarpri, në fakt, kthehet në një princ për tetë orëçdo natë. Përfundimisht, e interesuar për ta pasur më gjatë, nusja hedh lëkurëne gjarpërit në zjarr derisa ai fle. Duke u zgjuar, princi vyshket. Ai nuk ka ku tëshkojë, dy të tretat e identitetit të tij janë shkatërruar. Ky është identiteti shqiptar, i shformuar nga historia, që Kadare ka për synim. Dhe kështu, nëpërmjet kapitullit dhe kundërkapitullit, jeta e dyfishtë e princit—gjarpër shtrihet mes aktualitetit dhe mallkimit nga e kaluara. E dashura e Markut, e shqetësuar, raporton se një xhaxha i vjetër e ka urdhëruar që borxhi i gjakut që i detyrohet familjes së tyre, Ukajve, të merret ndaj armikut të saj, Shkreli. Drejtori i qendrës së artit është qëlluar. Hallka evjetër stërgjyshore bërtet: "Angjelini i Ukajve"—vëllai i të dashurës—"ka vranë Marianin e Shkrelëve". Ashtu si motra e tij dhe Marku, Angjelini kishte menduar për veten si një person modern, në rastin e tij. Duke qenë një radikal, ai kishte planifikuar për t'ubërë një terrorist i kohës, ashtu siç bën edhe Marku, i cili në kundërkapituj, dhënë pas në kapitujt e vet, e humbet artin për t'u bërë polic, siç kishin dëshiruar prindërit e tij që ai të bëhej në kohën e Hoxhës. Kadare është më afër Sviftit se Kafkës; ai godet saktë dhe në të gjithaanët. Qëndrimi i tij është më pak i sigurt se ç'ka qenë, edhe pse, ai shkruan më shkëlqyeshëm, kur projekton të ardhmen nga e kaluara dhe jo të kaluarën nga e tashmja. Madhështia e tij shfaqet më mirë në alegori se në satirë. Tek *Lulet e ftohta të marsit*, kemi rindërtimin e mitit të gjarpërit, veshjen e shtresëzimeve sociale, psikologjike, histori-

ke; kemi një mit të rindërtuar me fantazinë më të ndezur në formën e një tregimi që mund të qëndrojë dhe më vete. Kurreshtja e lexuesit ngacmohet tepër, pasi përveç paraqitjes të një çmendurie, siç ishte martesë me gjarprin (Lajmi për kru-shqinë e përçudur e shkalafiti mesin e tetorit më fort se era e veriut...), pranëvënia e të kundërtave, përdorimi i paradoksit shkaktojnë moskuptimin, mosshpjegimin, habinë e madhe. Nusja pret kafshimin fatal në mesnatë, vdekjen e saj. Kjo nuk ndodh. Nusja sa vende zbukurohej. Jo vetëm sytë, por gjithë trupi i saj e jepte ngazëllimin... s'mbetej veç një ditë t'i thoshte të atit: të falem, zoti atë për këtë martesë.²⁹

Pastaj Marku kthehet te territori familjar për Kadarenë, ai i mitit dhe krimtë, eventualisht duke u kthyer në figurën e Edipit, paradigma e krimtë politik.

Të njëjtën ditë që tirani mori kurorën, këto krime janë transferuar nga e ardhmja, nga ajo që ende duhet të ndodhi, te e kaluara, te caku më i largët, deri te streha më e sigurt, barku i nënës. Në kërkimin e tij për të pajtuar të kaluarën dhe të ardhmen, Marku sheh mitin dhe realitetin të zihen nën vete, dhe ai nuk është në gjendje të lirojë veten nga frikat e tij të mbetura. Në skenën finale, ai e gjen veten bashkë me shefin e policisë, në pritje të një bande bankëvjedhësish që të hyjë në arkivin e fshehur thellë. Por teksa ata presin, shefin e policisë e zë gjuni dhe Mark Gurabardhi sheh një tjetër lloj bande që të qaset: tiranët e bllokut lindor—Enver Hoxha, Ëalter Ulbricht dhe Leonid Brezhnev. Udhëheqësit, dikur shumë të vërtetë, por tani prej shumë kohësh të vdekur, ndiqen nga Mbreti i verbër dhe i pafuqishëm Edipi, duke bërë për nga arkiva për t'u përballur me krimet e tyre bastarde, mitike dhe reale, thashetheme dhe të vërteta.

²⁹Kadare, I., *Vepra e plotë*, Vëllimi 15, Onufri, Tiranë, 2009, f. 297

Miti iluminon labirintet ku gjejnë veten, por nuk ofron një mënyrë për të dalë prej andej. Për Kadarenë një letërsi tranzicioni trazon hirin e të shkuarës, por sfilitet për të bërë më shumë se dritëdhije mbi trashigiminë tonë të pasur kulturore.

ARBEN SULEJMANI,

Fakulteti Filozofik, USHT – Tetovë

TEQEJA BEKTASHIANE HARABATI BABA, NDËR MË E VJETRA TRASHËGIMI NGA EKZISTUESET DERI MË SOT

Një rol të madh në Rilindjen Kombëtare shqiptare do të luaj Teqeja Harabati e Tetovës. Në lokalet e këtij tempulli të shenjtë islam, përveç 40 dervishëve dhe Baballarëve klerikë dikur numër të përhershëm, në këtë vatër kombëtare kanë qëndruar patriotë të shquar të cilët gjatë bisedave kanë frymëzuar njëri-tjetrin. Aty ishte vendosur shtabi i Kryengritjes së Dervish Carës 1843–44, dhe prej aty në realitet, filloi të bëhet e organizuar kjo kryengritje të cilës iu bashkëngjitën edhe shumë klerikë bektashianë, të cilët kontribuan në çlirimin e mjaft vendeve (qyteteve) në trevat lindore e shqiptare, si: Gostivari, Tetova, Shkupi, Kumanova, Presheva, si dhe Leskovci etj. Ndoshta edhe emri i udhëheqësit të kryengritjes nuk ishte i rastësishëm.

Klerikët e kësaj Teqeje, rol të madh luajtën edhe në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878–1881) dhe në Lidhjen Shqiptare të Pejës (1899). Kështu që, në mes tjerash, disa dervishë të këtij tempulli ndër më të shenjtët në Ballkan, kishin shkuar në Frashër të Shqipërisë, në 1878 Baba Alushi u ka thënë se nuk do të kishte kuptim që Lidhja Shqiptare të vendoset në Frashër dhe se ajo duhet të vendosur në Prizren shkaku i pozitës gjeografike si dhe demografia e tarikatit ishte e lart rreth Pri-

zrenit³⁰. Pra në Frashër ishte vendosur Shtabi i Lidhjes së Prizrenit, që në fillimet e saj. Ndër figurat (personalitetet) më të shquara e më kryesore nga trevat lindore shqiptare në Lidhjen e Prizrenit ishte Iljaz Pashë Dibra, kryetar i parë i saj, i cili mësimet e para i kishte marrë pikërisht në Harabati Baba, në Teqenë e Tetovës. Me këtë Teqe është lidhur edhe emri i Dervishë Himës nga Struga, kolosi i Rilindjes Kombëtare në dekadat e para të shek. XX. Si dervish dhe si i tillë vizitonte teqetë bektashiane, i frymëzuar me ide kombëtare gjente mbështetje dhe siguri tek baballarët, prej teqeje në teqe merrte dhe jepte njohuri pastaj shpërndante Abetaret shqipe dhe frymën patriotike kombëtare nëpër trevat e banuara me shqiptarë.

SERSEM ALI DEDE³¹. Ashtu siç thonë në shkrimet e veta shumë studiues për prejardhjen e tije të Tetovari, si dhe lidhjen e tij me Sulltan Sulejmani— Kanuni ose Ligjdhënësi, Sersem shqiptari i vëllai i gruas së parë Sulltan Mahidevran³². Pas një kohe të gjatë në detyra të rëndësishme, në një kohë arrin edhe titullin vezir dhe të mëkëmbësit të Sulltanit. Shqetësimet për motrën dhe posaçërisht likuidimi i Princ Mehmedit³³ që ishte i nipi i Sersemit³⁴ ngjarja vajtohet edhe nga poet të atëhershëm. Veçojmë këtu Jahja Bej Dukagjini (Taslixheli siç e quajnë turqit)³⁵— që ishte me origjinë shqiptare. Pas një kohe në shenjë pakënaqësie dhe revolti do ta çojnë të kërkoj

³⁰ Haxhi Dede Reshat Bardhi, intervistë dhënë në teqenë Harabati 28 mars 2006, Tetovë.

³¹ Vishko, Ali. Teqeja Harabati e Tetovës dhe roli i saj historik e Kulturor në të Kaluarën, Tetovë 2005, Faq. 21.

³² Bedri Noyan

³³ Samrxhiç. Radovan, Sulejman i Rokselana. Beograd 1976. Faq. 543, 663.

³⁴ Vishko, Ali. Teqeja Harabati e Tetovës dhe roli i saj historik e Kulturor në të Kaluarën, Tetovë 2005. Faq. 23.

³⁵ Samrxhiç. Radovan, Sulejman i Rokselana. Beograd 1976. Faq. 664.

të tërhiqet nga poste të larta të perandorisë, duke u dorëzuar si dervish në Pirevin³⁶ e Hynqar Haxhi Bektash Veliut. Në këtë derë të zotit dhe drejtësisë e mistikës Islame, Sersemi i pajisur me virtyte të larta morale e intelektuale iu dorëzua kryegjyshit të atëhershëm Ballëm Sulltanit³⁷ (pirit të dytë të bektashizmit), ky udhërrëfyes do ta orientoj dhe do ti tregoj udhën e dritës së Bektashizmit. Më pas do të kaloj një kohë në Teqenë e Dimotekës nga ku me 15 dervish³⁸ do drejtohet drejt vendlindjes dhe rrëzë malit të Sharrit do të ndez kandilin e Hynqar Haxhi Bektash Veliut dhe udhës së lavdishme të tij . Ai u bë një mistik i njohur i kohës, filozof e poet. Krijimtaria letrare, filozofike, fetare, arti e tjera të Sersem Ali Dede (Baba)³⁹ e të tjerë lanë gjurmë. Nga tyrbja e vogël e atëhershme që u themelua më 1538 sot do ta gjejmë si një Godinë komplekse arkitektonike e teqesë, imponante dhe madhështore e cila përbën një margaritar të thesarit të kulturës shqiptare dhe botërore. Ajo përbëhet nga shumë objekte të kompleksit të saj: faltorja – Kubbeli Mejdani, (ruhet sot vetëm paradhoma me dy mbishkrimet dhe mejdani pjesërisht); Shtëpia ose Konaku veror ku rrinin klerikët, dhoma e pritjes (Selamllëku), Qoshku veror dhe shatërvani i teqesë, Shtëpia dimërore me objekte të tjera: faltorja e vogël, Mejdani, tyrbja, Lavanderia,

³⁶ Qendra ku është themelua Teqeja e parë nga vet Hynqar Hynqar Haxhi Bektash Veliu u, u kthye muze që nga 1924 dhe vazhdon të jetë muze edhe sot e kësaj dite.

³⁷ Në historinë bektashiane njihet si udhëheqës i rëndësishëm sepse ai vuri si rregull atë që Haxhi Veli Bekatshi vu në themele të këtij Tarikati, institucionalizimin dhe celibatin.

³⁸ Vishko, Ali. Teqeja Harabati e Tetovës dhe roli i saj historik e Kulturor në të Kaluarën , Tetovë 2005. Faq. 25.

³⁹ I varrosur në brendinë e tyrbes në teqenë Harabati zakonisht themeluesit kanë vendin qendror, i njëjti ka mezar edhe në Hynqar Hynqar Haxhi Bektash Veliu u.

Kuzhina e vogël, Kabri i baba Mehmet Harabatit, Shtëpia e punëtorëve, Kuzhina e Teqesë (Restoranti i teqesë), Furra e teqesë, Hambarët e teqesë, Bodrumi i teqesë, Hajate bagëtish, Çezma e madhe, Çezma e vogël, Varrezat e teqesë, Kulla e rojeve mbi hyrjen kryesore. Teqeja ka katër porta të cilat simbolizojnë elementë nga doktrina bektashiane⁴⁰. Kompleksi madhështor i kësaj teqeje me objektet e ndërtuara janë integruar në një tërësi unike e plotësojnë njëri – tjetrin me veçoritë e veta portat, oxhaqet, kulmet, shtyllat katërkatëshe, korloriti i pasur i fasadave, pikturat murale, mbishkrimet e shumta, në oborrin e teqesë është gjelbërimi i pafund, harmonia në kompozimin e detajeve dhe shumë cilësi të tjera që janë me vlera të jashtëzakonshme, të cilat herë – herë paraqesin dhe simbole që kanë të bëjnë me elementë të doktrinës dhe kompletimin.

3. 2. *ROLI I KLERIT BEKTSHIAN NE TREVAT LINDORE SHQIPTARE*

Ky tarikati Islam u përkrah edhe në trojet lindore shqiptare, ose në trojet e Maqedonisë së sotme, filloi të depërtoj pothuajse menjëherë pas themelimit, ose më së voni në gjysmën e dytë të shek. XIV. Në këtë kohë me themeluesin e këtij tarikati, pati rast të takohet një bari i njohur në historinë bektashiane si Sari Salltëk, pinjollë nga familja e dervishëve dhe Halifeve të Hynqar Haxhi Bektash Veliut⁴¹. Sari Salltëku, u

⁴⁰ Baba Tahir Emini, me thoshte se nga katër anët e botës janë të mirëseardhur gjithë miqtë e zemrës së mirë, dhe se zoti është në gjithë anët e botës, gjatë bisedave në Harabati baba viteve të 90-ta.

⁴¹ Arben Sulejmani. KËRKIME HISTORIKE 4, Ndikimi i filozofisë bektashiane në zhvillimin e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore të kombit tonë, Shkup, 2011, faq.265

mahnit tepër me thjeshtësinë dhe dashurinë, pastaj fuqia e tij që ia ndriti zgjuarsinë dhe filozofinë e bashkëbiseduesit të tij, prandaj dhe me dëshirë të madhe që pajtuar me propozimin e Hynqar Haxhi Bektash Veliut që të bëhej dervish e pastaj të vinte në Ballkan, për të përhapur tarikatën bektashian. Kështu nga fillimi i shek XIV e në mbarim të shek. XIV, Sari Salltëku veproi shtat vende të Gadishullit Ballkanik, e në këtë kuadër edhe shumë qytete shqiptare në trevat lindore, si: Manastirin, Shkupin, Ohrin, Krujën, etj. Në Manastirin e Shën Naumit, karshi Pogradecit, edhe sot e kësaj dite lakohet emri i Sari Salltëkut i njohur në historinë si Spiridoni i shenjtë.

Studiuesi Edwin Jacques ka theksuar se dervishët bektashinj "udhëtuan nëpër Shqipëri nga fshati në fshat, nga veriu në jug, duke shpërndarë libra për rilindjen e Shqipërisë. Teqetë e tyre u bënë shkolla kombëtare, ku predikohej "Qerbeleja", për-kthyer si poezi e gjallë nga njëri prej poetëve të tyre të padekshëm, Naim bej Frashëri ⁴².

Bektashianët duan çdo popull si shqiptarin e vet, por më tepër duan mëmëdhenë dhe mëmëdhetarët—shkruan poeti i madh i Rilindjes, Naim Frashëri, dhe këtë e arsyeton në këtë mënyrë: "Gjithë njerëzit që janë, vëllezër janë të tërë, një mëmëdhe, një atë kanë, nga një baltë janë bërë.

Bektashizmi i lidhur me shqiptarizmin, ka një kontribut themelor në lirinë e pavarësinë e Shqipërisë, sepse bektashianët kanë qenë atdhetarë nga më të shquarit në të Gjithë kohëra. Mësimi e tyre universal me parime shumë të larta morale i ka bërë ata që të jenë shumë të qartë dhe të mrekullueshëm në luftën për të ringjallur dhe për të ndriçuar mendërisht e shpirtërisht Shqipërinë. Bektashianët krijojnë rrugë bashkimi për të tërë shqiptarët që kanë mendërisht e shpirtërisht a—

⁴² E. Jacques, *Shqiptarët*, 1995, f. 319.

tdheun, Gjithëashtu për të tërë shqiptarët që kanë fe (religjione) të ndryshme⁴³, nga ana tjetër janë komuniteti fetar që krijon lidhjet me gjithë fetë tjera, pa asnjë paragjykim në mënyrë të barabartë me besimin tek Zoti për të gjithë fetë e tjera të njerëzimit. "Baballarët dhe klerikët bektashianë bashkëpunuan ngushtë me shoqëritë atdhetare kulturore të diasporës për të marrë që andej abetare dhe libra shqip dhe për t'i shpërndarë ato nëpër trevat etnike shqiptare"⁴⁴.

Bektashinjtë shqiptarë dhe institucionet fetare bektashiane, (teqetë) kanë dhënë kontribute të mëdha në jetën shpirtërore të shqiptarëve dhe në proceset e zhvillimeve politike, shoqërore e sidomos kulturore në rrjedhat e historisë sonë kombëtare. Qëndrimi i tyre u përcaktua nga përvetësimi, dhe zbatimi me rigorozitet i mësimëve universale të filozofisë së Hynqar Haxhi Bektash Veliut, në themel të të cilës qëndrojnë idetë e përsosmërisë, të pastërtisë morale, parimi i dashurisë për atdheun, i dashurisë dhe i respektit për njeriun, i mirësisë i respektit për dituritë dhe i domosdoshmërisë së përvetësimit të tyre, idetë e vëllazërimit universal, pages, maturisë e urtësisë, thjeshtësisë, për durim e tolerancë, për mirëkuptim, bashkëpunim e harmoni, me tipare iluministe, me karakter human, me përmbajtje sociale që kanë të bëjnë direkt me jetën e zhvillimin e popujve. Jo vetëm bektashinjtë shqiptarë, por tërë shqiptarët gjetën tek këto parime ide që përputheshin me patriotizmin shqiptar, që i frymëzonin ata në aspiratat kombëtare për liri e pavarësi, për gjuhën shqipe, për arsimin e shkrimit shqip si ndër tiparet themelore të identitetit të tyre

⁴³ Arben. Sulejmani, Seminari ndërkombëtar, "Filozofia dhe Shkenca në Kulturën Perëndimore dhe Atë Lindore", Tiranë, 10. 11. 2010.

⁴⁴ Sh. Hysi, *Mision bektashian (Teqeja e Zallit)*, Tiranë, 2004, f. 43.

etnik e kulturor kombëtar dhe për emancipimin kombëtar të shqiptarëve në gjithë hapësirën etnike të tyre.

Stavro Skëndi ka vënë në dukje se shkollat shqipe u hapën fshehurazi nëpër teqetë bektashiane dhe se në "fund të shek. XIX abetaret e para erdhën në Shqipëri, madje mjaft prej tyre u sollën prej bektashinjve të cilët nëpërmjet "kafazeve të urdhrit bektashi, të punësuar në konsullatat e huaja, siguronin botime të ndaluara që u dërgoheshin atyre nga jashtë vendit nën mbulesën e paprekshmërisë së konsullatave"⁴⁵.

Nga këto të dhëna për veprimtarinë e klerikëve bektashinj në të mirë të përhapjes së shkrimit shqip del qartë se ata ishin njerëz të pajisur me kulturë e me ide përparimtare, ishin të ndërgjegjshëm se kështu vinin në jetë dhe zbatonin filozofinë e Hynqar Haxhi Bektash Veliut dhe se në këtë mënyrë i shërbenin kombit, mbronin, zhvillonin dhe forconin identitetin dhe individualitetin kulturor të tij. Me sakrifica është bektashizmi, por nuk dorëzohet i betuari i Hynqar Haxhi Bektash Veliut Haxhi Muhamet Babaj, të cilit në teqenë ku shërbente iu gjetën libra dhe dorëshkrime shqipe, u dënua prej gjyqit të Janinës⁴⁶.

Faktet e mësipërme dëshmojnë se edhe bektashinjtë shqiptarë, duke ndjekur dhe zbatuar mesazhet e filozofisë së Hynqar Haxhi Bektash Veliut si dhe pranimin e mendimeve të ndryshme nga i veti, kanë dhënë, siç ka theksuar Ismail Kadare, "kontribute të fuqishme në gjithë rrugëtimin e popullit shqiptar drejt lirisë dhe emancipimit"⁴⁷.

⁴⁵ S. Skëndi, *Zgjimi Kombëtar i Shqiptarëve*, Tiranë, 2000, f. 137.

⁴⁶ Revista "Urtësia", 2005, nr. 48, f. 35.

⁴⁷ I. Kadare, *Ektremistët islamë dhe qarqet greke rrezikojnë tolerancën*, "Gazeta Shqiptare", 15 nëntor 2003.

Baba Fejza (Sheh Bulqiza), i cili për çështjen kombëtare mbannte lidhje dhe bashkëpunonte me 72 teqe të shtrira në trojet shqiptare, kërkoi të hapej një shkollë në gjuhën amtare ⁴⁸.

Kontributin e bektashinjve në jetën shpirtërore të shqiptarëve gjatë historisë sonë kombëtare gjithëashtu e ka vlerësuar dhe e ka pasqyruar historiografia shqiptare. Ndikimi i bektashinjve në zhvillimet politiko-shoqërore kombëtare të popullit tonë është përcaktuar nga parimet e sistemit të tyre mistik dhe nga mesazhet që u kanë përcjell breznive mësimet universale të Hynqar Haxhi Bektash Veliut, në themel të të cilave qëndrojnë idetë e përsosmërisë, të barazisë, të pastërtisë morale, i mirësisë, i respektit për dituritë, i vëllazërimit universal, i paqes etj. Mësimet e filozofisë së Hynqar Haxhi Bektash Veliut dhe parimet e moralit bektashian që rrjedhin prej tyre për një jetë të thjeshtë, për një veprimtari praktike mirëbërëse të dobishme dhe në interes të komunitetit, për respektin për tjetrin kushdo qoftë ai, për maturi e urtësi, për durim e tolerancë, për mirëkuptim, bashkëpunim e harmoni, për rolin dhe funksionin e dijeve e si rrjedhojë edhe për domosdoshmërinë e përvetësimit të tyre, si kusht për përparimin e njerëzimit etj., janë parime të natyrës demokratike, me tipare iluministe, me karakter human, me përmbajtje sociale dhe kanë të bëjnë drejtpërdrejt me jetën e popujve. Në parimet dhe mesazhet që u transmetojnë brezave mësimet e Hynqar Haxhi Bektash Veliut, shqiptarët gjetën ato ide që përputheshin me nevojën shqiptare, që i frymëzonin ata në aspiratat kombëtare për liri e pavarësi, në dashurinë për gjuhën shqipe si një ndër tiparet themelore të identitetit të tyre kombëtar, për arsimin e shkri-min shqip, të cilat ishin dhe kërkesat themelore të lëvizjes për

⁴⁸ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi 270, dos. 51, fl. 29-30.

emancipimin e tyre kombëtar. Shtrirje të gjerë të veprimtarisë bektashiane e të ideve të saj në trojet, në një periudhë të gjatë kohore dhe në gjithë hapësirën etnike shqiptare në fushën e gjuhës shqipe e të dijes, në atë të lëvizjeve politike kombëtare, në fushën sociale etj.

Ky aspekt i veprimtarisë së bektashinjve rridhte nga natyra humane e doktrinës së tyre, nga prija e tyre për përparimin në përgjithësi. Kontributi i bektashinjve në këtë fushë kishte të bënte jo vetëm me përparimin e kulturës shqiptare, por ai ishte gjithëashtu një përpjekje për mbrojtjen, afirmimin dhe lartësimin e identitetit dhe të individualitetit kombëtar shqiptar. Përpjekja e vëllezërve Frashëri për dijen, kulturën, gjuhën dhe gjithë dukuritë e lidhura me këto t'i hapin popullit rrugën drejt qëllimit, merrte dritë nga Baba Alushi. Iluminizmi ka qenë një nga tiparet themelore të rilindësve tanë. Mu këtu u bashkuan edhe liderët fetarë klerikalë bektashianë të formuar dhe të mbujtur me mesazhet filozofike të Hynqar Haxhi Bektash Veliut për dijen, dituritë dhe rolin e tyre në proceset historiko-shoqërore të popujve. Në mendimin e tyre çështja e përhapjes së dijes, të shkollës, të arsimit dhe të gjuhës shqipe shihej dhe vlerësohej sipas koncepteve që kishte pasur për to iluminizmi evropian, i lindur dhe i zhvilluar para Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Baballarët bektashian u bënë gjithëashtu nismëtarë për shndërrimin e institucioneve fetare bektashiane e të teqeve të tyre në vatra të lëvizjes kombëtare shqiptare dhe të mësimi të gjuhës dhe shkrimit shqip.

3. 3. *TEQEJA HARABATI*⁴⁹

Në gjysmën e parë të shekullit XVI, vë vitet 1538–1548 në Tetovë ngrehet Teqeja Harabati nga Sersem Ali Dede (Baba), qendër fetare, kulturore e arsimore e dëgjuar në shumë anë. Pranë godinave fetare islame, përpos shkollave, siç ishin mektebet, medreset etj.

Mirëbërësit e atëhershëm me ndihma të shumta dhe të ndryshme ndihmuan që edhe në kompleksin e Teqesë Harabati të themelohet që me kohë një bibliotekë, e pasur dhe shumë e dëgjuar, e cila veproi në shekujt e kaluar, deri nga fillimi i shekullit të XX.

Në atë kohë nga bibliotekat, si më e pasura veçohej e mirë njohura “biblioteka e Teqesë Harabati” aty veçojmë një antologji e përbërë prej pesë përmbledhjeve poezish nga Tetovari Sersem Ali Dede, një Baba Bektashian, vezir, filozof, teolog e poet i dëgjuar i kohës.

Librat e shtypur, të kopjuar dhe dorëshkrime të kësaj biblioteke, të krijuesve të ndryshëm: pers, shqiptarë, turk, arab, ajzerbexhanas, e të tjerë shkencëtarë, filozofë, letrarë, teologë etj.

Libra nga sfera e më shumë lëmive si: astronomia, kozmografia, jurisipodenca, mjekësia, historia, etika, morali, etj

Veprat letrare si :

⁴⁹ Sulltan Mahmuti do të mbahet në mend si i pashpirtë, do të emërohet edhe si Sulltan i krimeve mbi bektashinjtë dhe jeniçerët, pasardhësi i tij Sulltan Abdyl Mexhidi i cili më 3 nëntor 1839 shpalli “Hatti-Sherif-i Gjylhanes”(Dekretin e shenjtë të trëndafilave) ose Dekreti i Tanzimatit ku moto kishte “do të regullonte jetën” ndërsa ai qëllimin e kishte “si të zhdukte pushtetin lokal”, Kjo situatë e re në Maqedoni me Qeveritë e ndzshme sikur gjason me të kaluarën e lashtë të shqiptarëve, dhe kjo nuk befason bektashianët, por duhej të punohet sa më shpejtë në teren prandaj edhe Babai jepte dhe pranonte mendime me njëri-tjetër të mençur, bënin plane nga se ishin në të njëjtën botë, njashu edhe bota shpirtërore pasurohej kurgeshetoheshim mendimet.

Përmbajtje të poezisë së divaneve, gazeleve, kasideve, nefeseve, tregimeve, të shkrimtarëve të mëdhenj të Orientit poezitë e tregimet e të cilëve janë margaritar të letërsisë botërore.

Sufistët e njohur: Omar Khajami, Saadi-u, Firdusi-u, Baki-u, Hafiz Shirazi-u, Muedin Arabi-u etj.

Një numër i madh i librave i takonin teologjisë pra edhe nga kjo lëmi sepse edhe vetë biblioteka i takonte një institucioni fetar. Duke pas parasysh se Teqeja Harabati është kompleksi numër dy në botë, pra një numër i madh i dervishëve vinin të ngrenë nivelin e njohurisë dhe gradën shpirtërore dhe se kua-dri Bektashian ishte Elita e Islamit. Këtu merrnin njohuri rreth Sheriatit, Tarikatit, Hakikatit dhe Marifetit.

Kjo bibliotekë dispononte edhe me dorëshkrime të shekullit XV, siç ishte dorëshkrimi i Mehmed Alemdarit i vitit 891 h(1486 vj.)

Në këtë bibliotekë përveç Titullarit “Gjyshit” dhe personelit të brendshëm, një numër i caktuar i Baballarëve(më shumë se një Baba), 40 dervishëve dhe të tjerëve që shërbenin në teqenë Harabati, librat i ç’fletonin mysafirët dhe njerëz nga jashtë, dashamirë të kulturës dhe intelektualë etj.

Rëndësia e bibliotekës së Teqesë Harabati kishte të bëj për rolin e saj si pjesë përbërëse e kompleksit kulturo-arsimor duke bërë kopjimit në sistem dhe riprodhimin e veprave të rralla.

–siguronte marrëdhënie me bibliotekat tjera, me ato të vendit Tetovë e Gostivar ashtu edhe me ato të vendeve tjera, duke bërë huazimin dhe kopjimin e tyre.

–pasurimin e vazhdueshëm me vepra të rralla dhe të vjetra inkunabile.

–depozitimin e dorëshkrimeve dhe relikteve të ndryshme të autorëve të ndryshëm etj.

Kopjimi i veprave aty bëhej me kaligrafi të zgjedhura nga ana e klerikëve të Teqesë Harabati, nga mjeshtër të ndryshëm prej Manastiri e Sarajeva. Mësonin nxënës që përgatiteshin për postin e Baba-it që do të udhëhiqnin Teqetë ku do t'u caktohej nga kleri urdhërues.

Aty ata mësonin edhe vizatime dhe shkrime murale dhe përpunimin e drurit.

Në vendin HARABATI ka vepruar shkolla fillore Private, pranuar nga shteti më 1307 h. (1889/1890 vj.) me shpenzime vjetore 600 grosh.

Një shkollë fillore shtetërore kishte edhe në lagjen Teqe quajtur “teqe mahalesi, me shpenzime vjetore 7.650 grosh. Sipas të dhënave nga Salnameja perandorake e Arsimit për vitin 1317 h.(1899/1900 vj.)⁵⁰. Më 1796 mbi mbeturinat e kështjellës Ilire u rindërtua teqeja Ball-li Baba ndërsa qendra e mirënjohur e kultit islam të tarikatit bektashian dhe vatër e kulturës dhe arsimit të kësaj ane Teqeja Harabati u meremetua, u përmirësuan dhe u zgjeruan pasuritë e saj. Sipas shënimeve të udhëpërshkruesit frëng-Ani Bue, i cili në atë kohë e kishte vizituar Tetovën, Abdurahman Pasha paska edhe konak veror ku edhe e paska pritur A. Boue. Sa dihet konaku veror i Abdurahman Pashës ishte një ndërtesë brenda kompleksit të Teqesë Harabatie, cila ishte godina ose objekti shtëpia verore”⁵¹.

Rrugëpërshkruesi dhe studjuesi gjerman Doktor Grisebech profesor në universitetin e Geutigenit, në vitin 1839 vizitoi residençen e shqiptareve Abdurahman Pashës dhe Hevzi Pashës⁵². **Doktor Grisebech** thotë se ka parë vetëm një femër në

⁵⁰ Devlet Maarif Salnamesi, 1317 h.”1899/1900 vj.) f.1330-1 350/

⁵¹ Ali Vishko-Harabati Baba Teqe, f.38/

⁵²/DITURIA, Revistë për shkencë e Mithat Frashërit, nr.12 vëll.III, Tiranë 1928, f.388, 389./

disa ditë të qëndrimit të tij në Tetovë, e kjo ishte e bija e Pa-shait që e solli për këqyrje mjekësore, kjo do të thotë se edhe doktor Grisebech ka qëndruar në teqenë Harabati Baba duke thënë se shqiptarët kanë psikologji të veçantë, krenarinë, guximin dhe janë shumë të sjellshëm me Evropianët, mikpritja është në një shkallë të lartë, aty doemos do të therrnin mishra (kurban) dhe servonin 6 deri në 8 gjellë të orientit të tëra të gatuar me një cilësi të lartë e të shijshme. Përgatitja e gjithë këtyre gjellëve, thotë Grisebech nuk qëndron larg kuzhinës Vijeneze. Ishte pyetur evropiani se si mund të bëhet një rrugë me që shafi i këtij vendi është i preokupuar si të bëj rrugën që të lidhet Tetova me Prizrenin. Ky vend kishte edhe mollë me emrin e shqiptarit “arnaut almasi”, që tregoheshin në Perandorinë Osmane e që vlerësoheshin në mënyrë të veçantë—si fruta tepër fisnike.

Teqenë Harabati dhe tre teqe tjera na i përmend edhe mësuesi bulgar—Andrea Stojanovi në shënimet e veta që i botoi në gazetën e Stambollit “novinii” n zv.1891–1892, “Shënimet nga udhëtimet e mia në Tetovë”.

Qyteti në atë kohë ka pasur katër teqe, dhe njëra nga Teqetë ka qenë shumë e pasur (e ka fjalën për Teqenë Harabati Baba).

3. 4. VEPRIMTARIJA FETARE E KULTURO— ARSIMORE NË TEQENË HARABATI NË TË KALUARËN

Adekuatë rrethanave të volitshme të kohës, ne Teqenë Harabati të Tetovës u zhvillua dhe një veprimtari e dukshme fetare, kulturo—arsimore etj, që nga shekulli XVI e peri ne shekullin XX.

Si kurore e veprimtarisë nga sferat e fesë, arsimit, diturisë, letërsisë e të tjera të klerikëve e të tjerë që jetuan,vepruan e

krijuan në teqenë Harabati, mes tjerash, janë veprat e tyre dhe mbishkrimet që ata kanë lënë të kaligrafuara nëpër muret dhe te skalitura e të gdhendura nëpër gurët e stallave, te mureve, te çeshmeve, fontanave, në portat e tavanit, të Qoshkut Veror të Teqesë e të tjera Ato janë shkrime brilante me përmbajtje religjioze filozofike, historike, letrare, didaktike, moralizuese e të tjera. Këto shkrime me vlerat e veta të veçanta kulturore historike, letrare e të tjera janë margaritarë të thesarit të popullsisë së kësaj aneje, më gjerë.

Teqeja Harabati si seli e njohur për përgatitjen e kuadrit të klerikëve bektashian që të shërbejnë në teqetë tjera bektashiane, pranë vetes kishte edhe një medrese, për plotësimin e nevojave arsimore për popullsinë e kësaj ane. Si një shkollë e dëgjuar, të cilët aty paiseshin edhe me njohuri nga më shumë sfera – nga dituritë, feja, letërsia etj. Teqenë e vizitonin edhe zyrtarë të lartë, diplomatë, udhëpërshkrues, intelektualë të shquar e tjerë.

Një numër i konsiderueshëm të shërbyesve, klerikëve etj. në këtë teqe janë marrë dhe me letërsi. Këta krijues nga sfera e letërsisë që të takojnë drejtimeve letrare të Lindjes, kanë shkruar e na kanë lënë përmbledhje poezish të quajtura D–I–V–A–N–E, poezi të bukura të odeve të quajtura gazele, vargje poezish të kasideve, nefeseve e të tjera lloje të bukura. Në vëllimin letrar të këtyre krijuesve të shquar kemi tentime për humanizëm, tolerancë, fisnikëri, dashuri njerëzore e hyjnore, me qëllim të krijimit të njeriut si genie universale.

Veprat e krijimtarisë filozofike–mistike, shkencore, letrare, fetare e të tjera të krijuesve të kësaj teqeje, të këtij vendi, siç ishin muidi i Tetovës, tetovari Serem Ali Dede, dervish Turabiu, anonimi i Tetovës, Muhamed Mehdi Baba, Mehmet

Aqifi e tjerë janë margaritarë të kulturës së shqiptarëve e të popujve të tjerë të kësaj ane.

3. 5. ROLI KULTURO–ARSIMOR DHE RËNDËSIA HISTORIKE E TEQESË HARABATI

Nisur nga veprimtaria krijuese, nga tentimet imediate e të tjera të krijuesve të Teqesë Harabati, kjo teqe në të kaluarën luajti rol me rëndësi të veçantë kulturo–arsimor.

Teqeja Harabati duke qenë seli e njohur islame bektashiane për viset perëndimore të Ballkanit dhe qendër gjyshate, bren–da një periudhe të gjatë prej disa shekujsh arriti të përgatiste intelektualë të shquar jo vetëm për këtë regjion,por dhe më gjerë. Kjo teqe duke qenë shkollë e njohur për këto anë të Siujdhesës Ballkanike, ndjekësit e vizituesit këtu mësonin e njiheshin, përveç me njohuri të thjeshta teologjike islame dhe me dituri edhe nga sfera të tjera si

– filozofia, linguistika, letërsia, shkenca e tjer

Në Teqenë Harabati brenda pesë shekujve kanë shërbyer, vepruar e krijuar klerikë bektashian e intelektualë të penës – teolog, filozofë , letrarë e tjerë. Një plejadë krijuesish, krijim–taria e të cilëve janë ruajtur nëpër fletoret bektashiane të kohës, nëpër mbishkrime muresh të kaligrafuara, të skalitura nëpër dru në ato objekte të kompleksit të teqesë në fjalë etj. Krijimtaria e shkruar letrare, filozofike, shkencore, fetare etj, të krijuesve të përmendur të kësaj teqeje, përveç shqiptarëve, u takon edhe popullatave të tjera të kësaj ane e më gjerë.

Vepra e krijuesve në fjalë e godina grandioze e kompleksit të Teqesë Harabati me elegancën e me veçoritë e saja që e karakterizojnë subtilitetin e një epoke historike, e cila u ngritë në atë kohë në Tetovë , flasin dhe për krijuesit e themeluesit, për bamirësit e humanistët, të cilët me veprat e veta

lënë gjurmë të pashlyeshme jo vetëm në kulturën e popullsisë së kësaj ane, por dhe në atë mbarënjerezore. Nga gjithë kjo kuptohet, se përveç rolit kulturor, Teqeja Harabati ka dhe rëndësi e veçantë historike. Kjo teqe me veprimtarinë e vet brenda një kohe të gjatë ekzistimi në këto hapësira gjeografike i kontribuoi shumë zhvillimit në më shumë sfera të jetës – kulturore, arsimore, fetare etj, si për shqiptarët, ashtu dhe për popullsitë tjera të krahinës së Pollogut, si dhe të vendeve fqinje.

Veprimtaria e shumanshme në Teqenë Harabati, thesaret e lënë nga udhërrëfyesit, shërbyesit e krijuesit që kanë jetuar, vepruar e krijuar aty brenda një periudhe të gjatë, flasin se kjo teqe në shekujt XVI–XX ka luajtur rol të veçantë historik dhe, si e tillë, ka rëndësinë e vet historike, sidomos për historinë e popujve të kësaj ane e më gjerë.

Pas Luftës së Parë Ballkanike, në vitin 1912 serbët pasi e pushtuan Tetovën, me regjistrimin që patën bërë në vend e kishin përfshi dhe Teqenë Harabati, me pasuritë e saja të tundshme e të patundshme. Me atë rast kompetentët e kishin regjistruar edhe fondin e librave të bibliotekës të teqesë që patën mbetur në atë moment. Glisha Elezoviq sekretar i administratës serbe për qarkun e Tetovës kishte numëruar 216 libra⁵³ dhe mes tjerash ka shënuar: “mendoj... se nuk do të jetë pa interes që opinionin e gjerë ta informoj për përmbledhjen e bibliotekës së kësaj teqeje të Tetovës, dëgjuar larg e cila në shekullin XIX njihet si njëra nga Teqetë më të pasura të komunitetit Bekta-shian...”⁵⁴

⁵³ Arkivi i Kosovës, fondi Glisha Elezoviq. Dokument i nënshkruar si sekretar i administratës serbe për qarkun e Tetovës.

⁵⁴ /Milan B. Gavrillović. Bektastvo, "Juzna Srbija", knj. III, br. 29, 1 juli 1923, Skopje, f. 405-408/

Për teqetë dhe prezencën bektashiane flet edhe Evlija Çelebiu gjatë udhëtimit nga Kosova i cili shkruan për teqenë bektashiane të Kaçanikut, për Tyrben Kırklar në Shkup. Për sa i përket Teqesë së Dupnicës, ai thotë se në oborrin e kësaj teqeje ka pas edhe një tyrbe të Hussam Dedes.⁵⁵

3.6. TEQETË BEKTASHIANE NË MAQEDONI

Aktiviteti më i bujshëm i Tarikatit Bektashi në trojet e Maqedonisë së sotme është prezantuar duke filluar prej gjysmës së dytë të shekullit XIV e deri në ditët e sotme. Inkuadrimi i disa udhëheqësve në Tarikatin Bektashi si Rexhep Pasha do ta forcoj pozitën e Babait të Teqesë si dhe në ndërtimin e shumë teqeve dhe zavijeve të reja bektashiane. Të njëjtën dashamirësi do ta tregoj edhe Dr. Xhafer Sulejmani si prefekt i Komunës së Tetovës. Ai do të ndikojë në zhvillimin pa pengesë të aktiviteteve bektashiane si dhe do të bëj të pamundurën që e gjithë pasuria që i takon Harabati Baba's, me një marrëveshje brenda dy drejtimeve të Islamizmit në vakëfin e Tetovës do t'i kthehet prona e uzurpuar, pronarit të vërtetë⁵⁶. Aktivitetin e përbashkët të udhëheqësve vendorë me baballarët bektashi e shohim qartë në Teqenë Harabati Baba në Tetovë. Rexhep Pasha ka ndihmuar në organizimin material ashtu që baballarët anën fetare e kanë pas të lehtë ta udhëheqin, dhe është bërë kjo udhë mistike të jetë sa më e ngritur. Gjithashtu me bamirësitë të Teqesë Harabati Baba dhe kjo teqe në kohën e tyre ka lulëzuar⁵⁷. Mirëpo largimi i disa baballarëve të mëvonshëm bektashi me forcë nga pushtuesit do të ngjallë aversion te po-

⁵⁵ Evlija Çelebi. Putopis, Sarajevo 1967.

⁵⁶ Faksimil nga origjinali, marur nga Arkivi i Teqesë Harabati.

⁵⁷ Ali Vishko, *Harabati Teqe e Tetovës dhe veprimtaria në të në periudhën e kaluar*, f. 35-38.

pullata e gjithëmbarshme islame ndaj këtij (Pushtuesi) dhe kurrresi jo aversion ndaj bektashinjve⁵⁸. Ja si e përshkruan një profesor nga Tetova të kundërtën:

Pushteti Serb tokat që i grabiti me pushtimin e tyre më 1912 vazhdonin ta uzurpojnë dhe mos ua kthejnë pronarëve tokat e tyre. Të përmendet Baba Qazimi pa u përmendur Harabati Baba është e pamundur, edhe nëse flitet për teqenë e Gjakovës.⁵⁹

Baba Qazim Bakalli⁶⁰ i kërkoi Gjyqit të Tetovës, që të urdhëronte fshatarët e Bërvenicës që ose të paguanin tokën e grabitur gjatë kohës së sundimit serb ose t'i kthenin pasurinë Teqesë Harabati Baba.⁶¹

Veprimet e administratës Serbe do të ndikojnë në pakësimin e ithtarëve të këtij tarikati në Tetovë dhe më gjerë (shkruan një studiues) i cili harron të kundërtën reale se edhe disa intelektual e fetar iu vunë në ndihmë sistemit, duke u avancuar në poste dhe tituj shkencor.

Për Teqenë Harabati Baba burimet më të sakta thonë se teqenë e ka themeluar Sersem Ali Dede⁶², ndërsa në kohën e Harabati Babait teqeja është shndërruar në kompleks dhe ka arritur kulmin e zhvillimit të saj, nga tyrbja mu aty në vendin ku është ndezur që nga 1538 kandili i Sersem Ali Dedes⁶³ ku e

⁵⁸ Dhe kurrresi jo largimi nga parimet bazë islame të tarikatit bektashi, siç proponon Metin Izeti.

⁵⁹ Për më gjerë për Teqenë dhe Gjakovës më ka dhënë informacione Baba Mumin Lama Kryetari i Komunitetit Bektashian të Kosovës.

⁶⁰ Vishko, Ali. Teqeja Harabati e Tetovës dhe roli i saj historik e Kulturor në të Kaluarën, Tetovë 2005. Faq. 80.

⁶¹ Vebi Xhemali, Forcat Kombëtare në mbrojtje të Shqipërisë Etnike 1941-1945.

⁶² Sersem Ali Dede ka qenë Tetovar dhe ka shërbyer si vezir në Portën e Lartë në kohën e Sulltan Sulejmanit, Sersemi ka qenë njëkohësisht kunati i tij.

⁶³ Sulltan Sulejmani ka qenë i martuar me motrën e Sersem Ali Dedeut, Mahidevrinin. Me lejen e Sulltanit ai është tërhequr prej detyrës dhe pastaj është

ka themeluar teqenë. Prandaj teqeja përmendet në raste edhe me dy emra: Sersem Ali Dede dhe Harabati Baba, që për fat të keq disa shërbëtorë të sistemeve dhe grupeve të interesit e përdorin emrin Sersem Ali Dede për ti shfrytëzuar projektet dhe pronat e Harabati Babas, që janë me Tapi origjinale prone e Bektashinjve⁶⁴. Është me rëndësi të theksohet se në ngritjen e teqesë Harabati Baba, kontribut të madh kanë dhënë ballarët Mehmet Harabati Baba, Ahmet Baba, Haxhi Emin Baba, Baba Qazimi dhe Baba Tajari në veçanti baba Tahir Emmini duke ia lënë si amanet punët e filluara, Baba Edmondit në ndërkombëtarizimin dhe kthimin e pasurisë së patundshme, ushtrimin e besimit me origjinë tradicionale bektashiane të komunitetit dhe rolit të tyre në durim urtësi në këtë kohë të rëndë në Maqedoni.⁶⁵

veshur si dervish në teqenë kryesore bektashiane në Kirshehir, ku ka arritur deri në postin e Kryegjyshit. Shih: Noyan, B., *po aty*, f. 45.

Profesori ali Vishko e çmonte shumë lartë poezinë dhe mistikën dhe përkushtimin e këtij shenjtori.

Baba Mondi, thot se Sersem Ali Dede bën të qartë frymën bektashiane, me vetë faktin se njëjtë si Piri Hynqar Hynqar Haxhi Bektash Veliu ui la pozitën në pushtet që të bëj shërbim, gjë që pa shërbim nuk mund të jesh bektashi. dmth. Të heqësh dorë nga të mirat materiale, të jesh i drejtë dhe të ngihesh në shkallë më të lartë shpirtërore, sakrifica fillon nga vetja dhe duhet udhëtuar si vetë udhëheqësi shpirtëror.

⁶⁴ Original Tapi e Pronës së Teqesë Harabati Baba, Tapitë shpëtuan pa u djegur, më 12 dhjetor 2011, kur iu vu flaka për herë të tretë që nga

⁶⁵ Duke u bazuar në dorëshkrimet e Baba Qazim Bakallit, Prof. Ali Vishko në monografinë e tij për Teqenë Harabati. Shih: *Harabati Teqe e Tetovës dhe veprimtaria në të në periudhën e kaluar*, f. 35-38. Si dhe Baba Tahiri dhe Baba Mondi që kam qenë pran tyre përkëtoçështje.

SEFER TAHIRI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore
të Shqiptarëve—Shkup*

PROJEKTI SHKUPI 2014 MIDIS POLITIKËS DHE KULTURËS

Shkupi, kryeqyteti i Maqedonisë viteve të fundit ka fituar panje të re, imazh që dallon nga ai pas tërmetit të vitit 1963. Shkupi kohëve të fundit dallon nga shumë kryeqendra evropiane, pasi është duke fituar identitet krejtësisht të ri, veçanërisht në pjesën më frekuentuese të tij, siç është sheshi.

Sheshi i Shkupit është ndërtuar në periudhën midis viteve 1920 dhe 1940. Në planin urbanistik, edhe para projektit “Shkupi 2014”, në shesh ka pasur një numër të madh të objekteve të rëndësishme. Por, pas tërmetit të vitit 1963, gjendja në planin formal dhe përmbajtësor është ndryshuar dukshëm dhe varfëruar sa i përket ndërtimeve më atraktive arkitektonike. Sheshi më shpesh ka shërbyer për organizimin e një numri të madh të manifestimeve kulturore dhe tubimeve politike-partiake.

Në kuadër të projektit “Shkupi 2014” tentohet të realizohet procesi i ndryshimit të identitetit etnik dhe kombëtar maqedonas, projekt që mbështetet financiarisht nga Qeveria e Maqedonisë. “Mbani mend panjen e tanishme të sheshit të kryeqytetit. Ai më asnjëherë nuk do të jetë i njëjti”. Me këto fjalë është paralajmëruar videoprezantimi i projektit.

Në Shkup, çdo ditë ngriten përmendore dhe sheshi i kryeqendrës së shtetit tashmë është i ngushtë për numrin e madh të statujave, që sipas ideatorëve të këtij projekti ka për qëllim që të reflektojë historinë kombëtare të popullit maqedonas.

Natyrisht se në Ballkan loja me identitetet kolektive nuk ka përfunduar, veçanërisht kur çdoherë gjenden konsumatorë, por njëkohësisht edhe prodhues dhe riprodhues të tij që janë zakonisht elitat politike. Maqedonia, sipas studiuesit Izaim Murtezani, nuk është përjashtim nga ky rregull. Maqedonia ka kaluar në rrugën e “deideologjizimit” ose “çmontimit” të ish sistemit socialist, përkatësisht shmangies së gjurmëve të asaj kohe. Në këtë raport ka ndodhur edhe ndryshimi i emrit të sheshit të Shkupit. *“Në periudhën socialiste, ai quhej Marshall Tito, ndërsa në periudhën postsocialiste u pagëzua si sheshi ‘Makedonija’. Por kulminacioni i promovimit të identitetit kolektiv maqedonas, do të ndodh pikërisht në këtë hapësirë, përmes vendosjes së disa përmendoreve historike, duke filluar nga koha antike deri më sot”*. (Murtezani I, 2014:2).

Në ‘Shkupin 2014’ ndërtohen objekte monumentale arkitektonike si hotele, objekti i Teatrit të vjetër, godina të organeve të shtetit, Salla e Filarmonisë, Ura ‘Syri’, Ura e Artit, Porta ‘Maqedonia’, kisha ‘Shën Konstantini dhe Helena’ dhe Porta Triumfale. Poashtu janë ngritur edhe disa përmendore të personaliteteve historike. Në këtë drejtim veçohet përmendorja e Aleksandërit të Madh, i cili është riemërtuar si Luftëtari në kalë, një përmendore grandioze e lartë rreth 22 metra, pastaj përmendoret e Filipit të dytë, Shën Cirilit e Metodit, Shën Klimentit e Naumit, Mbretit Samoil, Karposhit, Goce Delcevit, Dame Gruevit, përmendorja e heronjve të rënë për Maqedoninë, përmendorja e “mbrojtësve” të Maqedonisë (kushtuar forcave të sigurisë maqedonase, që luftuan kundër ish Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare gjatë konfliktit të armatosur që ndodhi në vitin 2001) si dhe shumë përmendore të tjera.

Përndryshe përmendoret përmes simbolikës dhe monumentalettetit të tyre, si pjesë përbërëse e hapësirës publike, ndoshta në

mënyrë më të mirë e reflektojnë raportin ndaj memories kolektive të një shoqërie. Përmendoret, në cilësinë e prezantimit të së kaluarës, njëkohësisht janë medium më i rëndësishëm për konservimin e historisë. Kjo njëherësh e shndërron atë të kaluar në faktor të rëndësishëm të bashkëkohësisë. Ngritja e përmendoreve publike është akt që zbatohet përmes institucioneve të pushtetit, sepse ato e shprehin edhe opinionin publik të regjimit.

Ky projekt nuk synon vetëm ndryshimin e pamjes së Shkupit, por tenton të ndryshojë edhe historinë e Maqedonisë si shtet dhe të popullit maqedonas në përgjithësi. Projekti ndan shoqërinë në vija etnike, sepse ajo në Maqedoni funksionon e ndarë etnikisht, por edhe në aspektin religjioz. Shkupi 2014 nuk i ndan vetëm shqiptarët dhe maqedonasit, myslimanët dhe të krishterët, por ndikon edhe në ndarjen intraetnike tek maqedonasit, sepse kontestohet nga një pjesë e intelektualëve dhe ekspertëve. Historiania e artit Donka Barxhieva-Trajkovska mendon se në gjashtë vitet e fundit Shkupi ka përjetuar dridhje tektonike, të cilat sipas intensitetit i tejkalojnë pasojat e tërmetit katastrofik të vitit 1963. Ajo madje thotë se në vitin 2006 ka ndodhur një “fatkeqësi natyrore” më e tmerrshme, e cila kërcënon ndryshimin e pamjes së qytetit, si pasojë e realizimit të projektit “Shkupi 2014”.

Ky projekt kontrovers ka prapavijë ideologjike, me të cilën në mënyrë të drejtpërdrejt dëmtohet trashëgimia kulturore. Në fakt, stilet anakronike, që me forcë imponohen, asnjëherë nuk kanë qenë pjesë e kësaj toke, ndërsa janë karakteristike për kulturën perëndimore. Vetë dukuria e stilit barok është rezultat i reagimit të Kishës Katolike kundër protestanizmit dhe përkrahësve

të Martin Luterit. Në tentimin që sërish t'i tërheq be-sintarët në kisha, është formuar ky stil, si bashkëdyzim integral i arkitekturës, skulpturës dhe artit figurativ, i plotësuar me shumë teatralitet dhe patos. Tradita maqedonase është dominante krishtere dhe kisha ka lëvizur në rrugë tjetër që e përcakton dhe definon trashëgiminë kulturore. Është e saktë që disa “elemente” të barokizuarra dhe “klasiciste” paraqiten në arkitekturë dhe art në shekullin XIX, por si shprehje reale autentike me primesa perëndimore, që lehtë identifikohen si remineshenca të stileve të kaluara.

(Barxhieva D, intervistë për portalin Plusinfo, 25.02.2013,
<http://arhiva.plusinfo.mk/mislenje/767/Skopje-2014-e-pogolema-katastrofa-od-zemjotresot-vo-1963-ta>)

Ekspertë të shumtë të trashëgimisë kulturore, historisë, urbanizmit, arkitekturës, politikologjisë vlerësojnë se kjo që ndodh tani është risi jo vetëm për ne, por edhe për njerëzit e sferës kulturore perëndimore. Sipas Barxhievës kjo që ndodh në Shkup është më larg se edhe interpretimi vulgar i devizës së arkitektit të madh të postmodernizmit Robert Venture “Pak është e mërzitshme” („Less is a bore“) sepse mungon koncepti kreativ autentik. Përkundër kësaj zbatohet një diktat drejtpërdrejt nga kreu, nga Qeveria, selia e së cilës është barokizuar dhe neoklasikuar, përkatësisht humbet në njërin nga stilet që tashmë janë anakronikë.

“Shkupi 2014” mbështetet fuqishëm sidomos nga ideatorët dhe realizatorët e projektit. Valentina Karanfilovska-Steva-

novska, skulptorja që ka projektuar dhe realizuar pjesën më të madhe të përmendoreve në kuadër të projektit vlerëson se në aspektin estetik kryeqendra e Maqedonisë duket shumë më bukur, se sa më herët. *“Sot duke iu falënderuar projektit Shkupi 2014, kryeqendra e Maqedonisë mund të numërohet në mesin e metropoleve më të bukura në botë. Është fatkeqësi që disa media na nënçmojnë si artistë, duke mos pasur aspak respekt për punën tonë. Ne jemi artistë dhe nuk duhet të përzihemi me politikën, sepse shumë pak dimë për të”* (Stevanovska V, deklaratë për Al Jazeera Balkan, 14. 09.2015, <http://balkans.aljazeera.net/vijesti/rat-spomenika-u-skoplju>)

Qeveria, përkatësisht Ministria e Kulturës nuk ofrojnë të dhëna të sakta lidhur me çmimin e projektit, por sipas disa përlllogaritjeve nga ekonomistët, në të do të shpenzohet rreth 1 miliard euro. Elita politike përmes këtij projekti promovon leximin e ri të historisë dhe ndoshta është shembulli i fundit më eklatant në Evropë, ku plotësisht instrumentalizohet historia në favor të krijimit të një realiteti të ri në raport më të kaluarën.

Skender Hasani, drejtor i Institutit të Trashëgimisë Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, thotë se ajo çfarë po ndodh tani në sheshin e Shkupit është koncept i shekullit të XIX, kur luftohej për krijimin e shteteve apo të kombeve të ndryshme.

Koncepti i shekullit XXI është ai i thyerjes së kufijve, koncept i integritetit, i afrimit të popujve dhe shteteve, por në Maqedoni ndodh krejtësisht e kundërta. Ne kthehemi në shekullin XIX, duke u larguar nga konceptet dhe integritetet euroatlantike. Mendoj se projekti ‘Shkupi 2014’, paraqitet për shkak të krizës së identitetit të bashkëqytetarët tanë maqedonas. Gjatë historisë dihet

shumë mirë se brenda VMRO-së janë gërshetuar dy koncepte, ai i antikitetit dhe koncepti sllav. Koncepti sllav kulmoi gjatë vitit 1998–2002, kur u ngritën kryqe në gjithë Maqedoninë dhe në malin ‘Vodno’ të Shkupit, kurse periudha e viteve 2006–2012 kulmoi me ndërtimin e sheshit ‘Shkupi 2014’.

(Hasani S., intervistë për radion Evropa e Lirë, 14.01.2012,
<http://www.evropaelire.org/content/article/24451727.html>)

Në fakt në projektin Shkupi 2014 fillohet me përmendoren e Lekës së madh, si bartës i shtetit të maqedonasve antikë, pastaj vazhdohet me Samoilin si krijues i mbretërisë së shekullit të mesëm, përmendoren e Nikolla Karevit si kryetar i parë i Republikës së Krushevës (e formuar në vitin 1903 dhe e cila ka zgjatur vetëm 10 ditë). Koha pas Luftës së Dytë Botërore është prezantuar me përmendoren e Metodija Andonov Çentos, si simbol i formimit të shtetit të ri–Republikës Socialiste të Maqedonisë. Nga këtu del konstatimi se në kuadër të projektit tentohet të vendoset një paralele midis kohës së antikitetit me Lekën e Madh, pastaj Mesjetës me personalitetin e Samoilit, Republikës së Krushevës me personalitetin e Nikolla Karevit dhe Maqedonisë së pasluftës me personalitetin e Çentos.

Ky projekt ka për qëllim të përforcojë dominimin kulturor maqedonas dhe krishter në Maqedoni. Kjo argumentohet me faktin se edhe pse përmendoret e historisë së popullit maqedonas vendosen sipas planit të parashikuar, nuk dihet se kur do të ndodh vendosja e tri përmendoreve të historisë shqiptare: Josif Bageri, Nexhat Agolli dhe Pjetër Bogdani. Qeveria e

VMRO–DPMNE–së dhe BDI–së, që në vitin 2011 ka marrë vendim për përfshirjen e këtyre përmendoreve në projektin “Shkupi 2014”, por ky vendim nuk gjen zbatim.

Në atë projekt pati vend për elemente ortodokse me shumë shenjtorë dhe me kishën “Shën Konstantini dhe Elena”, pati vend për Car Dushanin serb, pati vend për Pallatin e Oficerëve, pati vend për Teatrin Popullor (serb), pati vend për plot elemente antike të realizuara në kiç bashkëkohor, por nuk pati vend për xhaminë Burmali, as për xhaminë Ibni Pajko, që të dyja pjesë e sheshit të Shkupit. Nuk pati vend për përmendore tipike shqiptare, si Skënderbeu, Hasan Prishtina, Ismail Qemali, vëllezërit Frashëri, Vehbi Dibra, Said Najdeni, Sherif Langu, Ferhat Draga, Dervish Cara, Rexhep Voka, Adem Jashari, Azem Morana.

(Ibrahimi Z., kolumnë e botuar në gazetën e përditshme Koha, 29.01.2015, <http://koha.mk/opinion/34381-%E2%80%9CShkupi-2014%E2%80%9D-me-para-dhe-me-vul%C3%AB-shqiptare.html>)

Përgjegjësia për vendosjen e përmendoreve të historisë shqiptare sipas dispozitave ligjore i takon komunës Qendër të Shkupit. Kreu i kësaj komunë, Andrej Zhernovski ka sqaruar se postamenti i njërës përmendore është në fazën përfundimtare të përpunimit, ndërsa dy të tjerat duhet të përgatiten dhe kur të kompletohen do të sillen nga Italia dhe do të vendosen. *“Midis të gjitha përmendoreve, që janë vendosur nuk janë përmendoret e tri personaliteteve shqiptare. E dimë që ato*

janë lënë si ‘patate te nxehta’ nga pushteti aktual (VMRO–DPMNE) me qëllim që të shkaktojnë tendosje ndëretnike. Por udhëheqja e komunës Qendër nuk do të bie pre e provokimit. Ajo që është pjesë e projektit Shkupi 2014 dhe është detyrim nga udhëheqja e mëparshme e komunës do të realizohet”. (Zhernovski A., deklaratë për Al Jazerra Balkan, 14. 09.2015, <http://balkans.aljazeera.net/vijesti/rat-spomenika-u-skoplju>).

Një ditë para ditës së pavarësisë së Maqedonisë, 8 shtatori, janë vendosur edhe 5 përmendore të reja. Figurat e përmendoreve janë në kuaj dhe mbajnë armë dhe janë vendosur përballë dy përmendoreve të personaliteteve shumë të rëndësishme të historisë shqiptare, përmendores së heroit më të madh kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeut, të cilën e ka financuar komuna e Çairit dhe ideologut të pavarësisë së Shqipërisë, Hasan Prishtina, e cila ishte donacion privat i Mehmet Prishtinës.

Nuk kaloi shumë kohë dhe u kumtua se janë vendosur edhe skulptura të reja të nëntë muzave greke të artit dhe një luan i ri i bronzit. Dita ditës projekti “Shkupi 2014” rrumbullakohet në aspektin formal dhe përmbajtësor dhe reagimet, komentet afirmative dhe kundërshtuese janë shumë të mëdha. Por, përgjegjësinë për vendosjen e përmendoreve të reja, por edhe të Car Dushanit, nuk e kanë marrë as Qeveria, Qyteti (Bashkia) e Shkupit, e as komuna Qendër. Si porositës është paraqitur një organizatë fantome nga Lerini në Greqi.

Partitë politike shqiptare janë treguar të pasuksesshme që të ndalojnë projektin Shkupi 2014 dhe kanë hedhur fajin njëra tjetrës. Qeveria, përkatësisht Ministria e Kulturës nuk ofrojnë të dhëna të sakta lidhur me çmimin e projektit joproduktiv dhe jokapital, por sipas disa përllogaritjeve nga ekonomistët në të do të shpenzohet rreth 1 miliard euro. Shumë media ndër-

kombëtare projektin Shkupi 2014 e cilësojnë si Diznilend, ndërsa në mediat gjermane, por dhe mediat e tjera evropiane dhe të rajonit ka pasur kritika se disa objekte dhe përmendore paraqesin një, përkatësisht se janë vepra joartistike dhe joestetike.

“Politizimi i artit”, pastaj e kushtëzon “artin e politizuar”, që do të thotë se nga do që ta kthesh më së shumti ka pësuar arti. Meqenëse në rastin konkret kemi të bëjmë me ndërhyrje të drejtpërdrejt të politikës në lëmin e artit, atëherë është e qartë se në këtë drejtim do të parashtrihen edhe hipotezat rreth interpretimit dhe shpjegimit të idesë, qëllimit dhe realizimit të projektit me karakter publik, siç është ‘Shkupi 2014’, rreth të cilit viteve të fundit po zhvillohen debate të ashpra, ku janë përfshirë politikanë, artistë, studiues, intelektualë dhe qytetarë të rëndomtë, të cilët tanimë janë ndarë në dy anë: në ata që përbëjnë grupin të cilët janë “për” dhe ata të grupit që janë “kundër” këtij projekti. Dhe, nga krejt kjo që po ndodh në lidhje me këtë projekt, përveç reperkusioneve sociale dhe politike, me sa duket si pasojë e tij më së shumti është cenuar karakteri estetik i këtij projekti artistik.

(Pollozhani M, analizë e botuar në revistën Shënja, mars 2012)

Kundërshtarë të këtij projekti nuk ka vetëm tek pala shqiptare, por edhe tek ajo maqedonase. Njëri ndër intelektualët më të guximshëm që lufton këtë projekt, arkitekti Miroslav Gërçev propozon zhdukjen e projektit Shkupi 2014.

Shkatërrimi i godinave dhe përmendoreve në projektin ‘Shkupi 2014’ duhet të jetë i detyrueshëm, performativ dhe klimaks simbolik i festimit të çlirimit të serishëm të Maqedonisë. Siç ky projekt monstruoze nuk mund të ndahet nga rrënimi shoqëror, i shkaktuar nga ndërtuesit e tij, ashtu edhe rrënimi i tij patjetër duhet të jetë pjesë përbërëse e krenimit të çlirimit të ardhmërisë maqedonas nga përqaftimet vdekjeprurëse të DPMNE-së.

(Gërçev M, kolumnë në portalin Okno, 17.04.2013
<http://okno.mk/node/27467>)

Por kështu nuk mendon pushteti dhe intelektualët e afërt me të, të cilët konsiderojnë se ky projekt ka për qëllim të ndikojë në përforcimin e identitetit maqedonas, edhe pse kundërhartët e vrojtojnë si kontruksion joreal i një identiteti të ri kombëtar të maqedonasve.

Pushteti, saktësisht VMRO-DPMNE-ja, nga vitin 2006 dhe 2007 e këndeje, zbuluan “të vërtetën” e re historike, se maqedonasit e sotëm etnikë kanë prejardhje nga maqedonasit antikë! E tërë historiografia sllave për një çast ra në ujë. Mbeten të nemitur shumë akademikë e historianë eminentë maqedonas, që kishin shkruar libra shkollorë e vepra të shumta shkencore, për të argumentuar se maqedonasit kanë prejardhje nga sllavët e jugut, të cilët në këto hapësira kanë ardhur në shekullin e 7-të nga Karpatet.

Kjo gjetje e kryeministrit më pas u masivizua, përmes megafonëve të tij mediatikë, të instaluar në shumicën e mediave. U gjetën edhe disa “mendje” të reja, që dëshmonin se maqedonasit kanë rrënjë antike. Si çdo ideologji politike, që synon idetë dhe pikëpamjet e saj, t’i bëjë sa më populllore, ndërmerr

edhe veprime që kanë impakte arkitektonike, urbanistike dhe historike. “Shkupi 2014” është projekt i cili në tërësi është instrument i filozofisë politike, ideal ky që tenton ta bëjë sa më real dhe më të pranueshëm manipulimin historik, “shpëlarjen e trurit” të maqedonasve mbi të kaluarën e tyre kolektive. De facto ky projekt i mbështetur nga mediat proqeveritare e intelektualë të shumtë, të cilëve qeveria nga buxheti i shtetit u ndan para, ka detyrë të rëndë, që realitetin virtual mbi identitetin maqedonas ta bëjë sado që është e mundur realitet objektiv.

Manipulimi i historisë, sipas njërës ndër liderët e opozitës së tanishme, Lubço Georgievski, është “manipulimi më i madh në histori që u bëhet maqedonasve”.

Debati mbi identitetin maqedonas është shumë i zjarrtë, zhvillohet me tone të larta dhe me barikadimin e atyre që mbrojnë, afirmojnë dhe promovojnë tezat antike mbi identitetin maqedonas dhe atyre që identitetin maqedonas e ndërlikojnë vetëm me sllavët dhe assesit me maqedonasit antikë, për arsyen e thjeshtë, se është një hapësirë e madhe mijërvjeçare midis antikës dhe maqedonasve të sotëm.

Përderisa pushteti, si në sistemet totalitariste, bën censurë në botimin e librave shkollorë, duke i detyruar autorët që të shkruajnë mbi historinë e vjetër të maqedonasve me fakte, gjoja të reja, të mbështetura në arkeologji e në histori, pala tjetër, opozita e pushtetit populist përdor argumente të tjera kundërshtuese. Nga viti 2006 kur në pushtet erdhi VMRO-DPMNE-ja ndodh një fenomen politik: maqedonasit nuk kanë qenë kurrë më të ndarë brenda etnisë së vet.

Megjithatë përderisa nacionalizmi ekskluziv maqedonas është i strukturuar institucionalisht, ai shqiptar është folklorik, tradi-

cional dhe ushqehet shumë pak nga institucionet dhe shumë pak financohet nga buxheti.

Ky etnonacionalizëm, që ka për qëllim zgjimin e maqedonasve etnikë ka krijuar edhe shthurjen identitare të maqedonasit. Ka edhe nga ata që me gjysmë zëri thonë se janë antikë, por edhe sllavë. Thjesht kolektivisht etnia maqedonase përballet me një konfuzion sa i përket identitetit, fakt që flet se identiteti etnik i popullit maqedonas nuk paska qenë i formësuar kulturallisht dhe etnopsikologjikisht, por më tepër ka qenë i mediatizuar dhe i imponuar si politikë shtetërore dhe institucionale.

Nga e gjithë kjo që thamë del konkluzioni se projekti “Shkupi 2014” është kontradiktor, njëetnik, njëreligjioz dhe njëpartiak dhe ka për qëllim shënjimën e hapësirës publike në kryeqytetin e Maqedonisë me elemente antike dhe sllave, por edhe krishtere, duke mos reflektuar realitetin shumëetnik, shumëfetar dhe shumëkulturor në Maqedoni.

Literatura dhe burimet

Anderson, Benedict 1983: *Imagined Communities*. London: Verso.

Azaryahu, Maoz 1999: Politički simboli u svakidašnjici. Politsistemski pristup istraživanju. *Etnološka tribina*. 22. Vol. 29. Godišnjak hrvatskog etnološkog društva. Zagreb.

EPK 1993: *Enciklopedija političke kulture*. Redaktor Milan Matič. Beograd. Savremena administracija.

Dentile, Emilio 2009: *Religije politike. Između demokratija i totalitarizama*. Beograd. Biblioteka XX vek.

Dordano, Kristijan 2001: *Ogledi o interkulturnoj komunika—
ciji*. Beograd. Biblioteka XX vek.

Ože, Mark 2005: *Prilog antropologiji savremenih svetova*.
Beograd. Biblioteka XX vek.

Putinja, Filip, **Štref—Fenar**, Žoslin 1997: *Teorije o etnicitetu*.
Beograd. Biblioteka XX vek.

Murtezani, Izaim 2014: *Sheshi i qytetit si lokus dhe fokus*
(punim shkencor), Shkup

Burimet:

Shtypi ditor dhe periodik në gjuhën shqipe dhe maqedonase
Mediat ndërkombëtare Evropa e Lirë dhe Al Jazeera Balkans
Portalet në internet në gjuhën shqipe dhe maqedonase

KONKLUZIONET E KONFERENCËS SHKENCORE “SFIDAT E TRASHËGIMISË KULTURORE NË MAQEDONI”

Studiuesit dhe profesorët universitarë, pjesëmarrës në konferencën shkencore me temë: “Sfidat e trashëgimisë kulturore në Maqedoni”, e mbajtur më 30 shtator të vitit 2014 në Institutin e Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve— Shkup, konstatuan se duke u nisur nga fakti se trashëgimia kulturore e një populli paraqet tërësinë e vlerave shpirtërore dhe materiale të krijuara gjatë historisë së tij, pasqyron zhvillimin shoqëror, politik, kulturor e fetar në të kaluarën e tij dhe paraqet luftën shekullore për ruajtjen e identitetit të tij etnik, gjuhësor dhe kulturor dhe se ruajtja e trashëgimisë kulturore, si një akt qytetërues i një populli, ka rëndësi pasi dëshmon se çdo dukuri bashkëkohore mund të ketë rrënjë të thella historike, kërkojmë qasje më serioze nga të gjithë përgjegjësit për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore në Maqedoni, e në veçanti të shqiptarëve.

Duke u nisur nga e dhëna se jetojmë në kohën e globalizimit, kur me të madhe atakohen vlerat e trashëgimisë kulturore kombëtare, imponohet nevoja që këto vlera të mbrohen dhe afirmohen në mënyrë institucionale. Kjo nënkupton angazhimin e të gjithë faktorëve, pasi është çasti i fundit që të shpëtohen këto vlera etnokulturore, sepse ato dita—ditës po rrënohen para syve tanë.

Duke evidentuar se llojet e ndryshme të trashëgimisë janë të cenuara seriozisht, kërkojmë që të gjitha institucionet e shtetit, në bazë të rregullativës normative—juridike të përkujdesen

dhe të kenë qasje më serioze ndaj etnokulturës shqiptare, me qëllim që trashëgimia kulturore kombëtare të ruhet në gjen-djen e saj burimore. Shteti ka për detyrë të mbrojë trashëgiminë kulturore në të gjithë territorin e tij, pa marrë parasysh ngjyrimin e saj etnik.

Gjithashtu konsiderojmë se duhet të krijohen kushte që të ruhet integriteti i të gjitha të dhënave si dëshmi, burime dhe dokumente.

Trashëgimia kulturore është shumë e gjerë dhe në brendinë e saj ndërthhen trashëgiminë materiale, në të cilën përfshihen artefaktet dhe trashëgimia shpirtërore, që përfshin vlerat jo-materiale, të cilat kanë të bëjnë me qenien e identitetit tonë kombëtar.

Trashëgimia kulturore përfshin të mirat materiale dhe jomateriale, si shprehje dhe dëshmi e krijimtarisë njerëzore në të kaluarën dhe të sotmen, përkatësisht veprat e përbashkëta të njeriut dhe natyrës, të cilat për shkak të vlerave historike, arkeologjike, etnologjike, artistike e arkitektonike kanë rëndësi kulturore dhe historike. Por, meqë kohëve të fundit vërehen tendenca degraduese për qëllime të caktuara, për tejkalimin e kësaj gjendje rekomandojmë që të ndërmerren aktivitete konkrete. Ato duhet të shtrihen në sferën e mbrojtjes së trashëgimisë dhe parandalimin e veprimeve dhe dukurive, të cilat mund të shkaktojnë dëmtimin, shkatërrimin, degradimin dhe përvetësimin kundërligjor të trashëgimisë kulturore të shqiptarëve.

Etnokultura shqiptare e Maqedonisë është e begatshme dhe e llojllojshme, por ajo kërkon përkujdesje dhe kultivim të saj.

Nëse Jugu i Shqipërisë krenohet me polifoninë tanimë nën mbrojtje të UNESCO-s, kurse Veriu i Shqipërisë dhe Kosova me këngët e kreshnikëve që trokasnin në dyert e UNE-

SKO-s, edhe shqiptarët e Maqedonisë kanë perlat e tyre, si këngëtimin specifik dyzërësh, apo paradigmën e melosit kërcë-ovar, veshjen e fshatrave të zonës së Rekës, Sallarevës e Patishka Rekës, artizanatet e shumta, e kështu me radhë, të denja për çdo lloj respekti.

Andaj në funksion të mbrojtjes së tyre rekomandojmë rritjen e përfaqësimit të shqiptarëve, përkatësisht zmadhimin e numrit të të punësuarve shqiptarë në institucionet që janë përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore: Drejtorinë për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, Qendrën Nacionale për Konservim, muzetë, bibliotekat, Kinotekën e Maqedonisë dhe Arkivin Shtetëror të Maqedonisë.

Meqenëse kuadri i dedikuar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore është shumë deficitar te shqiptarët, rekomandojmë që institucionet përgjegjëse të angazhohen për themelimin e Katedrës së Etnologjisë, Historisë së Artit dhe Arkeologjisë në kuadër të Universitetit Shtetëror të Tetovës, ndërsa aftësimi teorik dhe praktik të kuadrove për fushat e veçanta të trashëgimisë, t'i kushtohet rëndësi edhe në Institutin e Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve në Shkup.

Përveç këtij angazhimi, nisur nga fakti se krahas disa publikimeve me material etnologjik dhe folklorik të shqiptarëve në Maqedoni, mbetet edhe shumë për t'u bërë, sidomos në planin e vjeljes së materialit empirik, pasi nuk mund të pretendohet studimi i këtyre lëmnive pa një gjë të tillë.

Në të ardhmen është i nevojshëm realizimi i makroprojekteve shkencore me ekspedita, të cilat në radhët e tyre do të përfshinin të gjitha profilet e studiuesve, si etnologë, folkloristë, etnomuzikologë, historianë, arkitektë, gjuhëtarë e kështu me radhë. Kjo mënyrë e eksplorimit të materialit empirik në të gjitha zonat e banuara me shqiptarë në Maqedoni, ndoshta do

të rezultonte me sukses të caktuar, mes tjerash, edhe në grumbullimin dhe sistematizimin e materialit folklorik dhe etnologjik.

Në funksion të mbrojtjes së trashëgimisë shpirtërore duhet të jetë edhe popullarizimi i saj nëpërmjet mekanizmave dhe instrumenteve gjegjëse. Kjo do të nënkuptonte realizimin e emisioneve cilësore dokumentare shkencore, organizimin në shkallë vendore dhe republikane, por edhe mbarëkombëtar e më gjerë, të festivaleve të karakterit folklorik, ekspozitave, seminareve, simpoziumeve e kështu me radhë.

Padyshim se duhet ta kultivojmë dashurinë ndaj këtyre artefakteve kulturore, pasi nëpërmjet tyre përdëftojmë se jemi pjesë përbërëse e botës së qytetëruar e cila manifeston një kujdes të posaçëm ndaj së kaluarës duke gjetur mënyra dhe forma të ndryshme për ta ruajtur, apo konservuar atë në trajtën parake, apo autentike si një vlerë të pacenuar kulturore të paraardhësve të vet.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека
"Св. Климент Охридски", Скопје

930.85(497.7)(062)

SFIDAT e trashëgimisë kulturore në Maqedoni: (konferencë shkencore - 30.09.2014) / [kryeredaktor Zeqirija Ibrahim]. - Shkup : Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të Shqiptarëve, 2015. - 178 стр.; 21 см. - (Biblioteka Scupi)

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4653-25-7

а) Културно наследство - Македонија - Собири
COBISS.MK-ID 98291978